There are different kinds of tests, such as:

- Proficiency tests
- Achievement tests
- Placement tests
- Diagnostic tests use proficiency or achievement tests

We see **evaluation** as wider than testing. Testing may be a successful tool in evaluation, but we also think there are other criteria for assessing someone's performance. Evaluation is not limited to numbers or just giving learners marks. Instead of trying to count or measure learner's ability to make useful contribution to the class, we can simply judge whether s/he makes a contribution or not, and sometimes we will have to justify, negotiate, and possibly modify our opinions.

With the evaluation we are trying to help the learner to learn, so it is not an assessment, in fact it is aid to learning. In other words, we can use assessment procedure to develop and improve, not only the learner, but also the teaching programme and even the school.

For methodological guidelines see the English Language Curriculum document.

HYRJJE

Mësimi i gjuhës frënge deri në vitet e shtatëdhjeta, është mësuar në shumicën e shkollave të Kosovës. Pastaj ky raport ka ndryshuar në favor të gjuhës angleze.

Gjuha frënge edhe sot, është njëra nga gjuhët më të rëndësishme botërore dhe paraqet një gjuhë me interes për t'u mësuar edhe edhe më tutje në Kosovë. Ajo njihet si gjuhë zyrtare e OKB-së, si gjuhë e diplomacisë, e kulturës, e artit, e modës, e mirësjelljes, etj. Si e tillë, ajo mbetet një gjuhë me interes për gjeneratat tona të tashme dhe të ardhme.

Sipas plan-programit të ri të Kosovës mësimi i gjuhëve të huaja mundëson **formimin e qytetarit aktiv e të ndërgjegjshëm në një shoqëri demokratike dhe multikulturore.**

Gjuha frënge, tash e tutje, do të mësohet vetëm si gjuhë e dytë e huaj – në **nivelet 2 dhe 3. Në shkollën e mesme të ulët** ajo do të mësohet me **dy orë në javë – si lëndë zgjedhore.** Pra, ajo do të mësohet në ato shkolla në të cilat nxënësit do të kërkojnë ta mësojnë. Mirëpo, deri në zbatimin e reformës dhe futjen e programeve të reja në të gjitha klasat, gjuha frënge, aty ku ende është duke u mësuar, do të mësohet me programet e vjetra (pra si gjuhë e parë e huaj).

QËLLIMET

Mësimi i gjuhës frënge në klasën e VI, pra në vitin e parë të mësimin të kësaj gjuhe të huaj, ka këto qëllime kryesore:

- Forcimi i kompetencave të përgjithshme të fituara në mësimin e gjuhës amtare dhe gjuhës së parë të huaj;
- Zhvillimi i aftësisë për të komunikuar në gjuhën e huaj;
- Zotërimi i komunikimit elementar në situata të jetës së përditshme;

- Pasurimi i përvojës kulturore të nxënësit;
- Pranimi i kulturave tjera dhe zhvillimi i qëndrimit kritik ndaj vlerave të tyre;
- Vetëdijësimi për ruajtjen e llojllojshmërisë kulturore;
- Zhvillimi i empatisë dhe yshtjes ndaj kulturës franceze;
- Zhvillimi njohës dhe psikoafektiv i nxënësit;
- Formimi i përgjithshëm i personalitetit të nxënësit;
- Formimi i shprehive për punë të pavarur të nxënësit;
- Zhvillimi i aktiviteteve ndërdisiplinare;
- Përgatitja e nxënësit që të futet në jetën profesionale dhe të mësojë gjatë tërë jetës;
- Pranimi i tjetrit dhe luftimi i stereotipeve të ndryshme, etj.

LËNDA: GJUHË FRËNGE (kategoritë dhe nënkategoritë)

1.0. KOMUNIKIMI:

- 1.1. Motivimi për komunikim
- 1.2. Aftësimi për komunikim
- 1.3. Zhvillimi i shkathtësive receptive (ndijimore)
 - 1.3.1. Të dëgjuarit
 - 1.3.2. Të lexuarit
- 1.4. Zhvillimi i shkathtësitë produktive
 - 1.4.1. Të folurit
 - 1.4.2. Të shkruarit

2.0. TË KUPTUARIT DHE PËRDORIMI I GJUHËS:

- 2.1. Njohja e tingujve
- 2.2. Të kuptuarit e fjalorit
- 2.3. Elementet e ligjërit - konceptet

3.0. KULTURA

- 3.1. Kultura e popullit francez
- 3.2. Kultura e popullit shqiptar
- 3.3. Frëngjishtja në botë (frankofonia)

OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITURA

Kl.	Kategoritë	Objektivat e përgjithshme	Objektivat specifike	Rezultatet e pritura
VI	1.0. KOMU- NIKIMI	Përvetësimi i një fjalësi fillestar të frëngj	Përvetësimi: <ul style="list-style-type: none"> • i fjalësit fillestar • i shprehjeve fillestare • i mekanizmave gjuhësorë të gjuh. 	Nxënësi është në gjendje të përdorë: <ul style="list-style-type: none"> • një fjalës fillestar • shprehjet fillestare • mekanizmat fillestarë të gjuhës
		Zhvillimi i shprehive dhe i shkathtësive fillestare për punë	Aftësim i nx. për të dëgjuar / kuptuar Aftësim i nx. për t'u shprehur në gj. frënge Aftësim i nx. për të lexuar në gj. frënge Aftësim i nx. për të shkruar në gj. frënge Zhvillim i shprehive për punë (mësim)	Nxënësi ka fituar shprehitë dhe shkathtësitë fillestare për punë
	2.0. TË KUPTUARIT DHE PËRDORIMI I GJUHËS	Shqiptimi i drejtë i tingujve të gj. frënge	Perceptimi dhe dallimi i tingujve dhe riprodhimi i tyre	Nxënësi dallon dhe riprodhon drejt tingujt themelorë
	Të kuptuarit e fjalësit themelor të gjuhës frënge	Të kuptuarit e mekanizmave gjuhësorë dhe funksionimi i tyre	Nxënësi kupton mekanizmat themelorë dhe funksionimin e tyre	
	Renditja e fjalëve në fjali	Njohja e funksioneve bazë të fjalëve në fjali Përforcim i aftësive të përgjith. kulturore Vetëdijësim për të qenë i hapur me tjerët	Nxënësi njeh funksionet bazë të fjalëve në fjali Nxënësi njeh aspekte themelore nga kultura frënge	
3.0 KULTURA	Njohje e nxënësit me kulturën frënge	Përforcim i kompetencave ndërkulturore Zbulim i një kulture tjetër	Nxënësi përforcon kompe. Ndërkulturo. Nxënësi has / zbulon një kulturë tjetër	
		Rëndësia e gjuhës frënge në botë	Kahet e zhvillimit të frankofonisë në botë	Nxënësi kupton vendin e frëngjishtes në botë dhe rëndësinë e njohjes së saj

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

TEMAT DHE SHKATHTËSITË KOMUNIKATIVE (THEMES ET SAVOIR-FAIRES COMMUNICATIFS)

1.0. Shkathtësitë komunikuese (savoir-faires communicatifs)

1.1. Marrëdhëniet e përditshme shoqërore (relations sociales courantes) :

- 1.1.1. Përshëndetje, ndarje (saluer, prendre congé)
- 1.1.2. Takohem me dikë (prendre contact avec quelqu'un)
- 1.1.3. Falënderoj (remercier)
- 1.1.4. Kërkoj ndjesë (s'excuser)
- 1.1.5. Kërkoj me mirësjellje (demander poliment)
- 1.1.6. Shpreh urime: ditëlindje, festa (exprimer des souhaits: anniversaire, fête)
- 1.1.7. Ftoj, propozoj...(inviter, faire des propositions...)

1.2. Identiteti: jap / kërkoj informata (l'identité: donner /demander des informations):

- 1.2.1. Emri dhe mbiemri, njoftimi (prénom et nom, la présentation)
- 1.2.2. Tregoj moshën (dire l'âge)
- 1.2.3. Shtetësia (la nationalité)
- 1.2.4. Vendbanimi, adresa (lieu où l'on habite, l'adresse)

1.3. Veprime nga jeta e përditshme (les activités de la vie quotidienne)

- 1.3.1. Shkolla (l'école)
 - 1.3.1.1. Tregoj klasën (indiquer la classe)
 - 1.3.1.2. Tregoj shkollën (indiquer son école)
 - 1.3.1.3. Tregoj lëndët mësimore (indiquer les disciplines étudiées)
 - 1.3.1.4. Pjesëmarrja në ritualin e klasës (participer au rituel de la classe)
 - 1.3.1.5. Kërkoj / jap informata për mjetet shkollore (demander / donner des informations sur le matériel à l'école)
 - 1.3.1.6. Kërkoj / jap informata për një ditë shkollore (demander /donner des informations sur une journée à l'école)
 - 1.3.1.7. Kërkoj / jap informata për etapat e vitit shkollor (demander / donner des informations sur les étapes de l'année scolaire)
- 1.3.2. Familja (la famille)
 - 1.3.2.1. Emërtimi i anëtarëve të familjes së ngushtë (nommer les membres de la famille proche)

- 1.3.2.2. Tregoj sa vëllezër / motra kam (dire combien on a des frères et des soeurs)
- 1.3.2.3. Tregoj moshën, emrat e vëllezërve / motrave (indiquer l'âge et le prénom des frères et des soeurs).

1.4. Shijet (les goûts)

- 1.4.1. Tregoj çka (nuk) më pëlqen: kënga, këngëtari, muzika, sporti, ushqimi (dire ce qu'on aime / ce qu'on n'aime pas (chanson, chanteur, musique, sport, aliments)
- 1.4.2. Shpreh një parapëlqim (indiquer une préférence)

2.0. Kategoritë gramatikore (les catégories grammaticales)

2.1. Emri (le nom)

- 2.1.1. Gjinia e emrit (le genre du nom)
- 2.1.2. Numri (le nombre)

2.2. Përcaktuesit - fjalia (les déterminants – la phrase)

- 2.2.1. Nyja shquese (l'article défini)
- 2.2.2. Nyja joshquese (l'article indéfini)
- 2.2.3. Nyja e rrëgjuar (l'article défini contracté)

2.3. Mbiemrat (les adjectifs)

- 2.3.1. Mbiemrat dëftorë (les adjectifs démonstratifs)
- 2.3.2. Mbiemrat pronorë (les adjectifs possessifs)
- 2.3.3. Mbiemrat cilësues (les adjectifs qualificatifs)

2.4. Numrorët (les adjectifs numériques)

- 2.4.1. Numërorët themelorë (les numéraux cardinaux)

2.5. Përemrat (les pronoms)

- 2.5.1. Përemrat vetorë (les pronoms personnels)

2.6. Folja (le verbe)

- 2.6.1. Grupi i foljeve me **-er** (le groupe des verbes en **-er**)
- 2.6.2. Kohët e foljes (les temps du verbe)
- 2.6.3. Mënyrat e foljes (les modes)

3.0. Sintaksë (la syntaxe)

Llojet e fjalisë:

- 3.1. Fjalia pohore (la phrase affirmative)**
- 3.2. Fjalia pyetëse (la phrase interrogative)**
- 3.2. Fjalia mohore (la phrase négative).**

4.0. Fonetikë (la phonétique)

4.1. Zanoret (les voyelles)

4.1.2. Zanoret hundore (les voyelles nasales)

4.2. Bashkëtingëlloret (les consonnes)

5.0. Lidhja e fjalëve (la liaison des mots)

6.0. Ortoepia (le contenu orthoépique)

7.0. Drejtëshkrimi (l'orthographe)

8.0. Kultura (la culture)

8.1. Marrëdhëniet e përditshme (les relations courantes)

8.2. Identiteti (l'identité)

8.3. Mjedisi; hapësira e përditshme (le milieu; l'espace courant)

8.4. Vlerësimi i dijës së nxënësve (l'évaluation des connaissances des élèves)

8.5. Familja (la famille)

8.6. Frankofonia (frëngjishtja në botë)

UDHËZIME METODOLOGJIKE

1.0. PARIMET METODIKO-DIDAKTIKE

Të mësosh një gjuhë do të thotë të mësosh për të komunikuar në atë mënyrë që të mund të përdorësh gjuhën në situata të jetës reale. Shkathësitë zënë vend parësor në mësimin e gjuhëve.

1.1. Parimi i parë: përqendrimi në komunikim, dhe jo si deri më tani përqendrim në gjuhë;

1.2. Parimi i dytë: përqendrimi në nxënësin dhe në nxënien e tij.

2.0. FORMA KOMUNIKATIVE E MËSIMDHËNIES

Se mësimdhënia më e mirë është në formë komunikative është e ditur sepse tanimë është e pranuar ndërkombëtarisht. Prandaj në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme. Kjo formë ju mundëson nxënësve arritjen e mjeteve gjuhësore që atyre u ne-

vojiten për t`u shprehur në gjuhën frënge, në situata të caktuara gjuhësore e shoqërore.

Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja e një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo anasjelltas.

3.0. METODAT E MËSIMDHËNIES

3.1. Metodatat që nxisin komunikimin

- Puna në grupe, në qifte
- Debatet,
- Lojrat në role
- Intervistat e thjeshta

3.2. Metodatat që nxisin punën e pavarur

- Tekste me vende të zbrazta
- Lojëra mësimi (si Memorie)
- Kontrolli i partnerit
- Përpunimi i pavarur i të dhënave (nga biblioteka, kompjuteri, etj.)
- Nxënia gjatë mësimdhënies (nxënësi merr rolin e mësuesit)
- Letërkëmbime me Francën (partnerizimi i shkollave, letërkëmbime mes nxënësve tanë dhe francezë, etj).

3.3. Metodatat që nxitin prodhimin

- Punimi i gazetave të murit, i pikturave, posterëve, teksteve (p.sh. për ekspozita, gara të shkollës apo interne, etj.)
- Shkrimi kreativ i poezive, i tregimeve të shkurtra), i nxitur përmes aktivizimit të njohurive paraprake.

4.0. PËRDORIMI I MEDIAVE

4.1. Televizioni

Televizioni është një mjet i dobishëm dhe i përhershëm që duhet të shfrytëzohet si nga arsimtari ashtu edhe nga nxënësit. Emisionet shkollore kushtuar gjuhës ose kulturës frënge të ne, programet e filmit dhe ato

te dramës dhe emisionet e ndryshme te televizioneve te jashtme ne gjuhën frënge janë një mjet i fuqishëm qe do te ndihmoje dhe shpejtoje përvetësimin e kësaj gjuhe te huaj nga nxënësit tanë.

4.2. Filmi, teatri, muzika

Filmi, teatri dhe muzika, poashtu, përbejnë mjete motivuese te rëndësishme për rritjen e rezultateve ne përvetësimin e gjuhës frënge, edhe pse te ne ato nuk janë shfrytëzuar aq sa ka pasur mundësi. Kinemaja dhe teatri, bashke me Televizionin, tani e tutje do te luajnë një rol me te rendesishem ne këtë aspekt.

4.3. Fotografitë

Fotografitë ndihmojnë për të sajuar tekste kreative, dhe përshkruese.

- Nxënësit përshkruajnë gjërat e njohura dhe ato të pazakonshme që shohin në fotografi.
- Ata tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e përshkruan fotografia.

4.4. Videoprojektori

Përdorimi i projektorit rrit interesimin e nxënësve për mësim. Kjo arrihet me:

- prezentimin e fotografive, vizatimeve, tregimeve të ilustruara, etj. dhe të teksteve përmes folive dhe projektorit,
- mbulimin dhe zbulimin e pjesërishëm të fotografisë,
- paraqitjen me fotografi të një ngjarjeje pa renditjen kronologjike,
- pararaqitjen e një teksti të ndarë në pjesë dhe të radhitur në mënyrë jo të rregullt dhe rregullimi i tij.

4.5. Materiali auditiv

Ky material mundëson ballafaqimin me frëngjishten standarde dhe nxit të kuptuarit përmes dëgjimit.

- Nxënësit gjejnë fillimin ose mbarimin e një teksti të shkurtër të dëgjuar më parë,
- Ata personifikohen me personazhet e një pjese teatrore të dëgjuar dhe diskutojnë për sjelljet e tyre.

4.6. Videomateriali

Përdorimi i videomaterialit u jep nxënësve mundësi të shumta për sajimin e teksteve me shkrim dhe me gojë:

- Paraqitja e një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose një përralle, i cili nxit krahasimin me tregimin apo me përrallën e lexuar ose të dëgjuar më parë.

5.0. RENDITJA E VEPRIMEVE

Për mësimi të efektshëm të frëngjishtes është e nevojshme të respektohet kjo renditje:

të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit.

Kjo është një renditje logjike, respektimi i se cilës mundëson një mësimdhënie me te shpejte, me te lehte dhe me cilësore te gjuhës se huaj.

5.1. Puna aktive dhe konkrete

Gjatë mëimit të gjuhës frënge në shkollat tona mësimdhënësit duhet të kenë parasysh kushtet dhe rrethanat tona (si një mes jofrankofon) që dallohen nga ato të Francës (si mes frankofon).

5.2. Për ushtrime dhe zbatim

Rëndësi e veçantë duhet t'u kushtohet ushtrimeve, varësisht nga llojet e tyre. Ato mund të bazohen në të dëgjuar, në të shikuar dhe në të shkruar.

6.0. KORRIGJIMI I GABIMEVE TË NXËNËSVE

Mënyrat e korrigjimit diskutohen shpesh dhe në mënyrë kundërtë në rrethin e mësimdhënësve. Disa i shohin gabimet si pengesë në procesin e mësimdhënies, të tjerët i shohin si ndihmesë në përvetësimin e gjuhës së huaj. Ndërsa disa prej tyre mendojnë se ato duhet të korrigjohen menjëherë që të mos përvidhen, të tjerët mendojnë se nuk duhet të korrigjohet, me çdo kusht, çdo gabim. Sido që të jetë, në fazën e komunikimit gjuhësor, gjatë përshkrimit të një fotografie, mësimdhënësit praktikojnë të shprehur të lirë të nxënësve të tyre. Gjatë korrigjimit të

gabimeve, nxënësit nuk duhet ndëshkuar, qortuar apo kritikuar për gabimet e bëra.

7.0. MËSIMDHËNIA / NXËNIA E DIFERENCUAR

Asnjë klasë nuk ka përbërje homogjene nxënësish sa u përket njohurive të tyre paraprake. Këtë duhet ta ketë parasysh çdo mësimitdhënës dhe të organizojë orën në bazë të kësaj. Kjo nënkupton që nxënësit që kanë aftësi për nxënie më të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët në mënyrë që mësimi i gjuhës frënge të jetë në përputhje me mundësitë dhe aftësitë individuale të secilit nxënës.

8.0. TEKNIKAT E PUNËS

Një ndër detyrat e mësimitdhënies në gjuhën e huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të marrin përgjegjësinë për të mësuarit individual. Nxënësit të cilët kanë mundësi për të menduar për proceset e nxënies dhe të organizojnë procesin e mësimitdhënies dhe të të mësuarit në grup, zakonisht arrijnë sukses më të mirë. Në këtë mënyrë ata, përveç tjerash, mund të përgatiten që të reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat jashtëshkollore si dhe të vazhdojnë proceset e mësimit të gjuhës.

LIDHJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Mësimi i një gjuhe të huaj sidomos në klasat e larta, ofron mundësi të shumta për lidhje ndërprogramore, në të gjitha nivelet. Këto lidhje do të përfshijnë shumë lëmenj (lëndë mësimore), sidomos ato të gjuhëve (gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj të parë); të shkencave shoqërore (edukatën qytetare, historinë, gjeografinë, etj.); të arteve të llojeve të ndryshme; por edhe të shkencave të natyrës. Në këtë mënyrë, nxënësit, përmes njohurive nga lëndët tjera, në një rënë anë do të ndihmohen në përvetësimin më të suksesshëm të gjuhës frënge, në anën tjetër, përmes njohurive nga gjuha frënge, ata do të zgjerojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre paraprake nga lëndët tjera.

VLERËSIMI

1.0. FUNKSIONET E VLERËSIMIT NË ORËN E GJUHËS FRENGE

1.1. Vlerësimi diagnostik:

- të identifikojë vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit dhe
- të ndërmjetësojë në tejkalimin e tyre;
- të kontrollojë njohuritë e nxënësve;

1.2. Vlerësimi i jashtëm

- të vlerësojë njohuritë e nxënësve, të vërtetohet se njohuritë e fituara mjaftojnë që nxënësi mund të kalojë në klasën më të lartë (p.sh., Diplomën e vitit të katërt);
- të vlerësojë përparimin e nxënësit;
- të identifikojë anët pozitive dhe negative të nxënësit;

1.3. Vlerësimi formativ:

- t'i mundësojë nxënësit të identifikojë anët e tij pozitive dhe negative dhe të angazhohet në përmirësimin e anëve negative.

2.0. ÇFARË DUHET TË VLERËSOHET ?

2.1. Të kontrollohen njohuritë e fituara:

2.2. Të kontrollohet përparimi i nxënësit:

- Vlerësimi i zhvillimit të nxënies;
- Shkalla e zotërimit;

2.3. Integrimi i njohurive të fituara:

- Vlerësohet projekti ose aktivitetet jashtëshkollore.

3.0. SI DUHET TË VLERËSOJMË?

3.1. Mënyrat e vlerësimi nga profesori: kontrolli i vazhdueshëm:

Vlerësimi i drejtpërdrejtë:

Profesori vlerëson rezultatet e nxënësit

Vlerësimi i tërthortë:

(Teste me shkrim)

3.2. Vlerësimi bëhet:

- Me ndihmën e një tabele (vlerësimi objektiv)
- Pa tabelë (vlerësimi subjektiv)

3.3. Vlerësimi nga nxënësit (vlerësim i njëri tjetrit): në grupe nxënësish brenda klase, me ndihmën e një tabele. Ky është një vlerësim i drejtpërdrejtë.

3.4. Vetëvlerësimi i nxënësve: vlerësimi bëhet nga vetë nxënësit: secili nxënës vlerëson vetvetën.

4.0. KRITERET E VLERËSIMIT

4.1. Aktivitetet e të shprehurit:

- Të shprehurit gojor në vazhdimësi dhe të shprehurit gojor përmes ndërveprimit.
- Të shprehurit me shkrim:
 - Aktivitetet e receptimit (të kuptuarit gojor dhe të kuptuarit me shkrim)
 - Mjetet pedagogjike për vlerësimin e nxënësve:
- për një vlerësim të drejtpërdrejtë: një tabelë
- për një vlerësim të tërthortë: testet;
- për një vlerësim në të shprehur me gojë dhe me shkrim
 - tabela me kritere dhe me shpjegime për nxënës (tabela përpilohet nga vetë ata).

Notat	Të dëgjuarit	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit
5	x	x		
4			x	
3				x
2				
1				

Skedë për të drejtuar të mësuarit e nxënësit

	Shkalla e të përvetësuarit	Duhet të përmirësojë	Për të përmirësuar unë kam...
Dëgjoj	Mirë / përafërsisht		
Flas			
Lexoj			
Shkruaj			
Pjesëmarrja në aktivitete të klasës			
Mirëmbajtja e fletores			

HYRJA

Gjuha gjermane sipas planprogramit të ri mësohet për herë të parë në shkollën e mesme të ulët. Gjuha gjermane është njëra ndër gjuhët më të rëndësishme evropiane dhe përmes të kësaj gjuhe nxënësit do të marrin njohuri themelore për kulturën, gjuhën dhe letërsinë gjermane.

QËLLIMET

- të zhvillohen katër shkathtësitë gjuhësore,
- të aftësohen nxënësit të komunikojnë, brenda dhe jashtë shkollës, me njerëz që i përkasin kulturës dhe gjuhës gjermane,
- të aftësohen nxënësit të krahasojnë në mënyrë produktive kulturën gjermane me kulturën dhe traditën vetanake, si dhe të shfrytëzojnë këto pikëpamje të fituara për rrënimin e paragjykimëve dhe për zgjerimin e njohurive për botën dhe për vetën,
- të aftësohen nxënësit që të shfrytëzojnë strukturat dhe rregullsitë e gjuhës gjermane për përdorim më të vetëdijshëm të gjuhës amtare, që t'i zhvillojnë në mënyrë të pavarur më tutje aftësitë e fituara në gjuhën gjermane si dhe mbi këtë bazë të mësojnë gjuhë tjera të huaja.

	Viti i parë i mësimit të gjuhës gjermane
Objektivi 1	Krijimi i kontakteve të thjeshta gjuhësore
Objektivi 2	Emërtimi dhe përshkrimi i gjësedeve dhe veprimeve
Objektivi 3	Kuptimi i udhëzimeve dhe përgjigjja e pyetjeve
Objektivi 4	Orientimi në kohë dhe hapësirë
Objektivi 5	Krijimi i kontakteve gjuhësore
Objektivi 6	Dhënia dhe marrja e informatave gjuhësore

Plan-programi mund të lexohet edhe *horizontalisht*, pra prej të majtës në të djathtë .

	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9
Objektivi 1	Krijimi i kontakteve të thjeshta gjuhësore	Biseda me njëri tjetrin	Dhënia e informatave personale gjatë kontakteve gjuhësore	Raportimi mbi ngjarjet

Tek mënyra horizontale e të lexuarit vërehet një gjë: Objektivi 1. nga viti i parë zgjerohet më tutje në vitin e dytë, po ashtu në të tretin e pastaj edhe në të katërtin, sepse në secilin prej tyre kemi të bëjmë me “kontaktet gjuhësore”. Do të thotë se mbetet te tema e njëjtë, por në një nivel më të lartë e më të vështirë. Pra të gjitha objektivat me radhë përsëriten në vitin vijues, por me struktura gjithnjë e më të vështira dhe natyrisht me më shumë leksik (fjalës).

Shkathësitë gjuhësore, inventari gramatikor, fushat tematike

Përderisa me “shkathësi gjuhësore” janë dhënë mostra të fjalive, me “inventar gramatikor” janë dhënë fushat, të cilat përcillen me anë të objektivave specifike (shkathësitë gjuhësore).

Fjalësi(leksiku) në fjalitë mostra shërben si shembull dhe zgjerohet sistematikisht nga mësuesi.

Përmbajtja programore duhet të jetë e shkruar sipas rregullave më të reja të drejtshkrimit.

Pasi që nxënësit e kanë mësuar qysh moti alfabetin e gjuhës amtare, mospërputhja e pjesërishme e fonemave dhe grafemave në gjuhën shqipe e gjermane, nuk do të duhej të jetë ndonjë problem i madh.

Objektivat *gramatikore* të paraqitura në këtë plan-program janë të detyrueshme dhe duhet të shikohen si program minimal. E detyrueshme është edhe *radhitja e objektivave*, pasi që një objektivi ndërtohet mbi bazën e objektivit të mëparshëm.

Fushat tematike me qëllim janë të përgjithsuara, sepse siç u përmend më herët, sipas këtij plan-programi do të krijohen tekste shkollore. Sikur të caktoheshin qysh tash temat konkrete, në bazë të të cilave do të arriheshin objektivat specifike dhe gramatika, do të ishte kufizim për autorin e teksteve shkollore.

Këshillohet që temat të zgjedhen nga fushat që propozohen nga “Korniza programore për gjuhën gjermane si gjuhë e huaj” e Konferencës së Ministrisë Gjermane të Kulturës, e cila përsëri orientohet në Kornizën e Rekomanduar Europiane:

<ul style="list-style-type: none"> - Grundlegende Existenz Erfahrungen - Die persönliche Identität - Partnerbeziehungen - Alltag und Familie - Individuum und Gesellschaft - Wohnen - Erziehung - Arbeit - Versorgung - Gesundheitsfürsorge 	<ul style="list-style-type: none"> - Freizeitgestaltung - Sport - Mensch und Natur - Mobilität und Verkehr - Kommunikation - Wissenschaft und Technik - Kunst und Kreativität - Norm- und Wertorientierung - Zeitlich-historische Erfahrungen - Geistige und seelische Dimensionen
---	--

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

PASQYRË E OBJEKTIVAVE TË PËRGJITHSHME

1. LERNJAHR	
Lernziel 1	Lerninhalte
Einfache sprachliche Kontakte herstellen	Sprechfertigkeiten <i>Jemanden begrüßen</i> <ul style="list-style-type: none"> • Guten Tag! • Guten Morgen! • Guten Abend! • Hallo! <i>Sich verabschieden</i> <ul style="list-style-type: none"> • Auf Wiedersehen! • Gute Nacht! <i>Reagieren</i> <ul style="list-style-type: none"> • Ja, bitte. • Nein, danke. <i>Sich vorstellen</i> <ul style="list-style-type: none"> • Ich heiße ... • Mein Vorname ist ... • Mein Nachname ist ...

	<ul style="list-style-type: none"> • Dein Vorname ist ... • Dein Nachname ist ... • Ich wohne in ... • Ich bin Schüler. <p>Fragen</p> <ul style="list-style-type: none"> • wie heißt du? • wo wohnst du? • was bist du? <p>Grammatik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aussagesätze • Verben in der 1. und 2. Person Singular • Personalpronomen in der 1. und 2. Person Singular im Nominativ • Einfache Fragesätze • Sein als Vollverb in der 1. und 2. Person Singular
1. LERNJAHR	
Lernziel 2	Lerninhalte
<p>Gegenstände und Tätigkeiten benennen und beschreiben, nach Gegenständen fragen</p>	<p>Sprechfertigkeiten</p> <p>Fragen</p> <ul style="list-style-type: none"> • Was ist das? • Ist das ein/eine/ein ...? • Ist das dein/deine/dein ...? • Was machst du? <p>Benennen</p> <ul style="list-style-type: none"> • Das ist der/die/das ... • Das sind die ... • Das ist ein/eine/ein ... • Das sind ... <p>Beschreiben</p> <ul style="list-style-type: none"> • Der/Die/Das ... ist ... • Die ... sind ... • Das ist mein/meine/mein/... • Das ist dein/deine/dein ... • Ich lerne ... • Wir lernen ... <p>Verneinen</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nein. • Das ist kein/keine/kein ... • Das ist nicht mein/meine/mein ... • Das ist nicht dein/deine/dein ... <p>Grammatik</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Einfache Fragesätze • Bestimmter Artikel im Nominativ Singular und Plural • Unbestimmter Artikel im Nominativ Singular und Plural • Possessivpronomen in der 1. und 2. Person im Nominativ Singular • Nomen im Nominativ Singular und Plural • Adjektive in prädikativer Stellung • Sein als Vollverb in der 3. Person Singular und Plural • Verben in der 1. Person Singular und Plural • Personalpronomen in der 1. Person Plural • Negation mit nein • Negation mit kein/keine/kein • Negation mit nicht • Kardinalzahlen von 1 – 10
1. LERNJAHR	
Lernziel 3	Lerninhalte
Anweisungen verstehen und Fragen beantworten	<p>Sprechfertigkeiten <i>Anweisungen verstehen und danach handeln</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Schreibe ab. • Male aus. • Sprich laut. • Unterstreiche. • ... • Schreibt ab. • Malt aus. • Sprecht im Chor. • Unterstreicht. • ... <p>Fragen beantworten</p> <ul style="list-style-type: none"> • Er/Sie schreibt. • Er/Sie schreibt nicht. • Er/Sie malt aus. • Er/Sie malt nicht aus. • Sie schreiben. • Sie schreiben nicht. • Sie malen aus. • Sie malen nicht aus. <p>Grammatik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Imperativ mit nicht trennbaren und trennbaren Verben im Singular und Plural • Personalpronomen in der 3. Person Singular und Plural,

	maskulin/feminin im Nominativ • Verben in der 3. Person Singular und Plural • Negation mit nicht
1. LERNJAHR	
Lernziel 4	Lerninhalte
Sich orientieren und verständigen	Sprechfertigkeiten <i>Räumliche Angaben erfragen und geben</i> <ul style="list-style-type: none"> • Wo ist/bist/sind/seid ...? • Dort/hier/Oben/Unten. • Er/Sie ist ... • Wir sind ... • Ihr seid ... • Sie sind ... <i>Zeitliche Angaben erfragen und geben</i> <ul style="list-style-type: none"> • Wann haben wir Deutschunterricht? • Am ... • Heute. • Morgen. Grammatik <ul style="list-style-type: none"> • Fragen mit wo • Fragen mit wann • sein als Vollverb in allen Personen • Personalpronomen in allen Personen • haben als Vollverb in der 1. Person Plural • Adverbiale des Ortes und der Zeit • Kardinalzahlen von 11 – 12
1. LERNJAHR	
Lernziel 5	Lerninhalte
Sprachliche Kontakte knüpfen	Sprechfertigkeiten <i>Auffordern und Aufforderungen beantworten</i> <ul style="list-style-type: none"> • Machst du mit?/Macht ihr mit? • Ich kann/Wir können leider nicht. • Tut mir/uns leid, ich muss/wir müssen die Hausaufgaben machen. • Willst du/Wollt ihr mitkommen? • Ja, gerne. • Spielst du/Spielt ihr gern ...? • Ja/Nein. • Nicht so besonders. • Eigentlich nicht. • Ja, natürlich!

	<p>Fragen stellen und Fragen beantworten</p> <ul style="list-style-type: none"> • Was machst du/Was macht ihr? • Darf ich/Dürfen wir mitkommen? • Ich möchte/Wir möchten auch gerne mitkommen. • Komm, wir gehen/Wir wollen gehen. • Gehen wir? • Kannst du/Könnt ihr schwimmen? • Kannst du/Könnt ihr Fußball spielen? • Na klar! • Toll! • Nein, zeigst du/zeigt ihr es mir? <p>Erklären</p> <ul style="list-style-type: none"> • Jetzt musst/kannst/darfst du ... • Jetzt müsst/könnt/dürft ihr ... <p>Grammatik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Frage- und Aussagesätze mit Modalverben • Modalverben <i>mögen, können, dürfen, wollen, müssen</i> in der 1. und 2. Person Singular und Plural • Adverbiale der Art und Weise
1. LERNJAHR	
Lernziel 6	Lerninhalte
Einfache Auskünfte einholen und erteilen	<p>Sprechfertigkeiten</p> <p>Fragen nach dem Befinden stellen und beantworten</p> <ul style="list-style-type: none"> • Wie geht es dir/Ihnen? <ul style="list-style-type: none"> - Danke, gut. - Nicht gut/Schlecht/Es geht. • Was fehlt dir/Ihnen? <ul style="list-style-type: none"> - Mein Hals tut weh/Ich habe Halsschmerzen. • Bist du/Sind Sie krank? <ul style="list-style-type: none"> - Ja/Nein. <p>Vorhaben angeben</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ich möchte spielen/nicht spielen. • Er/Sie besucht den/die/das ... • Er/Sie braucht einen/eine/ein ... • Er/Sie hat/möchte/braucht keinen/kein/kein ... • Ich gehe in den Park/in die Schule/ins Geschäft. <p>Zeitangaben</p> <ul style="list-style-type: none"> • Wie spät ist es? • Es ist ... (nur volle Stunden!) <p>Grammatik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nomen im Akkusativ mit bestimmtem und unbestimmtem Artikel

	<ul style="list-style-type: none"> • Fragesätze mit wie • Modalverben in allen Personen • Präposition in mit Akkusativ • Kardinalzahlen von 13 – 31
--	---

Realizimi i objektivave të sipërhënuara bëhet përmes këtyre temave:

Pasqyrë e fushave tematike

KLASA E GJASHTË
1. Grundlegende Existenz Erfahrungen <ul style="list-style-type: none"> • Dasein in der Welt • Elementare Gefühle: Liebe zu den Eltern und Geschwistern
2. Die persönliche Identität <ul style="list-style-type: none"> • “Ich” – Erfahrung • Einige persönliche Eigenschaften
3. Partnerbeziehungen <ul style="list-style-type: none"> • “Du” – Erfahrung • einige Eigenschaften des anderen • mit Freunden spielen • Erlebnisse mit Freunden
4. Alltag und Familie <ul style="list-style-type: none"> • “Wir” – Erfahrung • die private Gemeinschaft der Familie: Eltern, Geschwister • Der Alltag einer Familie
5. Individuum und Gesellschaft <ul style="list-style-type: none"> • “Sie” – Erfahrung • Nachbarschaft • Erlebnisse in der Schule
6. Wohnen <ul style="list-style-type: none"> • Das eigene Heim • Haus, Wohnung, Siedlung • Kinderzimmer, Gemeinschaftszimmer • Die Schule als Lebensbereich
7. Erziehung <ul style="list-style-type: none"> • In der Familie • In der Schule (z.B. Stundenplan, Hausaufgaben, u.a.) • Vorbilder • Verkehrserziehung
8. Arbeit <ul style="list-style-type: none"> • Beruf der Mutter/des Vaters

9. Versorgung <ul style="list-style-type: none"> • Nahrung, typische Speisen
10. Gesundheitsfürsorge <ul style="list-style-type: none"> • Hygiene • Im Badezimmer • Zähneputzen, usw. • Zahnarzt
11. Freizeitgestaltung (der Kinder) <ul style="list-style-type: none"> • Hobbys • Lesegewohnheiten • Haustiere halten
12. Kommunikation <ul style="list-style-type: none"> • Das Telefon nutzen • Fernsehen
13. Kunst und Kreativität <ul style="list-style-type: none"> • Lieder singen • Bilder malen • Etwas selbst schreiben, lesen, malen, gestalten • Einfache Gedichte kennen lernen
14. Zeitlich-historische Erfahrung <ul style="list-style-type: none"> • Uhrzeiten • Tageszeiten • Jahreszeiten • Persönliche Vergangenheit-Gegenwart

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Forma komunikative e mësimdhënies

Në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme, kjo do të thotë: Cilat mjete gjuhësore ju duhen nxënësve që në situata të caktuara gjuhësore të shprehin dhe të sillen në mënyrë të duhur?

Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja për një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregullë gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo e kundërta

Metodat e mësimdhënies

Metodat që nxisin komunikimin

- Puna në grupe, në çifte
- Debatet, debat në podium
- Lojrat në role
- Intervistat

Metodat që nxisin punën e pavarur

- Stacione(materiali i përgatitur me detyra të shtruara në mënyra të ndryshme lihet në vende të caktuara, ashtu që nxënset/ sit në një rrugë të zgjedhur vet i mbledhin dhe përpunojnë ato pa ndihmen e mësuesit)
- Lojra mësimi (si Memori, Bingo)
- Kontrollimi i partnerit
- Përpunimi i pavarur i temave (mbledhja e informatave në bibliotekë, kompjuter etj; përpunimi i pavarur i informatave rreth një ligjerate, referati, ditari pune, kollazheve etj; përcjellja e mëtutjeshme e informatave tek grupi)
- Nxënia gjatë mësimdhënies(nxënësi merr rolin e mësuesit)
- Mbledhja e materialeve dhe burimeve
- Letërkëmbime me Gjermaninë(partnerizimi i shkollave, letërkëmbime mes nxënësve, etj)

Metodat që nxisin prodhimin

- Punimi i gazetave të murit , pikturave, posterëve, kollazheve, teksteve (p.sh. për ekspozita, gara të shkollës apo interne, etj.)
- Shkrimi kreativ (i poezive, eseve, tregimeve, skenarëve për teatër) i nxitur përmes aktivizimit të njohurive paraprake (me asociograme, clustering, Brainstorming etj.)

Përdorimi i mediave

Fotografitë

Ndihmojnë në prodhimin (shkruarjen) e teksteve kreative përshkruese dhe komentuese.

- Nxënësit përshkruajnë gjërat e njohura dhe ato të pazakonshme që shohin në fotografi dhe tregojnë si ndikon në ta ajo që shohin në foto;

- Ata tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e përshkruan fotografia

Videoprojektori

Prezentimi i materialeve (fotografive, vizatimeve, tregimeve të ilustruara, etj) dhe teksteve përmes folieve dhe projektorit, rrit interesimin e nxënësve për mësim

- Prezentimi i fotografive të veçanta ose të një sërë fotografish
- Mbulimi dhe zbulimi i pjesërishëm i fotografisë
- Një ngjarje e paraqitur me fotografi jepet me foto të radhitura gabimisht
- Pararaqitja e një teksti të ndarë në pjesë dhe të radhitur në mënyrë jo të rregullt dhe rregullimi i tij

Materiali auditiv

Ky material mundëson ballafaqimin me variantet gjuhësore individuale dhe regionale të gjermanishtes dhe nxit të kuptuarit përmes dëgjimit.

- Nxënësit gjejnë fillimin ose mbarimin e një teksti të shkurtër të dëgjuar më parë
- Ata karakterizojnë personat e një pjese teatrore të dëgjuar dhe diskutojnë për sjelljet e tyre.

Videomateriali

Përdorimi i videomaterialit u jep nxënësve mundësi të shumta për krijimin e teksteve me shkrim dhe me gojë:

- Paraqitja e një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose një përralle, i cili nxit krahasimin me tregim a përrallen e lexuar ose dëgjuar më parë.
- Puna me video sekuenca mund të bëhet në tri faza:
 - paraqitja e materialit filmik pa zë, ku nxënësit identifikojnë vendet dhe personat e njohur, përshkruajnë personat, vendet, veprimet ose gjësendet etj.
 - paraqitja e materialit filmik pa fotografi ku nxënësit diskutojnë mbi objektet dhe aktivitetet e ndryshme, shënojnë informacione nga ajo që dëgjojnë (numrat, emrat e vendeve, të personave, të dhënave kohore), emërtojnë temat, vizatojnë një pikturë.

- paraqitja e materialit filmik me zë dhe fotografi më që rast bëhet krahasimi në mes të supozimit të mëhershëm dhe sekuencës që shihet dhe dëgjohet.

Objektivat

Përcaktimi i qartë i objektivave, është lehtësim për punën e mësuesit dhe e ndihmon atë vet në përcaktimin e objektivave më specifike. Kur të arrihet objektivi - kjo do të thotë se nxënësit e zotërojnë materien e përpunuar - atëherë mesimdhësi do të duhej të jetë i kënaqur me këtë. Nëse ende nuk ka përfunduar ora mësimore nuk ka logjikë që të futen edhe përmbajtje të tjera në orë. Në këtë rast më e logjikshme do të ishte që të përforcohet ajo që është mësuar me anë të ushtrimeve të llojllojshme, të përpunohet një këngë gjatë orës së mësimit ose të futet ndonjë lojë mësimore më qëllim të arritjes së objektivit.

Kufizimi i objektivave

Duke i njohur nxënësit dhe duke i pasur të qarta objektivat e përcaktuara më parë mësuesi nuk do të duhej të bëjë gabim e të përcaktojë shumë objektiva për një orë mësimi e të habitet pastaj pse nuk është arritur objektivi. Për këtë arsye mësuesi duhet të caktojë një objektiv specifik, të cilin tenton ta arrijë brenda një ore mësimi. Përcaktimi i shumë objektivave për një orë ka për pasojë këtë:

Mbetet pak kohë për ushtrime dhe zbatim, për këtë arsye nxënëset/sit nuk mund ta bëjnë zotërimin e mjaftueshëm të materies. Në orën e ardhshme duhet të përsëritet dhe sqarohet materia edhe një herë, sepse mund të ndodhë që të jenë përvjedhur gabime, të cilat pastaj me mund mund të korrigjohen, arsye kjo për t'u dëshpruar arsimtari dhe nxënësi.

Llogaria është e thjeshtë: një orë e stërngarkuar dhe një orë për përsëritje bëjnë dy. Në këtë rast do të ishte më e logjikshme që materia qysh nga fillimi të ndahet në dy orë.

Sipas hulumtimeve nxënëset/sit mesatarë janë në gjendje që për një orë mësimi të mbajnë mend rreth dhjetë shprehje të reja. Ky fakt nuk duhet të lihet anash.

Radhitja: të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit

Posaçërisht në mësimin fillestar do të duhej të ruhet radha e katër shkathtësive, që d.m.th.:

- Nxënësit nuk do të duhej të flasin asgjë që nuk e kanë dëgjuar më parë,
- Ata nuk do të duhej të lexojnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar dhe folur më parë,
- Ata nuk do të duhej të shkruajnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar, folur dhe lexuar më parë.

Për t'iu përmbajtur kësaj radhitjeje posaçërisht te fillestarët, flet kjo arsye:

Nëse do të mësohet një fjalë, logjikisht ajo do të duhej të dëgjohej më parë. Në anën tjetër leximi i një fjale të re është më i lehtë kur ajo më parë është dëgjuar ose folur. Edhe të shkruarit do të duhej të ishte më i lehtë, kur ajo fjalë është dëgjuar, folur apo lexuar më parë.

Puna aktive dhe konkrete

Një dallim në mes të mësimin të gjuhës gjermane në Gjermani- pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjermanishten si gjuhë amtare ose për gjermanishten si gjuhë e dytë ose e huaj- dhe në Kosovë është ndër tjera se mjedisi-kosovar mund të japë pak ose aspak informacione për RFGJ-në dhe përveç orës së mësimin pothuajse nuk ekziston ndonjë mundësi për t'u zbatuar ajo që është mësuar. Kështu që bie mundësia që ajo që është mësuar në shkollë të thellohet jashtë orëve të mësimin si përmes ekskursioneve, zhvillimit të intervistave etj. Në këtë kontekst nuk duhet mbiçmuar apo nënçmuar televisionin.

Prodhimi(krijimi) i pllakatave, mozaiqeve dhe posterëve, prodhimi i punëdoreve të vogla janë gjithashtu të rëndësishme.

Një arsye tjetër për aktivitete të këtilla, janë njohuritë nga psikologjia e të mësuarit: sipas saj rezultati (arritja) është më i madh, sa më shumë që të mbështeten veprimet gjuhësore nga veprimet konkrete.

Kohë e mjaftushme për ushtrime dhe zbatim

Për nxënien dhe zotërimin e sigurtë të një gjuhë nevojiten në përgjithësi tri gjëra: kohë, kohë dhe prapë kohë.

Ne e dimë se ekzistojnë 3 tipa të ndryshëm të nxënësve:

Tipat akustik (ata e nxënë- mësojnë gjuhën më shpejt përmes dëgjimit - veshit);

Tipat vizuel- (pamor) (ata e nxënë gjuhën në radhë të parë përmes syrit);

Tipat motorik (ata nxënë gjuhën më se shpejti përmes të shkruarit).

Për këtë arsye është e rëndësishme, që ushtrimi të zgjedhet gjithashtu edhe përmes këtij këndvështrimi; që gjuha të mësohet njëkohësisht përmes kanaleve të shumta, pasi që te shumica e atyre që mësojnë gjuhën bëhet fjalë për tipa të ashtuquajtur të përzier.

Lllojshmëria në fazat e ushtrimeve

Secili mësues dhe mësuese e di saktësisht se në orën e gjuhës, të ushtruarit monoton të strukturës së fjalisë ndikon më parë në të kundërtën e asaj që është synuar.

Nxënësit dhe nxënset do ta humbin interesimin për mësim dhe nuk do të marrin pjesë aktivisht në të. Në anën tjetër ne e dimë se motivimi i synuar dhe dhënia e detyrave interesante mund ta ngrisin në mënyrë të ndjeshme dëshirën për mësim dhe gatishmërinë për punë (rezultate).

Si rezultat mund të jetë jo vetëm ndërrimi i formave të punës (puna e veçantë, puna në çifte ose në grupe), por posaçërisht edhe lojrat në mësim, këngët dhe poezitë si dhe tregimet do bëhen pjesë përbërse e mësimit.

Korrigjimi i shprehjeve të nxënësve

Pothuajse asnjë çështje nuk diskutohet aq shpesh dhe në mënyrë kundërtënëse në rrethin e mësimit se sa mënyra e korrigjimit.

Derisa korrigjimin disa e vështrojnë si pengesë të rrjedhjes gjuhësore, të tjerët mbështeten në atë se gabimet duhet korrigjohen menjëherë që të mos përvidhen..

Ndoshta mund të bëhet një kompromis i arsyshëm gjatë korrigjimit dhe ai do të dukej kështu:

Në fazën e kontaktit gjuhësor, si për shembull: gjatë përshkrimit të një fotografie, mësueset dhe mësuesit presin një të shprehur të lirë të nxënësve të tyre.

Po të bëjnë korrigjimin masiv gjatë kësaj faze të mësimit, nxënësit ndoshta do të tërhiqeshin menjëherë dhe në fund do të heshtin plotësisht.

Në këtë fazë është e drejtë që korrigjimet ndër të tjera të parashtrihen në atë mënyrë, për shembull, një fjalë e thënë gabimisht të përsëritet nga mësuesi edhe një herë, por natyrisht në mënyrë të drejtë. Nuk duhet të bëhet kurrfarë diskutimi: që do t'i turpëronte nxënësit në këtë rast para klasës, por të tregohet takt pedagogjik.

Diferencimi

Asnjë klasë nuk ka përbërje të njëtrajtshme. Këtë duhet ta ketë parasysh çdo mësuesi dhe të organizojë orën në bazë të kësaj. Kjo nënkupton që nxënësit, të cilët kanë aftësi të ndryshme të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët në mënyrë që mësimi i gjuhës të jetë përafërsisht i njëjtë për të gjithë.

Teknikat e punës

Një ndër detyrat e mësimit në gjuhën e huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të marrin përgjegjësinë për të mësuarit e vet. Nxënësit, të cilët janë mësuar që t'i reflektojnë proceset e tyre të mësuarit dhe që të organizojnë në grup procesin e mësimit dhe procesin e të mësuarit, zakonisht mësojnë me sukses dhe në mënyrë efektive. Në këtë mënyrë ata, përveç tjerash, mund të përgatiten që të reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat jashtëshkollore si dhe të vazhdojnë proceset e mësimit të gjuhës.

LIDHJA NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Duke pasur parasysh udhëzimet nga MASHT-i jemi kujdesur që zgjedhja e temave (më të përgjithësuara-orientuese, sepse temat specifike i zgjedhin hartuesit e librave shkollor) të bëhet ashtu që të ketë ndërlidhje programore.

Lidhja do të jetë me tri fusha kryesore:

Shkencat natyrore

Shkencat shoqërore

Artet

Me shkencat shoqërore do të jenë të lidhura kryesisht me: Edukatën qytetare, Historinë etj. gjatë trajtimit të temave si:

1. E kaluara dhe e tashmja
2. Tradita dhe religjioni
3. Skena dhe kultura rinore
4. Përditshmëria dhe familja
5. Bota e të rinjve dhe të rriturve
6. Shkolla dhe shkollimi
7. Individit dhe shoqëria
8. Jeta politike dhe çështja sociale
9. E drejta dhe drejtësia

Lidhja me shkencat natyrore do të jetë si:

1. Gjeografia
2. Biologjia
3. Matematika
4. Teknologjia

Dhe atë gjatë trajtimit të temave si:

1. Natyra dhe ambienti
2. Teknika dhe zhvillimi
3. Koha
4. Bota fantastike
5. Kultura dhe shkenca
6. Ekonomia dhe tregu i punës

Pasi që ora e mësimit do të bëhet kryesisht përmes komunikimit, lojës, këngës e mënyrave tjera kreative, atëherë lidhja me artet e sportin do të bëhet kryesisht gjatë zhvillimit të orës së mësimit dhe trajtimit të temave.

Gjatë punimit të plan-programit për gjuhë gjermane është menduar mjaft edhe për barazinë gjinore dhe personat me nevoja të veçanta. Tërë kohën thuhet “ajo/ai” ose “ata/ato”. Gjatë hartimit të librave do të definohen edhe gjërat tjera si personazhet do të jenë edhe femra të barabarta me meshkuj (nëna shkon në punë, vajzat bëjnë atë që bëjnë djemtë), ka fëmijë të racave të ndryshme etj.

VLERËSIMI

Janë tri aftësi që kontrollohen (vlerësohen):

1. Riprodhimi(reprodukimi) - nënkupton riprodhimin nga nxënësi e asaj që është mësuar më parë.

2. Riorganizimi- nënkupton bartjen e të mësuarës në situata të ngjashme(p.sh. nëse nxënësit i mësohet vendi i foljes në fjali të varur, duhet të jetë i aftë të aplikojë foljen në fjali të varur).
3. Transferi- nënkupton bartjen e të së mësuarës në situata plotësisht të reja.

Teknikat e të vlerësuarit

Teknikat e poshtëshënuara vlejné për mëyrën e vlerësimit me shkrim, pasiqë mendohet se kjo është mënyra më objektive dhe më e zbatuar në shkolla:

Përgjigjet seleksionuese

1. Përgjigjet alternative

Shembull:

Prishtinë ist die Hauptstadt von Kosova.	richtig <input type="radio"/>
	falsch <input type="radio"/>

2. Përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes

Shembull:

Kreuze die richtige Lösung an.

Das Auto steht	<input type="radio"/> unter der Straße.
	<input type="radio"/> über der Straße.
	<input type="radio"/> in der Straße.
	<input type="radio"/> auf der Straße.

Përgjegjet rregulluese

1. Përgjigjet kategorizuese

Shembull:

Ordne zu.

1. Peter	a) Griechenland
2. Armend	b) Deutschland
3. Giuseppe	c) Spanien
	d) Kosova
	e) Türkei
	f) Italien

2. Përgjigjet radhitëse

Shembull:

Schreibe die richtige Reihenfolge auf.

1. Es ist acht Uhr.
2. Liridon geht bei Rot über die Kreuzung.
3. Der Wecker klingelt.
4. Liridon kommt zu spät zur Schule.
5. Liridon hat verschlafen.
6. Der Autofahrer bremst scharf.
7. Er springt aus dem Bett.
8. Der Fahrer schimpft Lukas.
9. Er läuft schnell weiter.

Përgjigjet e lira

1. Përgjigjet plotësuese

Shembuj:

Viele Dinge sind schneller, schöner usw. als andere. Setze die richtige Form ein.

(langsam)	Ein Fahrrad ist ... als ein Auto.
(schwer)	Fünf Kilo sind ... als ein Kilo.
(teuer)	Fleisch ist ... als Brot.

Trage das Gegenteil in die Lücke ein.

Dieses Buch ist spannend. Es ist nicht ...
Anna ist groß. Sie ist nicht...
Emira ist ein Mädchen. Sie ist kein ...

Setze die richtige Zeit in die Lücke ein.

Heute Nachmittag ... (gehen) ich auf den Spielplatz.
Morgen ... (spielen) ich Tennis.
Gestern ... (sein) ich im Kino.

2. Përgjigjet e shkurtëra hartuese

Shembull:

Bilde aus den folgenden zwei Sätzen einen Satz.

Andreas weint. Eine Wespe hat ihn gestochen.
--

Librat mësimore, të cilat i preferojmë për klasën e gjashtë, derisa nuk botohen libra të bazuara në këtë plan-program janë:

- **B. Weisgerber, H. Böhm, R. Urbanek:** “*Hallo, Peter - wir lernen Deutsch I*”, Dürr + Kessler Verlag, 1998, Köln ose
- **S. Büttner, G. Kopp, J. Alberti:** “*Tamburin I*”, Hueber Verlag, 2002, Ismaning

Po ashtu preferohet edhe libra tjera shkollore që përdoren për mësimin e gjuhës gjermane për të huaj:

Libri i punës
Libri i ushtrimeve
Kaseta dhe CD

HYRJE

Matematika për klasën e gjashtë është vazhdimësi, rimarrje aktive dhe zgjerim i njohurive paraprake. Mësimi i matematikës u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri e shkathtësi për të kuptuarit e botës fizike dhe asaj shoqërore. Nëpërmjet matematikës nxënësit aftësohen të analizojnë, të përshkruajnë dhe sqarojnë, të parashtrajnë hipoteza dhe të zgjidhin probleme.

Krahas lëndëve tjera, mësimi i matematikës synon në:

- zhvillimin e personalitetit të nxënësit;
- edukimin e shprehive për punë të pavarur e sistematike;
- kultivimin e aftësive e shkathtësive për të menduar në mënyrë krijuese e kritike;
- nxitjen e kureshtjes dhe inkurajimin e nxënësit për kërkim dhe përzgjedhje të informacionit të nevojshëm;
- zotërimin e dijeve të reja që përfshihen në program me qëllim që t'i zbatojnë ato në zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme dhe në lëndët tjera shkollore.

Në veçanti, nëpërmjet gjuhës karakteristike-simboleve e diagrameve, matematika synon t'i kultivojë aftësitë për t'u shprehur sakt, për të organizuar e përmbledhur mendimet dhe për të komunikuar në përgjithësi.

Zbatimi, përherë e më shumë i matematikës së sofistikuar në fusha të gjëra të ekonomisë, teknologjisë e shkencës, e rritë rëndësinë e ndikimit të thellë të saj në zhvillimin e një shoqërie bashkëkohore.

QËLLIMET

Plani dhe programi mësimor i lëndës së matematikës për klasën e VI ka për qëllim:

- zhvillimin e një qëndrimi pozitiv te nxënësit ndaj matematikës dhe rëndësisë së saj;
- formimin e shprehive dhe shkathtësive të nxënësit për të kuptuar drejt konceptet matematikore dhe për të vepruar sipas tyre;
- zhvillimin e aftësive të nxënësit për të komunikuar sakt dhe në mënyrë efektive me gjuhën dhe simbolet e matematikës;
- krijimin e shprehive dhe shkathtësive për punë të pavarur dhe të përbashkët;
- përvetësimin e strategjive për zgjidhjen e problemeve matematikore dhe zbatimin e njohurive në jetën e përditshme.

KATEGORITË E PËRMBAJTJES: 1. ARITMETIKA DHE ALGJEBRA (80 orë) 2. GJEOMETRIA DHE MATJET (54 orë) 3. STATISTIKA DHE PROBABILITETI (14 orë)				
Nr	Nënkategoritë	Përmbajtja	Objektivat e përgjithshme Nxënësit:	Objektivat specifike Nxënësit duhet:
1. ARITMETIKA DHE ALGJEBRA (80 orë)				
	BASHKËSITË DHE RELACIONET	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkësia, elementi • Veprimet me bashkësi dhe paraqitja e tyre me diagramin e Ven-it • Kuptimi i dyshes së renditur • Funksioni si lidhje e dy bashkësive • Paraqitja e pasqyrimit me diagram shigjetor, me tabelë dhe në rrjetin koordinativ 	<ul style="list-style-type: none"> • të zgjerojnë njohuritë mbi bashkësitë dhe veprimet me to • të njohin kuptimin e relacionit si marrëdhënie ndërmjet elementeve të një bashkësie ose elementeve të bashkësive të ndryshme • të kuptojnë pasqyrimin si lidhje e dy bashkësive. 	<ul style="list-style-type: none"> • të emërtojnë bashkësinë dhe elementet e saj • të paraqesin bashkësitë dhe marrëdhëniet në mes tyre me diagrame gjegjëse • të kryejnë veprimet me bashkësi (unionin, prerjen, diferencën dhe përfshirjen) • të përshkruajnë marrëdhëniet e një objekti ndaj objekteve tjera • të paraqesin prodhimin e drejtpërdrejtë të bashkësive, si bashkësi e dysheve të renditura • të lidhin njohuritë për relacionet me shembuj <ul style="list-style-type: none"> • praktikë nga jeta e tyre • të paraqesin pasqyrimin (funksionin) si lidhje e dy bashkësive me diagrame, tabela dhe si bashkësi e dysheve të renditura • të paraqesin dyshtet e renditura në rrjetin koordinativ.

	<p>NUMRAT NATYRORË, THYESORË, DHJETORË dhe VEPRIMET ME TA</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Leximi dhe shkrimi deri në klasën e miliardëve • Krahasimi i dy numrave natyrorë • Mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave natyrorë • Plotpjesëtueshmëria • SHMVP dhe PMMP i numrave natyrorë • Rendi i veprimeve aritmetike • Kuptimi i thyesës. Thyesat e barabarta • Numrat e përzier • Thjeshtimi dhe zgjerimi i thyesave • Krahasimi i thyesave • Veprimet me thyesa • Kuptimi i numrit dhjetor • Leximi i numrit dhjetor • Krahasimi i numrave dhjetorë • Rrumbullakësimi • Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë 	<ul style="list-style-type: none"> • të kuptojnë lidhshmërinë dhe dallimet ndërmjet numrave natyrorë, thyesorë dhe dhjetorë, • të përvetësojnë veprimet themelore me numra • të zbatojnë njohuritë për numrat në situata të jetës së përditshme 	<ul style="list-style-type: none"> • të lexojnë dhe të shkruajnë numrat natyrorë, thyesorë dhe dhjetorë • të krahasojnë numrat natyrorë, thyesorë dhe dhjetorë • të identifikojnë vendvlerën e shifrës, • të gjejnë shumëfishat dhe plotpjesëtuesit e numrave natyrorë (përkatësisht ShMVP dhe PMMP) • të dallojnë numrat tek, numrat çift dhe numrat e thjeshtë natyrorë, • të shprehin numrat natyrorë si prodhim i faktorëve të thjeshtë, • të rrumbullakësojnë numrat natyrorë dhe numrat dhjetorë (p.sh. numrat natyrorë në qindëshen më të afërt, numrat dhjetorë në të qindëta), • t'i shndërrojnë numrat thyesorë në numra dhjetorë dhe anasjelltas, • ta llogarisin shumën, ndryshimin, prodhimin, herësin e këtyre numrave (me mend, me dorë si dhe në raste të veçanta me kalkulatorë), • t'i paraqesin numrat në boshtin numerik, • të zgjidhin probleme me fjalë nga jeta e përditshme
--	--	---	--	--

	SHPREHJET SHKRONJORE	<ul style="list-style-type: none"> • Shprehjet me shkronja • Njehsimi i vlerës së shprehjes për vlerën e caktuar të ndryshores • Ekuacione dhe inekuacione të thjeshta 	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojnë shprehjen shkronjore si makinë që prodhon numra. • të kuptojnë shkronjën si vendmbajtëse e numrave (ndryshore) dhe e numrit si konstant • të përvetësojnë zgjidhjen e ekuacioneve dhe inekuacioneve të thjeshta lineare • të kuptojnë rëndësinë e ekuacioneve në zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • ta gjejnë vlerën e shprehjes shkronjore për vlerën e caktuar të shkronjës • t'i paraqesin këto vlera me anë të tabelave dhe diagrameve. • T'i lidhin problemet me fjalë (me shprehje shkronjore) dhe t'i zgjidhin ato • të zgjidhin ekuacione dhe inekuacione të thjeshta lineare • t'i paraqesin zgjidhjet e inekuacioneve në boshtin numerik • ta përkthejnë gjuhën e zakonshme të problemeve në gjuhën e matematikës dhe t'i zgjidhin ato probleme.
2. GJEOMETRIA DHE MATJET (54 orë)				
	PIKA, DREJTËZA DHE RRAFSHI	<ul style="list-style-type: none"> • kuptimet themelore gjeometrike-pika, drejtëza dhe rrafshi • Gjatësia (kuptimi, matja dhe vizatimi i segmenteve) • Drejtëzat normale dhe paralele (vizatimi i tyre) • Largësia e drejtëzave paralele 	<ul style="list-style-type: none"> • t'i kuptojnë drejt nocionet themelore gjeometrike • t'i përshkruajnë vijat dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre • t'i përvetësojnë njësitë matëse të gjatësisë dhe të bëjnë matje në natyrë 	<ul style="list-style-type: none"> • të identifikojnë marrëdhëniet ndërmjet pikës dhe drejtëzës, dy drejtëzave dhe drejtëzës e rrafshit • të vizatojnë drejtëza paralele dhe normale • të lidhin kuptimet: largësia ndërmjet pikave dhe gjatësia e segmentit • të përcaktojnë largësinë e pikës nga drejtëza dhe largësinë ndërmjet dy drejtëzave • të paraqesin gjatësinë e segmentit me njësi matëse të ndryshme

	KËNDET	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi i këndit si hapje dhe rrotullim • Llojet e këndeve • Vizatimi i këndeve me masë të dhënë në gradë • Matja e këndeve me këndmatës • Shuma dhe ndryshimi i masave të këndeve 	<ul style="list-style-type: none"> • ta përvetësojnë kuptimin e këndit dhe madhësisë së këndit • t'i përdorin veglat gjeometrike për matjen dhe krahasimin e këndeve 	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë këndin si hapje dhe rrotullim • të vizatojnë dhe të krahasojnë kënde sipas madhësisë • të përdorin këndmatësin për matjen e këndeve • të konstruktojnë këndin e drejtë, të shtrirë dhe të plotë
	FIGURAT GJEOMETRIKE	<ul style="list-style-type: none"> • Vija e thyer (përkufizimi i shumëkëndëshit) • Perimetri i shumëkëndëshave • Paralelogramet, drejtkëndëshi, katrori, rombi, romboidi, trapezi • Drejtëza e simetrisë • Syprina e sipërfaqes katrore dhe drejtkëndëshe 	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë llojet dhe vetitë e figurave gjeometrike • të njihen me kuptimet sipërfaqe dhe syprinë • të njihen me figurat simetrikoboshtore • të masin dhe njehsojnë syprinën e sipërfaqeve me anë të katrorëve dhe njësisive matëse • të kuptojnë rëndësinë e zbatimit të njohurive nga gjeometria në situatat e jetës reale 	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë dhe të emërtojnë paralelogramet • të vizatojnë dhe konstruktojnë paralelogramet dhe shumëkëndëshat e rregullt • të klasifikojnë paralelogramet sipas vetive • të identifikojnë drejtëzën e simetrisë në figurat gjeometrike dhe t'i dallojnë ato në mjedisin ku jetojnë • të njehsojnë perimetrin dhe syprinën e sipërfaqes drejtkëndëshe e katrore me anë të formulave • të zbatojnë formulat për gjetjen e perimetrit dhe syprinës në zgjidhjen e problemeve praktike

	RRETHI DHE SIPËRFAQJA RRETHORE	<ul style="list-style-type: none"> • Rrethi dhe sipërfaqja rrethore 	<ul style="list-style-type: none"> • të njihen me kuptimet e rrethit dhe sipërfaqes rrethore 	<ul style="list-style-type: none"> • të identifikojnë marrëdhëniet ndërmjet pikës, drejtëzës dhe rrethit • të vizatojnë rrethin kur dihet rrezja e tij • të emërtojnë sektorin rrethor, segmentin rrethor dhe sipërfaqen rrethore
	TRUPAT GJEOMETRIKË	<ul style="list-style-type: none"> • Kubi • Kuboidi • Hapja dhe ndërtimi i kubit dhe kuboidit • Kuptimi i vëllimit të trupit • Njësitë për matjen e vëllimit • Vëllimi i kuboidit dhe kubit 	<ul style="list-style-type: none"> • të dallojnë format e ndryshme të trupave gjeometrikë • të përvetësojnë kuptimin e vëllimit të trupave gjeometrikë • të kuptojnë rëndësinë e matjes së vëllimit të trupave gjeometrikë në situatat e jetës reale 	<ul style="list-style-type: none"> • të dallojnë trupat gjeometrikë sipas brinjëve, kulmeve dhe faqeve • të ndërtojnë modelet e kubit dhe kuboidit • të njehsojnë syprinën e sipërfaqes së kubit dhe kuboidit • të njehsojnë vëllimin e kubit dhe kuboidit • të shndërrojnë njësitë kubike të rendeve më të larta në njësi të rendeve më të ulëta dhe anasjelltas • të zbatojnë formulat për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme
3. STATISTIKA DHE PROBABILITETI (14 orë)				
	TË DHËNAT STATISTIKORE	<ul style="list-style-type: none"> • Grumbullimi i të dhënave dhe paraqitja grafike e tyre • Vlerat mesatare • Leximi i të dhënave nga diagramet 	<ul style="list-style-type: none"> • të zhvillojnë planet e përpunimit të të dhënave • të shfrytëzojnë përpunimin e të dhënave në zgjidhjen e problemeve 	<ul style="list-style-type: none"> • të mbledhin dhe të klasifikojnë të dhënat • t'i organizojnë dhe t'i paraqesin të dhënat me tabela dhe në formë të diagramit me shtylla • të lexojnë të dhënat nga diagramet • të zgjidhin probleme të ndryshme statistikore

REZULTATET E PRITURA

Nxënësit duhet:

- të kryejnë veprimet me bashkësi dhe të përdorin diagramet e Venn-it për paraqitjen e tyre;
- të përvetësojnë numrat natyrorë deri në një milion dhe të kryejnë pa vështirësi veprimet themelore llogaritëse me ta;
- të gjejnë shumëfishat dhe plotpjesëtuesit e numrave natyrorë;
- të njohin thyesat dhe shënimin dhjetor të thyesave (numrat dhjetorë) dhe të kryejnë veprimet me to
- të kuptojnë pasqyrimin si lidhje e dy bashkësive dhe të paraqesin atë me diagrame, tabela dhe si bashkësi të dysheve të renditura
- të zgjidhin ekuacione të thjeshta lineare dhe t'i zbatojnë ato në zgjidhjen e detyrave nga jeta e përditshme
- të përvetësojnë nocionet themelore gjeometrike segment, drejtëz, gjysmëdrejtëz, paralelizëm, normalitet, rrafsh, kënd, perimetër, sipërfaqe, syprinë, vëllim);
- të njohin vetitë e katrorit, drejtkëndëshit, kubit dhe kuboidit;
- të kryejnë matjet dhe të përvetësojnë njësitë matëse;
- të dinë të mbledhin, të klasifikojnë dhe të organizojnë të dhënat si dhe t'i paraqesin ato me tabela dhe diagrame të thjeshta.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Si në çdo lëndë, edhe në lëndën e matematikës, detyra kryesore e mësimdhënësit është udhëheqja e veprimtarive mësimore, të cilat përmbushin kriteret për arritjen e rezultateve të të nxënës qe parashikohen në objektiva.

Praktika ka treguar se teknikat, metodat e strategjitë të cilat sigurojnë një mësimdhënie produktive, janë ato të cilat i mundësojnë nxënësit të përfshihet aktivisht në ndërtimin e të kuptuarit, në zhvillimin e strategjive matematikore për zgjidhjen e problemeve dhe në zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme.

Në vendimet që merr mësimdhënësi për zgjedhjen e metodave mësimore, krahas shumë faktorëve, duhet të mbajnë parasysh edhe:

- natyrën e materialit mësimor;
- tipin e të nxënësit të nxënës;
- nivelin dhe nevojat e nxënësve;

Për këtë qëllim, metodat dhe teknikat e mësimdhënies duhet të jenë të larmishme që të përshtaten me stilet e ndryshme të të nxënësve. Ato duhet të nxisin bashkëpunimin në mes nxënësve me qëllim të përfundimit të dimensionit shoqëror në procesin e të nxënësve.

Mësimdhënia ndërvepruese i angazhon nxënësit në marrjen e përgjegjësisë për zgjerimin e njohurive, por edhe për vlefshmërinë e tyre. Ky model pasohet nga pesë sekuenca:

- Përcaktohet tema apo çështja që është me interes për nxënësin, që ka kuptim dhe që është e lidhur ngushtë me aspektet jetësore. Kështu, matematika nga një lëndë abstrakte dhe mjaft teorike shndërron në një lëndë të kuptimshme, të lidhur ngushtë me jetën.
- Mësuesi inkurajon dhe nxit nxënësit të mendojnë rreth çështjeve që trajtohen në tekst apo rreth një problemi të caktuar. Në këtë fazë ata përfshihen në hulumtime të ndryshme, vëzhgojnë, mbajnë shënime, evidentojnë probleme, marrin informacione.
- Kjo është faza ku parashtrihen shumë pyetje për sqarim dhe të cilave u duhen dhënë përgjigje. Është e rëndësishme që pyetjet të kenë kuptim për nxënësit.
- Nxënësit zhvillojnë planet e tyre në këtë fazë, për të ndërmarrë kërkime apo hulumtime të thjeshta dhe u japin përgjigje pyetjeve të parashtruara më parë.
- Në këtë fazë, që është edhe e fundit, nxënësit dhe mësuesi së bashku reflektojnë rreth praktikës së tyre, rezultateve të nxjerra nga hulumtimi apo nga zgjidhja e problemit. Mësuesi i ndihmon ata të marrin në konsideratë alternativa të tjera për rezultatet dhe të planifikojnë kërkime apo hulumtime të mëtejshme. Është e rëndësishme që nxënësit të perceptojnë vlerësimin e ideve të tyre, zgjidhjeve që ata japin dhe të jenë të përgjegjshëm për detyrat që marrin.

VLERËSIMI

Procesi i vlerësimit është pjesë e integruar në mësimdhënien dhe të nxënësve. Ai është proces i vazhdueshëm dhe dinamik përmes të cilit gjykohej jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësve, por edhe vlefshmëria e programit dhe metodologjisë mësimore në përgjithësi.

Vlerësimi mundëson diagnostifikimin e përparimit të nxënësve dhe planifikimin e drejtë të mësimdhënies, motivimin e nxënësve dhe përcaktimet përfundimtare të rezultateve. Ai duhet të fokusohet në identifikimin

e njohurive ekzistuese të nxënësit, në konceptimet e gabuara dhe strategjitë e të nxënësve. Poashtu, përmes tij, sigurohet informacion i vlefshëm, të cilin mësuesi i matematikës e shfrytëzon për të shqyrtuar aftësitë e ndryshme të nxënësve, njohuritë paraprake të tyre dhe mënyrat që shmangin të nxënësve mekanik të fakteve e procedurave matematike.

Ndonëse aftësitë në llogaritje janë qenësore, vlerësimi duhet të përfshijë edhe verifikimin e aftësive të nxënësve për përdorimin e saktë të gjuhës e simboleve gjatë të shprehurit me fjalë të koncepteve dhe kuptimeve matematikore. Për këtë qëllim, mësuesi i matematikës sugjerohet të përdorin procedurën e teknika të larmishme të vlerësimit, si:

- **Regjistrime për vërtetimet në klasë**

Mbajtja e shënimeve të vazhdueshme për punën dhe angazhimin e nxënësve në klasë (pjesëmarrjen e tyre në diskutime, në zgjidhjen e detyrave me shkrim), detyrat e shtëpisë si dhe puna në grupe mundësojnë identifikimin e vështirësive në të nxënësve dhe gjetjen e rrugëve të reja për tejkalimin e tyre.

- **Detyrat kontrolluese**

Për matjen dhe kontrollimin e përparimit dhe arritjeve të nxënësve mësuesi planifikon: teste gojore, teste me shkrim për llogaritje numerike, teste për detyra problemore ku kërkohen shkathtësi të ndryshme matematikore dhe projekte që kërkojnë përpilime të të dhënave konstruktive të modeleve dhe vizatimeve të diagrameve.

- **Dosja dhe projektet**

Dosja është një koleksion i punimeve të nxënësve të mbajtura në një folder, që siguron një model të punës së nxënësve, të kryer gjatë një periudhe të caktuar kohore ose gjatë një viti. Nxënësi merr pjesë në mënyrë aktive në përpilimin e dosjes, e cila i shërben për vetëvlerësimin e përparimit të tij.

- **Testet dhe provimet me shkrim**

Testet e vlerësimit duhet të përdoren në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës së matematikës, strategjitë e të nxënësve dhe moshën e nevojat e nxënësve. Këto teste organizohen në fund të kategorisë së përmbytjes dhe në fund të vitit shkollor.

LIDHJET NDËRLËNDORE

Matematika ndërlidhet me të gjitha lëndët tjera, por në veçanti me:

- *Gjuhën amtare* – “përkthimi” i gjuhës së zakonshme në gjuhën e matematikës dhe anasjelltas
- *Artet e bukura* – vizatimi i vijave të drejta, të lakuara dhe figurave të ndryshme gjeometrike
- *Edukata fizike dhe sportet* – matjet e dimensioneve të terreneve sportive dhe paraqitja statistikore e rezultateve të lojërave të ndryshme
- *Teknologji* – ndërtimi i figurave dhe trupave të ndryshëm nga materiale të ndryshme

BURIMET DHE LITERATURA

1. **E. Gashi, E. Hamiti**, *Matematika për klasën e pestë të shkollës fillore*, botoi Libri Shkollor, 2000
2. **E. Hamiti, E. Gashi, R. Zejnullahu, S. Bilalli**, *Matematika për klasën e gjashtë të shkollës fillore*, botoi Libri Shkollor, 2001

HYRJE

Elementet e lëndës së biologjisë fillojnë të mësohen në kuadër të lëndës së integruar të shkencave të natyrës “Njeriu dhe natyra” në arsimin fillor, kurse si lëndë e veçantë fillon të mësohet në klasën e VI të shkollës së mesme të ulët. Programi mësimor i lëndës së biologjisë për këtë klasë është vazhdimësi e programit mësimor të pjesës biologjike të lëndës “Njeriu dhe natyra”.

Përmes mëimit të biologjisë nxënësit marrin njohuri themelore mbi jetën, ndërtimin, funksionin, shumimin dhe zhvillimin e qenieve të gjalla. Detyrë e mëtejme e mëimit të biologjisë është: zhvillimi i aftësive vrotuese dhe të menduarit kritik që në realitet është një formë e sofistikuar e të menduarit, përkatësisht proces njohës, veprues dhe ndërveprues.

Baza e biologjisë qëndron në shpjegimin e marrëdhënieve të ndërtimit dhe funksionimit të organizmave si dhe të përshtatshmërisë ndaj kushteve të ambientit.

Zhvillimi i programit mësimor të lëndës së biologjisë është ndërtuar mbi bazën e një ecurie të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënësve, metodat dhe instrumentet e vlerësimit.

QËLLIMET

Mësimet teorike të gërshetohen me metodat e vrotimit të drejtpërdrejtë të eksperimenteve në laborator ose në terren. Kjo iu mundëson nxënësve që aktivisht të fitojnë njohuri dhe në saje të kërkimeve dhe zbulimeve të kuptojnë ndërlidhjen e jetës me natyrën.

Nxënësit, nga informatat e shumta që marrin, zbulojnë thelbin e problemit, zbatojnë të menduarit kritik në radhitjen e të dhënave dhe infor-

matave. Mësohen të analizojnë, lidhin dhe përgjithësojnë të dhënat. Kjo u mundëson nxënësve kuptimin më të thellë të temave si dhe ndërlidhjen e biologjisë me shkencat tjera natyrore dhe shoqërore.

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën e VI siguron mundësi për t'i ndihmuar nxënësit në zhvillimin e: aftësive për të njohur strukturën e qelizës, **shkathtësive** për të zbatuar parimet e biosistematikës, **njohurive** për laramaninë e madhe të llojeve – mikrogjallesave, bimëve jovaskulare dhe vaskulare, **qëndrimit përgjegjës** gjatë punës eksperimentuese në laborator dhe natyrë, shkathtësive për të konsultuar literaturën adekuate, në të mbledhurit e informatave shkencore në mënyrë të pavarur dhe **klasifikimit të materialit biologjik**, **motivimit** për të manovruar me aparatet dhe instrumentet në laboratorin e biologjisë. Me një fjalë, të bëhen mendimtar kritik

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet:

- të kuptojë ngjashmëritë dhe dallimet mes natyrës së gjallë dhe jo të gjallë;
- të njihet me pikëpamjet e disa filozofëve natyralist për biologjinë;
- të njohë ndërtimin e qelizës, si njësi elementare e jetës;
- të njohë përdorimin e pajisjeve elementare në laboratorin e biologjisë;
- të kuptojë varshmërinë reciproke midis natyrës së gjallë dhe jo të gjallë;
- të kuptojë varshmërinë reciproke ndërmjet qenieve të gjalla;
- të njohë termat, kuptimet, konceptet, proceset dhe ligjshmëritë biologjike;
- të zhvillojë aftësitë për hulumtim të proceseve dhe dukurive jetësore;
- të zhvillojë aftësitë për zbatimin e njohurive të përgjithshme në përfitimin e njohurive të reja;
- të dijë se njeriu dallohet nga qeniet tjera, por njëkohësisht ai duhet të marrë përgjegjësinë për qeniet tjera;
- të zhvillojë aftësitë për hulumtim efektiv, të saktë dhe të sigurt. Të dijë çka duhet të arrijë gjatë një vrojtimi, gjegjësisht hulumtimi, përmes punës praktike në laborator, natyrë ;
- të mbajë qëndrim etik dhe përgjegjës ndaj ambientit;

- të dijë se njeriu është i varur nga natyra dhe është pjesë përbërëse e saj;
- të vlerësojë ndikimin negativ të njeriut në natyrë si dhe ambiciet e tij për ndryshimin e saj;
- të zbatojë njohuritë në rastet konkrete në jetën e përditshme;
- të përfitojë njohuri në mënyrë aktive dhe të formojë qëndrim pozitiv për natyrën.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Përmbajtja e lëndës është organizuar sipas kategorive, nënkategorive dhe temave mësimore në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të lëndës.

Organizimi i përmbajtjes përfshin: ndërtimin, balancimin dhe mbarështrimin.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin pesë tërësi mësimore, me anë të të cilave përfshihet fondamenti i lëndës. Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara sipas rëndësisë së temave mësimore.

Organizimi i përmbajtjes mësimore

Nr.	TEMAT MËSIMORE	Orë mësimi	%
1	Biologjia e qelizës	5	6.76%
2	Biosistematika-kategoritë sistematike	4	5.41%
3	Gjallesat pa bërthamë qelizore të diferencuar	5	6.76%
4	Gjallesat me bërthamë qelizore të diferencuar	48	64.86%
5	Punë praktike në laborator dhe terren-natyrë	8	10.81%
6	Orë në dispozicion	4	5.41
7	Numri i përgjithshëm i orëve	74	100.00%

Mbarështrimi i përmbajtjes së lëndës në klasë bëhet për 74 orë mësimi sipas kësaj forme:

- **Nënkategoritë dhe temat mësimore**
- **Objektivat**
- **Përmbajtja programore**
- **Rezultatet e pritura**
- **Ndërlidhja**

BIOLOGJIA E QELIZËS

Objektivat:

Nxënësit duhet:

- të dinë për ndërtimin themelor të qelizës
- të kuptojnë pse qeliza është njësi elementare e jetës
- të kuptojnë ndarjen e biologjisë sipas përmbajtjes së lëndës
- të njohin funksionin e infrastrukturave qelizore
- të njihen me disa filozofë natyralist (Shwani, Shllajdeni etj)
- të njihen me rëndësinë e biologjisë në jetën e përditshme
- të zbatojnë teknikat laboratorike në bazë të punës vetanake
- të dinë për formën e qelizës
- të dinë për ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet qelizës prokariote dhe eukariote
- të jenë në gjendje të kuptojnë dallimin ndërmjet qelizës bimore dhe shtazore
- të dallojnë strukturën e qelizës në fotografi, vizatim, skicë, mikroskop, etj

Përmbajtja programore

- Qeniet e gjalla janë të ndërtuara nga njësia elementare e jetës - qeliza
- Qeliza – ndërtimi, funksioni, veçoritë e qelizës bimore dhe shtazore
- Tipat e organizimit qelizor – qelizat prokariote dhe eukariote
- Vrojtimi i qelizës me mikroskop

Rezultatet e pritura

Nxënësi në fund të klasës së VI nga kjo përmbajtje mësimore:

- Hulumton ndërtimin dhe përshkruan funksionin e qelizës;
- Fut në përdorim shumë procese mendore si vëzhgimin, kërkimin, përfytyrimin, komunikimin, etj.;
- Në bazë të vrojtimit dallon qelizën bimore nga ajo shtazore;
- Dallon organizmat prokariotë nga ata eukariotë;
- Njih ndërtimin themelor të qelizës;
- Dallon strukturën qelizore nga fotografia, skema, skica etj.;
- Kupton se në qelizë vazhdimisht kryhet shkëmbimi i materies dhe energjisë;
- Kupton se nga qelizat formohen indet, nga indet organet dhe nga organet formohen sistemet e organeve.

Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

Kiminë: në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të qelizës

Fizikën: në aspektin e njohjes së ligjshmërive fizike, qarkullimit të materieve.

BIOSISTEMATIKA, KATEGORITË SISTEMATIKE

Objektivat

Nxënësit duhet:

- të njohin parimet e biosistematikës
- të kuptojnë metodat themelore që aplikohen në biosistematikë
- të dinë se bota e gjallë është ndarë në pesë mbretëri
- të dallojnë kategoritë themelore sistematike
- të klasifikojnë gjallesat në kategoritë më të larta sistematike
- të dinë për kontributin e Lineut në zhvillimin e Sistematikës
- të aftësohen për përdorimin e çelësave për determinim e organizmave të ndryshëm
- të njohin zhvillimin evolutiv të grupeve kryesore të bimëve

Përmbajtja programore

- Biosistematika-definimi
- Metodat e biosistematikës, çelësat për determinim
- Nomenklatura bineare
- Kategoritë sistematike
- Klasifikimi i botës së gjallë në pesë mbretëri: 1. Monera 2. Protista 3. Fungi 4. Plantae 5. Animalia.

Rezultatet e pritura

Nxënësit duhet të:

- Kuptojnë se klasifikimi i gjallesave bëhet në bazë të afrisë filogjenetike, ndërsa emërtimi sipas rregullave të nomenklaturës;
- Emërtojnë kategoritë dhe njësitë sistematike;
- Klasifikojnë disa lloje të kërpudhave, algave dhe bimëve me farë në mjedisin ku jetojnë;
- Zbatojnë njohuritë e biosistematikës në jetën e përditshme;
- Identifikojnë bimët e helmuese (p.sh. kërpudhat helmuese të mjedisit, ku jetojnë);
- Kuptojnë domosdoshmërinë e klasifikimit të gjallesave;

- Njohin kategoritë kryesore të botës së gjallë;
- Krahasojnë dallimet dhe ngjashmëritë në mes organizmave të mjedisit, ku jetojnë.

Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:
Anatominë, në aspektin e njohjes së ndërtimit të gjallesave
Paleontologjinë, gjeologjinë, gjenetikën, biokiminë, ekologjinë, embriologjinë etj.

BAKTERIET, ALGAT BLU NË TË GJELBËR

Objektivat:

Nxënësit duhet:

- të zhvillojnë njohuri për formën, ndërtimin, madhësinë, shumëzimin dhe përhapjen e gjallesave pa bërthamë të diferencuar qelizore.
- të kuptojnë se ekziston një laryshi e madhe e llojeve të gjallesave pa bërthamë qelizore të diferencuar
- të përshkruajnë karakteristikat e përgjithshme të monereve, rëndësinë e bakterieve
- të vlerësojnë rolin e bakterieve në natyrë dhe në ekonominë e njeriut
- të emërtojnë disa sëmundje që shkaktojnë bakteriet
- të kuptojnë se organizma më të vjetër foto-autotrofë janë algat blu në të gjelbër
- të zhvillojnë njohuri elementare për gjallesat pa bërthamë të diferencuar qelizore.

Përmbajtja programore

- Organizmat pa bërthamë qelizore të diferencuar. Bakteriet- forma, madhësia, përhapja dhe roli i tyre në natyrë;
- Bakteriet në shërbim të njeriut (bakteriet saprofite dhe parazite);
- Organizmat më të vjetër fotoautotrofë pa bërthamë qelizore të diferencuar- algat e gjelbra blu.

Rezultatet e pritura

Nxënësit duhet të:

- Dinë se bakteriet dhe algat Cyanophyceae grupohen në organizma prokariotë;

- Dallojnë bakteriet autotrofe dhe heterotrofe (saprofite, parazite);
- **Vlerësojnë** rolin e bakterieve në qarkullimin e materieve në natyrë dhe në ekonominë e njeriut (bioteknologjia);
- **Emërtojnë** disa sëmundje bakteriale;
- **Sqarojnë** pse nganjëherë shfaqet “lulesa ujore”;
- **Zbatojnë** shkathtësitë në teknikën e vrojtimit mikroskopik të bakterieve me rrëmojëse nga dhëmbët;
- Zbatojnë njohuritë e fituara për parandalimin e sëmundjeve bakteriale;
- **Zhvillojnë** rrjet mendimesh për dobitë dhe dëmet që mikroorganizmat i sjellin njeriut dhe ekonomisë së tij.

Ndërlidhja

Përmbajtja e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

Sistematikën - në kuptim të njohjes dhe emërimit të llojeve të bakterieve patogjene dhe dobiprurëse

Bioteknologjinë - në kuptim të shfrytëzimit të bakterieve në bujqësi, në industrinë ushqimore, farmaci, energjetikë, mbrojtje të mjedisit

Imunologjinë - në kuptim të njohjes së zhvillimit të mekanizmave mbrojtës të organizmit ndaj mikroorganizmesave patogjene

EUKARIOTËT –

ALGAT, KËRPUDHAT, LIKENET DHE MYSHQET

Objektivat:

Nxënësit duhet:

- të dinë për larminë e llojeve të algave eukariote
- të njohin ndërtimin e talusit të algave
- të kuptojnë rolin e pigmenteve që përmbajnë algat
- të dinë për përhapjen e algave në natyrë dhe rolin e tyre
- të dallojnë disa alga në mjedisin ku jetojnë
- të njohin kërpudhat, të dijnë se ato paraqesin grup të veçantë të bimëve
- të dinë ndërtimin, mënyrën e të ushqyerit, madhësinë dhe përhapjen e kërpudhave në natyrë
- të kuptojnë rolin e kërpudhave në natyrë dhe jetën e tyre
- të dallojnë kërpudhat helmuese nga ato me vlerë ushqyese për njeriun
- të njohin dhe përshkruajnë kërpudhat më të përhapura në mjedisin ku jetojnë

- të kuptojnë se likenet janë simbiozë e algave dhe kërpudhave dhe se likenet janë të afërta me kërpudhat
- të njohin likenet më të shpeshta dhe rolin bioindikatorë të tyre
- të njohin ndërtimin e myshqeve
- të kuptojnë përhapjen dhe rëndësinë e myshqeve

Përmbajtja programore

- Algat e gjelbra, mënyra e të ushqyerit, ndërtimi, shumimi dhe përhapja në natyrë
- Roli i algave në natyrë dhe në ekonominë e njeriut
- Kërpudhat - ndërtimi, mënyra e të ushqyerit, shumimi dhe përhapja
- Roli i kërpudhave në natyrë dhe në ekonominë e njeriut
- Bashkëjetesa midis kërpudhave dhe algave-likenet
- Ndërtimi i myshqeve, përhapja, mënyra e të ushqyerit në shembullin e plisores

Rezultatet e pritura

Në fund të kësaj përmbajtje programore nxënësit:

- Kuptojnë ndërtimin e talusit të algave eukariote, kërpudhave, likeneve dhe myshqeve
- Analizojnë mënyrën e të ushqyerit të algave, kërpudhave, likeneve dhe myshqeve.
- Dinë t'i dallojnë algat, kërpudhat, likenet dhe myshqet.
- Kuptojnë rolin e bimëve jovaskulare në natyrë dhe ekonominë e njeriut
- Kuptojnë se likenet janë simbiozë e kërpudhave dhe algave
- Dinë se trupi i kërpudhës është një micel i përbërë nga hifet
- Vrojtajnë me mikroskop mykun e bukës, algën e gjelbër etj.
- Gjykojnë për shkallën e ndotjes së mjedisit jetësor në saje të pranishme-mungesës së likeneve

Ndërlidhja

Përmbajtja e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

Ekologjinë - në kuptim të njohjes së përhapjes së bimëve jo vaskulare në planet;

Farmacinë - përdorimi i bimëve jovaskulare për prodhimin e antibiotikëve;

Paleontologjinë - në kuptim të njohjes së filogjenisë së bimëve jo vaskulare;

Biosistematikën - në kuptim të klasifikimit dhe emërimit shkencor të bimëve jo vaskulare.

FIERNAT.

BIMËT ME LULE OSE ME FARË (SPERMATOPHYTA)

Objektivat:

Nxënësit duhet:

- të kuptojnë veçoritë themelore të mbretërisë së bimëve;
- të njohin bimët më të përhapura vaskulare dhe të përshkruajnë rolin e tyre;
- të dallojnë përfaqësuesit e farëzhveshurave nga përfaqësuesit e farëveshurave;
- të përdorin çelësin për të bërë klasifikimin elementar të një bime vaskulare;
- të identifikojnë dhe përshkruajnë bimët më të përhapura në mjedisin ku jetojnë;
- të dallojnë përfaqësuesit e bimëve njëthelbore nga bimët dythelbore;
- të kuptojnë ndërtimin, përhapjen dhe ciklin e zhvillimit të fiernave dhe spermatofiteve;
- të njihen me disa përfaqësues të fiernave të vdekur dhe kuptojnë shkaqet e vdekjes së tyre;
- të njihen me karakteristikat e përgjithshme të bimëve me farë;
- të njihen me ndërtimin e lules;
- të njohin llojet e ndryshme të frutave;
- të kuptojnë ndërlidhjen e shtazëve dhe bimëve gjatë përhapjes së frutave;
- të zbatojnë parimet elementare të biosistematikës gjatë klasifikimit të farëzhveshurave dhe farëveshurave;
- të kuptojnë, dijnë se farëveshurat ndahen në: njëthelbore dhe dythelbore;
- të dinë të përcaktojnë grupet e bimëve përmes çelësave të thjeshtë për përcaktim (determinim);
- të dinë të ndërlidhin përvojat nga klasat e mëparshme në një tërësi.

Përmbajtja programore

- Fiernat si bimë të larta
- Ndërtimi, përhapja dhe cikli i zhvillimit të fiernave në shembullin e Polipodiun Vulgare
- Karakteristikat e përgjithshme të bimëve me farë
- Farëzhveshurat – familjet më kryesore – karakteristikat e përgjithshme dhe ndarja e farëveshurave në njëthelbore dhe dythelbore.
- Lulja, ndërtimi, simetria, formula dhe diagrami i lules
- Polenizimi, frytnimi, fara, fryti
- Punë laboratorike: dallimi i gjetheve dhe luleve të monokotiledoneve dhe dikotiledoneve.

Rezultatet e pritura

Nxënësit:

- Kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet në mes myshqeve dhe fiernave;
- Dinë pse fiernat i përkasin bimëve të larta;
- Dinë për ciklin e zhvillimit të fiernave, farëzhveshurave dhe farëveshurave;
- Identifikojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes lules së bimëve farëzhveshura dhe farëveshura;
- Analizojnë veçoritë në bazë të së cilave dallohen bimët monokotiledone dhe dikotiledone;
- Kuptojnë si formohet fryti dhe dallojnë llojet e fryteve;
- Aftësohen të veçojnë llojet sipas vlerave përdoruese;
- Demonstruojnë klasifikimin e bimëve monokotiledone dhe dikotiledone në mjedisin, ku jetojnë deri në nivelin e familjes;
- Kuptojnë rëndësinë e frytnimit artificial për fisnikërimin e bimëve;
- Dallojnë ndërtimin e organeve vegjetative të bimëve njëthelbore dhe dythelbore;
- Definojnë termat: polenizim, frytnim, farë, fryt;
- Dallojnë disa nga bimët mjekuese dhe helmuese të mjedisit ku jetojnë.

Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

Anatominë, morfologjinë, mjekësinë, pylltarinë, bujqësinë – në kuptim të njohjes së bimëve mjekuese me rëndësi të veçantë ushqyese.

PUNËT PRAKTIKE

Me punë praktike kuptojmë aktivitetet, të cilat i kryejnë nxënësit në natyrë dhe laborator. Këto punë kryhen me qëllim të konkretizimit të pjesës teorike të lëndës. Detyrat dhe ushtrimet për punë praktike (që duhet të kryhen në grupe ose individualisht) janë të lidhura me përmbajtjen e lëndës, prandaj për kryerjen e tyre nuk kërkohen njohuri jashtë përmbajtjes së lëndës së paraparë për këtë vit. Ushtrimet janë relativisht të thjeshta dhe të realizueshme për një orë. Nuk është vështirë të udhëhiqet me veglërinë e paraparë për ushtrime.

Punët praktike, të cilat do të duheshin të realizoheshin në mësimin e biologjisë

- Njohja me rregullat e sjelljes gjatë punës në laborator dhe në terren;
- Njohja me veglërinë laboratorike (mikroskop, qelqit zmadhues);
- Vrojtimi mikroskopik i epidermës së qepës, micelit të mykut, algës së shiut,
- mikroskopimi i bakterieve të marra me rrëmojëse nga dhëmbët e njeriut;
- Njohja dhe vrojtimi i rrënjës, kërcellit dhe gjethit;
- Njohja e ndërtimit të lules (me ndihmën e qelqit zmadhues) në material natyror;
- Vrojtimi i frutave dhe farave të bimëve që rriten afër shkollës dhe në bazë të dukjes jepet gjykimi për shpërndarjen e tyre;
- Në material natyror të njihen me parimet themelore të klasifikimit të bimëve;
- Në bazë të luleve të mbledhura të qershisë, mollës, dardhës, ftoit etj, të caktohet lloji, gjinia dhe familja e këtyre bimëve. Në mungesë të materiali të freskët mund të përdoren edhe bimët e herbarit, e në rastin e fundit edhe fotografitë e luleve të këtyre bimëve
- Nxënësit të udhëzohen për përdorim të çelësave për determinim të bazuar në karaktere diagnostike. Determinimi i farëzhveshurave. Përdorimi i çelësit të vogël për determinim të familjes së halorëve;
- Përcaktimi(determinimi) i farëveshurave. Caktimi i përkatësisë së disa familjeve të klasës së monokotiledoneve me ndihmën e çelësit të vogël;
- Përcaktimi dikotiledoneve drurore me ndihmën e çelësit të vogël;

- Përcaktimi i disa llojeve të familjes së fluturoreve me lule te bardha dhe te verdha me ndihmën e çelësit të vogël;
- Përcaktimi i kërpudhave. Çelësi për përcaktimin e kërpudhave më të përhapura në natyrë;

METODOLOGJIA

Mësimi në biologji, si dhe në çdo lëmi tjetër, mund të kryhet në disa mënyra, d.m.th. mund të shfrytëzohen disa metoda mësimore. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim që realizohet me metoda te ndryshme, ku secila prej tyre ka rëndësi dhe vlerë të veçantë.

Prej metodave të shumta që mund të përdorën në mësimet e biologjisë, përmendim:

- **Metodën e shpjegimit**
- **Metodën e kuvendimit (bashkëbisedimit)**
- **Metodën e leximit dhe punës me tekst**
- **Metodën e punës praktike në laboratorin biologjik apo në teren (ekskursionet)**
- **Metodën e të mësuarit dhe të nxënimit ndërveprues (në kompjuter, programe simuluese kompjuterike për proceset fiziologjike - fotosinteza, transpiracioni, qarkullimi i materieve dhe energjisë, ndërtimi i organeve bimore, etj.)**

Format e punës

- individuale,
- në çifte,
- në grupe
- me të gjithë nxënësit,
- brainstormingu, etj.

Arsimtari gjithmonë ka parasysh se nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes, me qëllim që te ai të zhvillohen të menduarit kritik dhe aftësitë kognitive.

Arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: **prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja.**

VLERËSIMI

Vlerësimi është pjesë përbërëse e mësimit, prandaj si i tillë ai kërkon objektiva të qarta mësimore. Arsimtari cakton qartas çfarë duhet mësuar nxënësit. Ky përcaktim tregon atë që duhet të vlerësohet.

Vlerësimi realizohet gjatë tri etapave:

- **Kontrolli**
- **Matja** - nxënësi ka nevojë të dijë për rezultatin e kontrollit. Matjen e bën arsimtari, me: pikë, simbole, shenja dalluese etj.
- **Vlerësimi** – nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi cilësor ose sasior të bazuar në matjen. Vlerësimin e bën arsimtari me notë, simbol ose shprehje.

Arsimtari parashikon disa vlerësime përmbledhëse gjatë vitit. Vlerësimi bazohet në atë se ç'thonë, ç'shkruajnë dhe ç'bëjnë nxënësit.

Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe sjelljeve të nxënësve ka një sërë teknikash:

- **Vlerësimi me shkrim**
- **Vlerësimi me gojë**
- **Vlerësimi me anë të dëgjimit**
- **Vlerësimi praktik**
- **Vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve**
- **Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në teren**
- **Testimi** - është ecuria e matjeve sipas një synimi ose objektivi të caktuar

Ekzistojnë lloje të ndryshme të testeve, si:

Testet me përgjigje alternative

Testet me kombinime

Testet me alternativa të shumta

Testet me përgjigje të shkurta dhe me plotësim

Vlerësimi duhet të jetë:

- **I vlefshëm**
- **I besueshëm**
- **I barabartë**
- **I paanshëm**
- **Formues**

NIVELET E VLERËSIMIT TË NJOHURIVE

Vlerësimi i njohurive nga lënda e biologjisë bëhet në tri rrafshe:

A. Njohja dhe të kuptuarit

B. Përpunimi i të dhënave dhe zgjidhja e problemeve

C. Verifikimi i shkathtësive eksperimentuese

NJOHJA DHE TË KUPTUARIT

Nxënësit njohin dhe kuptojnë:

- Dukuritë, ligjshmëritë, veprimet, definicionet, kuptimet dhe teoritë;
- Teknikën, aparaturën bazë dhe atë ndihmëse;
- Sjelljet gjatë punës në klasë, laborator të biologjisë dhe terren;
- Çrregullimet në mjedis, pasojat për shoqërinë dhe mënyra e tejkalimit të tyre.

Pyetjet që parashtrihen për verifikim të qëllimit, të bazuar në njohje dhe të kuptuar, zakonisht fillojnë me fjalët: **defino, shëno, përshkruaj, skico, arsyeto, apliko, sqaro, cakto, emërto, etj.**

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Nxënësit janë të aftë që njohuritë e fituara t'i shprehin në forma të ndryshme (**skematike, grafike, numerike**):

- të organizojnë t'i mbledhin informatat në mënyra të ndryshme.
- të riformulojnë informatat prej një forme në tjetrën.
- të përdorin të dhënat në mënyrë logjike
- të sqarojnë dukuritë, ligjshmëritë si dhe ndërlidhjet e tyre në mënyrë logjike
- të japin supozime dhe parashtrojnë hipoteza, duke lidhur njohuritë nga kaptina të ndryshme të biologjisë dhe lëndëve të tjera.
- të përdorin njohuritë në situata të reja, zgjidhin probleme, i analizojnë problemet në mënyrë kritike.

Pyetjet me të cilat verifikohen këto qëllime fillojnë me: **propozo, përdor, ndërlidh, përmend, etj.**

SHKATHTËSITË EKSPERIMENTUESE

Nxënësit dinë:

- të dizajnojnë eksperimente të thjeshta;
- të përgatisin p.sh. mostrën biologjike, vrojtojnë, përshkruajnë dhe masin;
- Të zbatojnë të dhënat në praktikë;
- Të përdorin teknikën, mjetet ndihmëse si dhe aparaturën në laborator dhe terren.

Gjatë përgjigjes në pyetje ose gjatë zgjidhjes së problemeve në lëmin e verifikimit të aftësive dhe shkathtësive, nxënësi duhet që njohuritë e tij **logjikisht t'i përdorë në situata të reja, në formë deduktive.**

HYRJE

Lënda e fizikës për klasën e gjashtë është hartuar mbi bazat e lëndës njeriu dhe natyra. Interpretimet e dukurive natyrore dhe ligjet e tyre këtu bëhen në nivel pak sa më të lartë shkencor, në nivel që i përshtatet moshës dhe aftësive psiko-fizike të nxënësve të kësaj klase. Këtu nxënësit fitojnë njohuritë elementare të dukurive fizike, siç janë: trupat dhe vetitë e tyre, lëvizjet e trupave, veprimi i trupave, forca, puna, energjia, nxehtësia, dukuritë elektrike dhe magnetike.

Nëpërmjet lëndës së fizikës nxënësit njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e natyrës dhe të ligjeve të saja. Ata formojnë qëndrim të drejtë ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, ndaj kursimit të energjisë dhe fitojnë bazë të mirë për njohjen edhe të dukurive dhe të ligjeve të tjera të cilat mësohen në lëndët e tjera, si kimi, biologji, matematikë etj.

QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Nxënësi:

- do të njihet me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e natyrës;
- do të njihet me kuptimin e botës lëndore, trupat, vetitë dhe llojet e tyre;
- do të njihet me kuptimin e madhësive dhe të dukurive fizike;
- do të njohë dhe do të përshkruajë dukuritë më të thjeshta fizike: mekanike, termike, elektrike, magnetike, optike etj.;
- do të njihet me metodat e studimit të fizikës dhe do t'i dallojë ato nga metodat e studimit të shkencave të tjera natyrore (kimisë, biologjisë, gjeografisë, astronomisë);

- do t'i ofrohet kalim i natyrshëm nga lënda e deritashme **njeriu dhe natyra** (dituri natyre) në lëndën e fizikës;
- do t'i krijohet shprehi pune në grupe dhe ekipe;
- do t'i krijohet vetëdija se njeriu është pjesë e natyrës dhe do të kuptojë se është pjesë e pandashme e saj;
- do t'i krijohet vetëdija e shfrytëzimit, ruajtjes dhe e kursimit të energjisë për mirëqenien e tij dhe të ruajtjes së ambientit;
- do të njihet me rolin e matjeve dhe të eksperimentit për verifikimin e ligjshmërive të fizikës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet:

- t'i thellojë dituritë për njohjen e natyrës të fituara në vitet e mëparshme nga lënda **njeriu dhe natyra** (dituri natyre);
- të kuptojë në mënyrë të drejtë madhësitë dhe dukuritë fizike;
- të zhvillojë aftësi për matje të sakta në fizikë dhe rolin e tyre;
- të planifikojë eksperimente dhe të bëjë demonstrime të thjeshta;
- të kuptojë, të dallojë dhe të identifikojë madhësitë e ndryshme fizike: masën, peshën, shpejtësinë, forcën, energjinë, punën, fuqinë, shtypjen etj.;
- të kuptojë rëndësinë e matjeve dhe të eksperimentit në fizikë;
- të kuptojë dukuritë: mekanike, termike dhe elektrike dhe lidhjen midis tyre;
- të kuptojë se energjia në natyrë as nuk krijohet, as nuk zhduket, por vetëm shndërrohet nga një lloj në llojin tjetër.

KATEGORITË

1. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE
2. LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE
3. ELEKTRICITETI DHE MAGNETIZMI
4. OPTIKË
5. FIZIKË BASHKËKOHORE
6. ASTRONOMI

PËRMBAJTJA PROGRAMORE
(2 orë në javë, 74 orë në vit)

KATEGORIA: POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE

NËNKATEGORIA: TRUPAT DHE VETITË E TYRE (12)	
QËLLIMET	OBJEKTIVAT
<ul style="list-style-type: none"> - të njihet me materien, trupat, vetitë e tyre dhe ndërtimin grimcor të saj; - të njohë dhe të dallojë trupat me veti të ndryshme; - të njihet me tri gjendjet agregate të trupave; - të dijë se çdo matje shoqërohet me gabime dhe të dijë të njehsojë vlerën mesatare të atyre matjeve. 	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojë lëndën dhe gjendjet e saj agregate; - të dijë të matë disa madhësi fizike, si: gjatësinë, sipërfaqen dhe vëllimin e trupave; - të kuptojë se çdo trup ka masë; - të arrijë të demonstrojë në mënyrë të pavarur ndonjë veti të: trupave të ngurtë, lëngjeve apo gazeve.
PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA
<p>Trupat dhe lënda. Ndërtimi grimcor i lëndës. Vetitë e lëngjeve dhe të gazeve. Vetitë e trupave të ngurtë. Matja e trupave: matja e gjatësisë, e sipërfaqes dhe e vëllimit. Çdo trup ka masë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të njohë, të kuptojë dhe të dallojë dukuritë fizike nga dukuritë e tjera natyrore; - të identifikojë, të përshkruaj dhe të vlerësojë dukuritë fizike më të thjeshta; - të dijë të matë disa madhësi fizike (gjatësinë, sipërfaqen ,vëllimin); - të kuptojë se çdo trup ka masë dhe të dallojë trupat me masa të ndryshme; - të dallojë trupat e ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.
UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Arsimtari demonstroi para nxënësve trupa të ndryshëm dhe bën disa ushtrime demonstruese në mënyrë që tek ata të zgjojë interesim për lëndën e fizikës. Arsimtari bën disa matje të gjatësisë, sipërfaqes dhe të vëllimit të trupave dhe demonstroi trupa me masa të ndryshme.</p>	<p>Matematikë Kimi Biologji</p>

KATEGORIA: POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE

NËNKATEGORIA: LËVIZJA E TRUPAVE NË NATYRË (7)	
QËLLIMET	OBJEKTIVAT
<ul style="list-style-type: none"> - të njihet me faktin se çdo trup në natyrë është në lëvizje; - të njihet me madhësitë kryesore fizike të lëvizjes së trupave. 	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojë qetësinë dhe lëvizjen e trupave; - të përshkruajë lëvizjen e trupave të ndryshëm, rrugen e kaluar në njësi të kohës (shpejtësinë); - të njohë trajektoren e lëvizjes së trupit në vijë të drejtë, vijë të lakuar dhe në vijë rrethore.
PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA
<p>Lëvizja dhe qetësia. Ç'është rruga dhe ç'është trajektorja. Rruga dhe shpejtësia.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojë qetësinë dhe lëvizjen e trupave në natyrë; - të dallojë qetësinë dhe lëvizjen e trupave; - të përshkruajë lëvizjen e trupave të ndryshëm, rrugën e kaluar në njësi të kohës (shpejtësinë); - të dijë trajektoren e lëvizjes së trupit në vijë të drejtë, të lakuar dhe rrethore.
UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Nxënësit, në mënyrë individuale, në çifte apo në grupe, bëjnë disa lëvizje sipas një vije të drejtë, të lakuar apo në rreth që të kuptojnë trajektoren, rrugën dhe shpejtësinë.</p>	<p>Matematikë Biologji Gjeografi</p>

KATEGORIA: POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE

NËNKATEGORIA:VEPRIMI NDËRMJET TRUPAVE - FORCA (11)	
QËLLIMET	OBJEKTIVAT
<ul style="list-style-type: none"> - të mësojë terminologjinë e fizikës; - të matë vetë disa madhësi fizike në mënyrë që të nxënësi të zgjohet interesimi për lëndën e fizikës dhe në përgjithsi për shkencat e natyrës. 	<ul style="list-style-type: none"> - të mësojë se forca shkakton deformimin e trupave; - të mësojë të matë forcën me dinamometër; - të dijë se forca e ndryshon shpejtësinë dhe drejtimin e lëvizjes së trupave.
PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA
<p>Forca deformon trupat. Të matim forcën-dinamometri. Forca ndryshon shpejtësinë e trupave dhe drejtimin e lëvizjes. Veprimi dhe kundërveprimi i forcave. Mbi rënien e lirë të trupave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojë se ekziston forca që njihet sipas veprimit të sajë; - të dijë se forca e ndërron formën, shpejtësinë dhe drejtimin e lëvizjes së trupit; - të dijë të matë forcën me dinamometer; - të përshkruajë deformimin e trupave nën veprimin e forces; - të dallojë, në rastin konkret, forcën e madhe nga forca e vogël.
UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Arsimtari demonstroi para nxënësve deformimin e trupave të ndryshëm. Me dinamometër mat forcën. Demonstroi se si forca e ndryshon shpejtësinë, drejtimin e lëvizjes dhe formën e trupave. Duke përdorur dy dinamometra të cilët i tërheqin dy nxënës bën demonstrimin e veprimit dhe të kundërveprimit të forcave.</p>	<p>Kimi Biologji Astronomi</p>

KATEGORIA: POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE

NËNKATEGORITË: PUNA DHE ENERGJIA (14)	
QËLLIMET	OBJEKTIVAT
<p>- të arrijë të kuptojë një varg termash të fizikës;</p> <p>- të njihet me punën mekanike, por njëherësh nxënësit të binden se duhet të punojnë për të arritur një qëllim të caktuar;</p> <p>- të njihet me disa makina të thjeshta. të cilat shpeshherë i ka hasur në jetën e përditshme, por nuk e ka ditur që mësohen në lëndën e fizikës.</p>	<p>- të njihet me punën mekanike, energjinë dhe nxehtësinë;</p> <p>- të mësojë për makinat e thjeshta, si p.sh. llozi, rrafshi i pjerrët dhe rrotullat;</p> <p>- të dijë të konstruktojë ndonjë makinë të thjeshtë;</p> <p>- të kuptoj se ekzistojnë fërkimi dhe forca e fërkimit;</p> <p>- të mësojë për llojet e ndryshme të energjisë dhe të njihet me shndërrimet e energjisë;</p> <p>- të njihet me temperaturën dhe me bymimin e trupave.</p>
PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA
<p>Kur kryejmë punë?</p> <p>Lëvizja e një trupi me anë të një llozi.</p> <p>Lëvizja e trupit nëpër rrafshin e pjerrët.</p> <p>Rrotulla e palëvizshme. Rrotulla e lëvizshme.</p> <p>Forca e fërkimit. Ç'është fërkimi?</p> <p>Fërkimi në jetën e përditshme.</p> <p>Fërkimi, puna dhe nxehtësia.</p> <p>Si shndërrohet puna në nxehtësi?</p> <p>Puna, nxehtësia, energjia.</p> <p>Kur kryhet punë?</p> <p>Kur lirohet nxehtësi?</p> <p>Energjia.</p> <p>Burimet dhe llojet e energjisë.</p> <p>Shndërrimet e energjisë në lloje të ndryshme.</p>	<p>Ttë kuptojë konceptin elementar për punën dhe energjinë;</p> <p>- të mësojë dhe të dallojë makinat e thjeshta (llozi, rrafshi i pjerrët, rrotullat);</p> <p>- të dijë se ekziston fërkimi dhe forca e fërkimit;</p> <p>- të kuptojë shndërrimin e punës në nxehtësi me fërkim;</p> <p>- të dijë se dielli është burimi kryesor i energjisë;</p> <p>- të dallojë llojet e energjisë dhe shndërrimet e një lloji të energjisë në tjetrën;</p> <p>- të dijë se me marrjen e ushqimit, në trup merr energji;</p> <p>- të mësojë se për të kryer punë nevojitet energji.</p>
UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Arsimtari demonstroi para nxënësve lëvizjen e ndonjë trupi me anë të llozit, rrafshit të pjerrët, rrotullës së lëvizshme dhe të rrotullës së palëvizshme.</p> <p>Demonstroi me shembuj të ndryshëm fërkimin e trupave, shndërrimin e fërkimit në nxehtësi, me demonstrime të ndryshme tregon se nga çka varet forca e fërkimit. Po ashtu me shembuj të ndryshëm praktikë arsimtari duhet t'u tregojë nxënësve se kur kryejmë punë dhe se puna është e dobishme për njeriun. Të demonstrojë para nxënësve se si një lloj i energjisë shndërrohet në një lloj tjetër të energjisë.</p>	<p>Biologji</p> <p>Kimi</p>

KATEGORIA: LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE

NËNKATEGORIA: DUKURITË E NXEHTËSISË (11)	
QËLLIMET	OBJEKTIVAT
Të njihet më dukuritë më themelore të nxehtësisë: temperatura e trupave, bymimi dhe tkurrja e trupave, avullimi, valimi etj.	<ul style="list-style-type: none"> - të njihet me temperaturën dhe byminim e trupave; - të mësojë për burimet e nxehtësisë; - të njihet me avullimin, valimin dhe kondensimin e ujit.
PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA
<p>Temperatura e trupave. Burimet e nxehtësisë. Bymimi dhe tkurrja e trupave të ngurtë. Bymimi dhe tkurrja e lëngjeve dhe e gazeve. Avullimi, valimi dhe kondensimi i ujit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të dallojë trupat e nxehtë dhe të ftohtë; - të dijë se nxehtësia kalon prej trupit më të nxehtë në trupin më të ftohtë; - të njihet me faktin se uji i nxehtë i sjell energji radiatorit dhe radiator i jep nxehtësi mjedisit (klasës); - të kuptojë se kur është i madh ndryshimi i temperaturës edhe rrjedhja e nxehtësisë është e madhe; - të njohë se nxehtësia shkakton bymimin e trupave.
UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Arsimtari merr shembuj të ndryshëm për të treguar trupat e nxehtë dhe të ftohtë dhe për të treguar se si nxehtësia kalon prej trupit të nxehtë në trupin e ftohtë. Demonstron bymimin e trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë. Demonstron avullimin dhe valimin e ujit.</p>	<p>Biologji Kimi</p>

KATEGORIA: ELEKTRICITETI DHE MAGNETIZMI

NËNKATEGORIA: DUKURITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE (19)	
QËLLIMET	OBJEKTIVAT E VEÇANTË
<ul style="list-style-type: none"> - të fitojnë njohuri më elementare për dukuritë elektrike; - të arrijnë të kuptojnë për rreziqet e ndryshme që rrjedhin nga rryma elektrike dhe të fitojnë shprehje për kursimin e rrymës elektrike; - të njihen me elektricitetin në atmosferë; - të njihen me një varg termash nga ky lëmë. 	<ul style="list-style-type: none"> - të njohë dy llojet e elektricitetit (pozitiv dhe negativ); - të mësojë për mënyrat e elektrizimit të trupave; - të mësojë për tërheqjen dhe refuzimin ndërmjet trupave të elektrizuar; - të dijë të konstruktojë elektroskopin dhe elektrometrin; - të njihet me rymën elektrike, veprimet e saj dhe me elektricitetin atmosferik; - të mësojë për magnetët e përhershëm, polet magnetike, për tërheqjen dhe refuzimin ndërmjet poleve magnetike.
PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA
<p>Dy lloje të elektricitetit. Elektrizimi i trupave me fërkim dhe me ndikim (influencë). Si të matet elektriciteti. Elektroskopi dhe elektrometri. Tërheqja dhe refuzimi elektrik. Burimet e rrymës elektrike. Elementet galvanike (bateria, akumulatori dhe elementi i Voltës). Qarku elektrik. Veprimet e rrymës elektrike. Elektriciteti atmosferik. Rrufeja. Magnetët e përhershëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të dijë se ekzistojnë dy lloje të elektricitetit:pozitiv dhe negative; - të njihet me mënyrat e elektrizimit të trupav (me prekje, fërkim, ndikim); - të dijë se trupat e elektrizuar tërhiqen ose shtyhen ndërmjet veties; - të përshkruajë elektroskopin dhe elektrometrin; - të njihet me atë se disa trupa e përçojnë rrymën elektrike e disa të tjerë nuk e përçojnë; - të njihet me burimet e rrymës, siç janë: bateria, akumulatori, elementi i Voltës, centralet elektrike etj.; - të mësojë për qarkun elektrik dhe për pjesët e tij; - të kuptojë se kur rryma elektrike kalon nëpër përçues, disa prej tyre

	<p>do të nxehen e disa të tjerë do të skuqen (do të japin dritë);</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njihet me elektricitetin atmosferik dhe me dukurinë e rrufesë; - të njihet me disa veti të magnetëve permanente.
UDHËZIME METODOLOGJIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
<p>Arsimtari demonstroi para nxënësve elektrizimin e trupave me prekje, fërkim dhe me influence, bën matjen e elektricitetit me elektrometër, tregon elektrizimin e trupave me elektroskop. Po ashtu demonstroi tërheqjen dhe refuzimin e trupave të elektrizuara. Arsimtari demonstroi burimet e rrymës elektrike, si p.sh. baterinë, elementin e thatë, elementin e Voltës dhe u tregon nxënësve për burimet e tjera të rrymës elektrike. Demonstroi disa veprime të rrymës elektrike, si p.sh. nxemjen e përçuesve, pllakat e shporetit elektrik, llamba elektrike etj. Demonstroi magnetet, tërheqjen e disa trupave me magnet, tërheqjen dhe shtyrjen e magnetëve, busollen etj.</p>	<p>Kimi Biologji</p>

VLERËSIMI

1. Vlerësimi sipas aktivitetit

Në radhë të parë mësuesi duhet ta pranojë nxënësin si partner të bashkëpunimit. Prandaj duke provuar që nxënësin ta kyç në bashkëpunim gjatë procesit të shpjegimit, njëkohësisht do ta vlerësojë se sa është në gjendje të përveçësive në mënyrë mësimore të shpjeguar. Në këtë mënyrë nxënësi do të jetë vazhdimisht aktiv në nxjerrjen e përfundimeve për ligjëshmëritë së bashku me mësuesin. Nxënësit e ndryshëm, për të njëjtën problematikë, mund të arrijnë në përfundime të ndryshme. Ky aktivitet i tyre për arritje deri te konkludimet së bashku me më-

simdhënësin apo edhe në mënyrë të pavarur duhet të merret si një parametër për vlerësimin e diturisë.

2. Vlerësimi me gojë

Ka nxënës të tillë që janë mjaft të përgatitur, por janë të tërhequr, jo aq aktivë dhe nuk marrin pjesë në bashkëbisedim. Për këtë arsye mësimdhënësi këta nxënës duhet t'i ftojë për t'i pyetur me gojë në mënyrë klasike, që të kuptojë nivelin e arritshmërisë së tyre. Edhe kjo mënyrë realizohet në formë bashkëbisedimi dhe nuk duhet t'i nënshtrohet e tërë klasa.

3. Vlerësimi nga zgjidhja e detyrave

Në programin e fizikës për klasën VI janë paraparë zgjidhje detyrash, detyra për përsëritje dhe detyra kontrolli. Në këtë rast nxënësit duhet të kyçen vazhdimisht për zgjidhjen e këtyre detyrave në tabelë apo në fletore. Ky aktivitet i nxënësve duhet të merret si parametër për vlerësimin e diturisë.

4. Vlerësimi me anë të përsëritjes

Në programin e kësaj lënde janë paraparë 38 orë për përsëritje, punë praktike, punë laboratorit etj. Gjatë përsëritjes së lëndës apo diskutimeve me nxënës në klasë mësimdhënësi mund të marrë informacione të shumta për nivelin e arritshmërisë së tyre. Po ashtu mësimdhënësi, nga përsëritja e lëndës mund të shohë se sa e kanë përvetësuar nxënësit lëndën dhe ky mund të merret si kriter për vlerësimin e diturisë së nxënësve.

5. Vlerësimi me testeve

Mënyra e vlerësimit të njohurive të nxënësve të tërë klasës me teste të pyetjeve mësimdhënësit i ofron një pasqyrë për nivelin e zotërimit të lëndës mësimore. Kjo metodë do të jetë aq më e saktë sa më tepër kohë që mësimdhënësi do t'i kushtojë mënyrës së drejtë të përpilimit të testeve, duke pasur parasysh kriteret e hartimit të testeve sipas taksomanisë së Blumit të cilat janë: niveli i njohjes (kognitiv), kuptimi, zbatimi, analiza

dhe sinteza. Në çdonjërin gjysmëvjetor përpilohet nga një test me qëllim që mësimitdhënësi të krijojë një përfytyrim për dituritë e përvetsuara.

6. Aktiviteti në laboratorin e shkollës

Në ato shkolla ku ekziston kabineti i fizikë mësimitdhënësi sipas programit do të demonstrojë ose do të kryejë ndonjë matje të ndonjë madhësie ose dukurie fizike. Pikërisht gjatë këtij angazhimi të tij disa nxënës nga kureshtja do të jenë më aktivë se të tjerët. Ata do t'i ndihmojnë mësimitdhënësit në procesin e demonstrimit apo të matjes apo do ta kryejnë në mënyrë të pavarur, ashtu që ky aktivitet merret si një nga parametrat për vlerësimin e diturive të tyre.

7. Puna e pavarur praktike

Vlerësimi i diturive të nxënësve kryhet edhe nga ndjekja e aktivitetit të tyre në punë praktike individuale dhe në grupe. Nxënësit do të marrin nga arsimtari detyra konkrete, të cilat do t'i realizojnë në mënyrë praktike, p.sh. ndërtimi i një elektroskopi, elektrometri, ndonjë makine të thjeshtë etj.

HYRJJE

Historia si shkencë shoqërore, në klasën VI, ka për objekt të studimit të kaluarën e shoqërisë njerëzore nga kohët më të lashta e deri në Mesjetën e zhvilluar – shekullin X – të. Ajo na mëson si kanë jetuar njerëzit, shkaqet e ndryshme të mënyrës së jetës, faktorë që kanë ndikuar në ndryshimin e jetës në shoqëri dhe të njerëzimit në përgjithësi.

QËLLIMET

- Zotërimi i njohurive dhe koncepteve për të kaluarën e shoqërisë njerëzore,
- Njohja e kulturave të ndryshme dhe dallimet në mes tyre që nga lindja e shoqërisë njerëzore e deri në Mesjetën e zhvilluar
 1. mënyrat e jetës dhe të të menduarit
 2. personalitetet e njohura
 3. ngjarjet e rëndësishme historike
 4. vendet dhe institucionet shoqërore dhe shtetërore
 5. besimet e popujve të ndryshëm
- kuptimin e ndërlidhjeve dhe ndikimeve në shoqëri,
- arsimimin demokratik,
- zhvillimin e autonomisë të nxënësi,
- zhvillimin e tolerancës,
- zhvillimi i vetërespektit dhe respektit për të tjerët,
- të mësojnë dhe të përcaktojnë drejt kuptimin dhe përdorimin e terminologjisë bazë të Historisë, si dhe të zhvillojnë mendimin historik si mjet i të kuptuarit të proceseve,
- shoqërore,
- Të zhvillojnë shprehitë dhe shkathtësitë për shfrytëzimin e dokumenteve, burimeve, materialeve, hartave historike, fotografive, albumeve, teksteve historike, historisë gojore etj.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Të kuptojnë proceset e zhvillimit të shoqërisë njerëzore nga parahistoria deri në Mesjetën e Zhvilluar;
- Të njohin tiparet kryesore të bashkësive të para njerëzore, antikitetit dhe periudhës së Mesjetës së Hershme;
- Të njohin mënyrën e organizimit të jetës në periudhat e hershme dhe të bëjnë krahasime me mënyrën e organizimit të jetës së sotme.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

- Të identifikojnë kuptimin e termave bazë të periudhës parahistorike, antikitetit dhe të Mesjetës së Hershme;
- Të dallojnë konceptet bazë të kohës së gurit dhe asaj të metaleve;
- Të përcaktojnë dhe të identifikojnë mënyrën e transformimit të njeriut nga faza e parë deri në të fundit;
- Të identifikojnë mënyrën e llogaritjes së kohës në histori;
- Të dallojnë mënyrën e organizimit të jetës së njerëzve (familjen, gjininë, fisin);
- Të përshkruajnë ndarjen e shoqërisë në klasa kryesore, në kasta dhe në shtresa në Antikë dhe Mesjetë (skllavopronar-skllavë dhe feudal-bujkrob, fshatar);
- Të kuptojnë dhe të jenë në gjendje të përshkruajnë organizimin shoqëror e shtetëror në Kohën e Vjetër dhe Mesjetë.

SHKATHTËSITË E SYNUARA

Përmes mësimin të historisë si shkencë shoqërore, në klasën e VI synohet që nxënësit t'i fitojnë këto shkathtësi:

- Orientimin në kohë dhe në hapësirë që nga rrethi ku jeton dhe më gjerë,
- Aftësitë për zhvillimin e personalitet të gjithanshëm,
- Të zhvillojnë aftësitë për të kuptuar dhe për të gjykuar drejt shkaqet dhe faktorët e zhvillimit të shoqërisë njerëzore,
- Aftësitë për t'ia përshtatur sjelljet e veta kritereve të një shoqërie demokratike e të qytetëruar,
- Të çmojë dhe të respektojë kulturën dhe traditat e popullit të vet dhe të popujve të tjerë,
- T'i zhvillojë shkathtësitë për komunikim me të tjerët.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

2 orë në javë, 74 orë në vit

(54 orë zhvillim, 6 orë mësim zgjedhor dhe 14 orë përsëritje)

Nënkategoritë- Temat	Objektivat	Përmbajtja programore (njësitë mësimore)	Rezultatet e pritura	Ndërlidhja
Hyrje në lëndën e Historisë	Njohja me objektin e mësimin të historisë si dhe me llogaritjen e kohës dhe periodizimin.	- Çfarë studion historia? - Njësimi i kohës dhe periodizimi i historisë	Dallon specifikat kryesore të lëndës së historisë dhe di për llogaritjen e kohës	Arkeologjinë, artet, matematikën, gjeografinë, etj.
Periudha parahistorike	Njohja me fazat e para të shoqërisë njerëzore dhe karakteristikat e saj	- Njerëzit e parë - Koha e gurit - Koha e metaleve	Fiton koncepte të qarta për jetën e njerëzve në kohën e gurit dhe të metaleve	Artet, biologjinë, arkeologjinë, gjeografinë, etj.
Lindja e Lashtë	Njohja me konceptin e organizimit të shteteve, organizimin hierarkik, shoqëror-ekonomik dhe njohja me besimin dhe kulturën	- Egjipti dhe Mesopotamia - Kina, India dhe Persia - Kultura e popujve të Lindjes së lashtë	Dallon karakteristikat kryesore të shteteve të para, përshkruan jetën shoqërore-ekonomike të kohës. Njeh mënyrën e besimit dhe perënditë	Arkeologjinë, mitologjinë, gjeografinë, artet matematikën, letërsinë

Popujt e lashtë të Ballkanit	Njohja me etninë e popujve të lashtë të Ballkanit	- Pellazgët, ilirët, grekët, maqedonasit dhe thrakët	Bën dallimet e mënyrës së organizimit të jetës, dallimet etnike, kulturore dhe origjinën e tyre.	Gjeografinë, biologjinë, gjuhën, arkeologjinë, mitologjinë, arkitekturën, etj.
Greqia e Vjetër	Njohja me kulturën e hershme të Mesdheut dhe lëvizjet e popullsisë. Njohja me organizimin shtetëror, luftërat. Njohja me shoqërinë, personalitetet e shquara, kulturën, edukimin, besimin etj.	<ul style="list-style-type: none"> - Greqia në kohën më të hershme - Qytet-shtetet greke. Athina dhe Sparta - Ngulimet greke në Mesdhe dhe Iliri - Luftërat greko-persiane dhe luftërat e Peloponezit - Kultura greke - Edukimi i fëmijëve në Greqinë e Vjetër - Iliada e Odiseja - Personalitetet e shquara 	Di t`i dallojnë specifikat kryesore të organizimit shtetëror, ngulimeve të popullsisë, luftërave, mënyrën e edukimit të fëmijëve, kulturën, lojërat olimpike. Njeh personalitetet dhe besimin	Filozofinë, letërsinë, artin, edukatën fizike, arkitekturën, edukatën qytetare, matematikën, gjeografinë, etj.

<p>Maqedonia e Lashtë</p>	<p>Njohja me mendimet për origjinën e maqedonëve të lashtë. Njohja me shtetin në kohën e Filipit II, Lekës së Madh, si dhe kulturën helene.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Maqedonia - Filipi II dhe Leka i Madh 	<p>Dallon pikëpamjet për origjinën e maqedonëve të lashtë. Njëherit specifikat e shtetit në kohën e Filipit II dhe Lekës së Madh. Dallon karakteristikat kryesore të kulturës helene</p>	<p>Arkeologjinë, artet, gjeografinë, arkitekturën, letërsinë, filozofinë, etj.</p>
<p>Roma e vjetër</p>	<p>Njohja me Romën e Lashtë, popullsinë dhe zgjerimin territorial. Kryengritjet e skllëvërve dhe luftërat qytetare. Njohja me organizimin shtetëror, kulturën, artin dhe krishterimin. Njohja me shkaqet e shthurjes së Perandorisë Romake dhe personalitetet e shquara</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Banorët e lashtë të Gadishullit Apenin - Zgjerimet e Romës në Itali dhe Mesdhe - Kryengritjet e skllëvërve - Triumvirati i parë dhe i dytë - Perandoria Romake gjatë shek. I-II. - Lindja dhe përhapja e krishterimit. - Kriza dhe shthurja e Perandorisë - Kultura dhe besimi - Personalitetet e shquara romake 	<p>Di për kohën e themelimit të Romës. Dallon ndryshimet dhe progresin shoqëror dhe shtetëror. Di të dallojë raportet në mes shtresave shoqërore. Di për paraqitjen dhe përhapjen e krishterimit. Di për kulturën. Njeh oratorët, filozofët, poetët dhe personalitetet të tjera me rëndësi</p>	<p>Artin, gjeografinë, edukatën qytetare, filozofinë, letërsinë etj</p>

Iliria	Njohja me origjinën, shtrirjen dhe vendbanimet. Njohja me fiset kryesore ilire, lindjen dhe zhvillimin e shteteve, luftërat, zhvillimet shoqërore-ekonomike, rolin e gruas në shoqërinë ilire dhe edukimin e fëmijëve. Njohja me luftërat, kryengritjet, kulturën, qytetërimin, besimin, krishterimin, si dhe njohja me personalitetet e shquara ilire.	<ul style="list-style-type: none"> - Ilirët, vendbanimi dhe fiset kryesore - Mbretëria e Enkelejëve dhe e Taulantëve - Mbretëria e Epirit - Mbretëria Ardiane - Mbretëria Dardane - Jeta ekonomike dhe shoqërore te Ilirët - Gruaja, dhe edukimi i fëmijëve në Iliri - Dardania në kohën e sundimit romak - Kryengritja e madhe ilire (6-9 e.s.) - Kultura dhe besimi te iliret - Qytetet ilire - Përhapja e krishterimit në Iliri - Personalitetet e shquara ilire 	Di për origjinën dhe fiset kryesore. Njeh shtetet dhe shtrirjen e tyre. Njeh dhe kupton kushtet ekonomike dhe shoqërore, rolin e gruas dhe edukimin e fëmijëve. Dallon veshjet, zbulimet, veglat e punës, armët, mjekësinë, ilaçet, kulturën, besimin, perënditë dhe personalitetet e shquara ilire.	Arkeologjinë, artin, muzikën, gjeografinë, edukatën qytetare, biologjinë, etj.
Mesjeta e Hershme	Njohje me veçoritë themelore të feudalizmit të hershëm. Dyndjet e popujve në Evropë. Njohja me shtetin e hershëm frank.	<ul style="list-style-type: none"> - Dyndjet e popujve në Evropë - Shteti i frankëve 	Di për ndryshimet shoqërore të feudalizmit të hershëm. Kupton rrethanat e formimit dhe zhvillimit të shtetit frank.	Gjeografinë, artet, letërsinë, gjuhët evropiane.

<p>Bizanti Arabët</p>	<p>Njohja me shthurjen dhe ndarjen e Perandorisë Romake. Fuqizimi i Perandorisë Bizantine. Pozita e popullsisë iliro-arbënore në kuadër të Perandorisë Bizantine. Njohja me ndryshimet etnike në Ballkan. Njohja me arabët, lindjen e islamizmit dhe kulturën arabe</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Perandoria Bizantine deri në shek. XI - Arbërit në Perandorinë Bizantine - Kultura e Arbërit - Themat në Arbëri - Personalitet e shquara të Perandorisë Bizantine - Ardhja e sllavëve në Ballkan - Arabët-Lindja e islamizmit - Kultura arabe 	<p>Di për veçantit themelore të Perandorisë Bizantine. Di për pozitën, organizimin administrativ dhe kulturën e arbërit dhe rolin e personaliteteve arbërore në Perandorinë Bizantine. Di për kohën, mënyrën dhe pasojat e vendosjes së sllavëve në Ballkan. Di për paraqitjen e arabëve, islamizmin dhe kulturën e tyre</p>	<p>Gjeografinë, artet, letërsinë, muzikën matematikën, edukatën qytetare, etj.</p>
<p>Sllavët e Jugut në Mesjetën e Hershme</p>	<p>Njohja me veçoritë e feudalizmit të hershëm të Sllavët e Jugut. Njohja me kulturën dhe besimin e Sllavëve të Jugut.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Feudalizmi i Hershëm - veçoritë kryesore - Karantania, Kroacia dhe Bosnja - Bullgaria, Rasha, Dukla - Kultura e Sllavëve të Jugut gjatë Mesjetës së Hershme 	<p>Dallon veçoritë kryesore të feudalizmit të hershëm të sllavët e Jugut. Di për veçoritë e kulturës dhe besimit të Sllavëve të Jugut</p>	<p>Gjeografinë, gjuhën dhe letërsinë, artet, bujqësinë, etj.</p>

Vërejtje: 6 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë vendase etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, Instituteve, monumenteve etj.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Lënda e historisë mund të mësohet dhe interpretohet përmes metodave dhe teknikave të ndryshme. Metodologjia e re e mësimdhënies dhe nxënies e bën nxënësin më të aftë për të vështruar, për të gjykuar drejt, ngjarje të rëndësishme historike pavarësisht se në çfarë forme i paraqiten ato.

Mësimdhënësi bën zgjedhjen e metodave dhe teknikave mësimore duke ua përshtatur aftësive dhe kërkesave të nxënësve. Ai duhet të jetë i kujdesshëm për shkallën e arritshmërisë së objektivave gjatë procesit mësimor.

Që të jetë sa më i suksesshëm mësimi i historisë duhet përdorur metoda dhe teknika sa më të shumëllojshme me qëllim që të nxitet dinamizimi i orës, të motivohen nxënësit për punë duke pasur parasysh se nxënësit kanë nivele të ndryshme të aftësive dhe njohurive.

Për të pasur mësimdhënie dhe mësimnxënie të suksesshme duhet përdorur disa nga këto metoda dhe teknika:

- Puna me gjithë klasën
- Puna në grupe
- Puna në çifte
- Puna individuale
- Metodadat e vëzhgimit, diskutimit, demonstrimit, interpretimit,
- Vërshimi i shpejtë i ideve (Brainstorming)
- Puna kërkimore, hulumtuese, praktike, krahasuese
- Loja me role
- Të mësuarit problemor
- Kllasteri (teknikë e mendimit kritik–grumbulli apo pema e mendimeve)
- Pesëvargëshi,
- Xhigsou,
- Historia gojore etj.
- Vizita në: muze, kinema, ekspozita, institucione kulturo - historike etj.

Përdorimi i suksesshëm i të gjitha këtyre metodave dhe teknikave mundëson mësimdhënien me nxënësin në qendër dhe zhvillimin e mendimit kritik.

Përdorimi i metodave dhe teknikave nuk garanton sukses nëse mësimdhënësi nuk planifikon me kujdes përmbajtjen mësimore, caktimin e objektivave, përshtatjen e teknikave për realizimin e objektivave dhe nëse nuk vëzhgon si mendojnë dhe punojnë nxënësit për përpunimin e informacionit.

VLERËSIMI

Vlerësimi është një proces i vrojtimit të vazhdueshëm i dokumentimit të punës së nxënësve dhe ka të bëjë me çdo lloj veprimtarie dhe matje që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve .

Në mënyrë që të sigurojmë informacione të mjaftueshme për të vlerësuar arritjet e nxënësve në lëndën e historisë, duhet të përdoren mjete dhe teknika të ndryshme.

Disa qëllime të vlerësimit:

- Të identifikojë përparimin e nxënësve dhe t'iu ofrojë të dhëna të mjaftueshme;
- Të motivojë nxënësit për punë;
- Të sigurojë informacione për shkallën e arritshmërisë së objektive;
- Të ndihmojë nxënësin dhe mësuesin;
- Të përmirësojë nxënien dhe mësuesin;
- Të sigurojë informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm etj.

Rëndësia e këtyre qëllimeve është:

- Përmes vlerësimit, mësuesin siguron informacione se sa e suksesshme ka qenë mësuesia e tij për të arritur rezultatet e caktuara dhe në bazë të arritjeve të tyre mësuesin t'ju ofrojë sqarime nxënësve dhe të planifikojë përmbajtjen mësimore sipas nevojave të nxënësve në të ardhmen.

Vlerësimi është i rëndësishëm për të kuptuar sa janë në gjendje nxënësit të punojnë një përmbajtje mësimore me qëllim që mësuesin të organizojë më mirë punën në grupe dhe për të vërtetuar në çfarë mase i kanë përvetësuar nxënësit njësitet e mësuara. Në bazë të rezultateve, të identifikojë nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë dhe të bëjë përforsimin e atyre njësive.

Tipat e vlerësimit

- **Vlerësimi formues** ka për qëllim ta udhëzojë mësuesin në planifikim dhe të nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.
- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim që të zbulojë shkallën e arritjes së objektive, pas një periudhe të caktuar të mësuesin p.sh. pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj..

- **Vlerësimi në bazë të kriterëve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara p.sh. krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësime-dhënës të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë përmirësimin e tyre.
- **Vlerësimi diagnostifikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.
- **Vlerësimi formues** dhe diagnostikues nuk vlerëson me nota por në bazë të tyre mësime-dhënësi planifikon punën e tij.
- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.
- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkolles (specialistë të nivelit të lartë).
- **Vlerësimi i përditshëm** bazohet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.
- **Vlerësimi në proces** bazohet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune apo detyre në zhvillim.

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- *Kontrulli i zakonshëm i veprimtarive në klasë*
- *Detyrat e shtëpisë*
- *Testet*

Mësime-dhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre

Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurojmë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë, në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherësh mund të jetë edhe e padobishme në rast se në vend që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës, nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

Format e testeve janë:

- Me gojë
- Me shkrim
- Përmes paraqitjes grafike etj.
- Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësi, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anë negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj.
- Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari tjera, p.sh.
Vlerësimi i eseve
Vlerësimi me dosje
Vetëvlerësimi...etj.

Në fund të klasë së VI nxënësit duhet:

- të kuptojnë dhe të dallojnë historinë si lëndë mësimore;
- të kuptojnë drejt mënyrën e llogaritjes së kohës te popujt e vjetër. Të dallojnë ç'është viti, dekada, shekulli dhe mijëvjeçari;
- të njohin llogaritjen e kohës para dhe pas lindjes së Krishtit;
- të identifikojnë dhe njohin rrjedhat shoqërore, shtetërore dhe kulturore te shtetet antike;
- të dinë dhe të kenë informacione të mjaftueshme për origjinën e popullit të vet, të fqinjëve si dhe rrjedhat e zhvillimit shoqëror, shtetëror, ekonomik dhe kulturor;
- të kuptojnë rrjedhat shoqërore, shtetërore, ekonomike, kulturore, fetare si dhe karakteristikat kryesore të Mesjetës;
- të njohin personalitetet historike nga periudha e antikës;
- të njohin personalitetet historike nga periudha e mesjetës;
- të aftësohen të përdorin dhe t'i kuptojnë fotografitë, hartat, burimet materiale dhe ato të shkruara, filmat dokumentar, filmat artistik me përmbajtje historike etj.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE:

1. *Aspekte të mësimdhënies së historisë*, Prishtinë, 1997
2. *Aspekte të mësimdhënies së historisë*, Tiranë, 1995
3. **Bardhyl Musai**, *Psikologjia e Edukimit*, Shtëpia Botuese: Pegi, Tiranë, 1999

4. **Bardhyl Musai**, *Metodologjia e Mësimdhënies*, Tiranë 2003
5. **Vilson Kuri, Ragip Zekolli, Bep Jubani**, *HISTORIA 5*, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 1999
6. **Dr. Bep Jubani, Dr. Isa Bicaj, Dr. y Vilson Kuri**, *HISTORIA për klasën e parë të shkollave të mesme*, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
7. **Dr. Fehmi Rexhepi, Dr. Isa Bicaj**, *HISTORIA për klasën e parë të shkollave të mesme profesionale*, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
8. **Grup autorësh**, *Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, nën redaktimin e prof. Dr. Hysni Myzyrit, botoi: Siprinti, Prizren, 2000
9. **Grup autorësh**, *Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët par të ndërtuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000*, botues: EUROCLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë, Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë, Tiranë, 2003
10. **Mikel Pjetrush**, *Atlas historik i botës*, Shtëpia Botuese: Camaj – Pipa, Shkodër, 2001
11. **MASHT**, *Plani dhe programi mësimor 9*, përgatiti për shtyp: Libri Shkollor, Prishtinë, 2002

SYNIMET E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Mësimi i gjeografisë është **orientuar në studimin e shfrytëzimit të hapësirës gjeografike në dobi të shoqërisë njerëzore.**

Gjeografia e ka zgjeruar gamën e problemeve, të cilat i studion. Në qendër të vëmendjes janë problemet e hapësirës, ligjeve të saj, problemet e ekuilibrit në natyrë, të marrëdhënieve shoqëri-mjedis gjeografik, problemet e shpërndarjes së njeriut dhe prodhimit në hapësirë, problemet serioze popullore dhe të ekonomisë në vende të ndryshme të botës.

Zhvillimi i gjeografisë u arrit edhe në sajë të avancimit të madh të metodave shkencore të studimit, të cilat u ndërtuan mbi një koncept, strukturë dhe aparat të ri. **Aktualisht gjeografia shkollore duhet të synojë formimin e vetëdijes hapësinore.**

Sa i përket kohës së fillimit të mesimit të lëndës dhe ngarkesës së saj gjatë viteve të shkollimit janë shtuar përpjekjet për t'a lidhur më mirë të mësuarit e gjeografisë më moshën e nxënësve. Kjo lidhje bazohet në pikëpamjet e sotme të psikologëve për mundësitë e zgjerimit shkallë-shkallë të përfytyrimeve hapësinore të fëmijëve me rritjen e moshës së tyre.

HYRJE

Gjeografia si shkencë hapësinore dhe shoqërore, në klasën VI, ka për objekt studimi Tokën, popullsinë, raportet e ndërsjella dhe Kosovën si regjion. Gjeografia i mëson nxënësit që të krijojnë kuptim të plotë dhe të drejtë mbi objektet dhe dukuritë natyrore e shoqërore (humane) në përgjithësi dhe në rastin e Kosovës në veçanti si hapësirë e jetës për popullsinë, e cila jeton në të.

QËLLIMET

Qëllimet e mësimit të gjeografisë janë që nxënësit:

- të zotërojnë njohuritë dhe konceptet për gjeografinë si shkencë, Tokën dhe Gjithsinë, lëvizjet e Tokës, sistemet fizike, humane dhe Kosovën, duke zhvilluar mënyrën e të menduarit kritik;
- të zhvillojnë aftësitë për të formuluar dhe zgjedhur probleme me ndihmën e gjeografisë, nga vendi, hapësira, mjedisi natyror, mjedisi human, rajoni dhe mjedisi e shoqëria;
- të zhvillojnë aftësitë për të përdorur modele të thjeshta gjeografike (si skica, plane, modele);
- zhvillimi i aftësive për vlerësim dhe përdorim të librave, globit, hartave, atllaseve, literaturës, leksikoneve, enciklopedive, internetit dhe programeve tjera kompjuterike, arsimore televizive;
- zhvillimi i aftësive për punë në bashkëpunim me komunitetet tjera.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Kuptimi i formës, madhësisë dhe levizjeve të Tokës si planet;
- Njohja me Gjithësinë, Sistemin Diellor, trupat qiellor, vetitë dhe relacionet në mes tyre;
- Të njohurit me rrjedhimet e formës dhe lëvizjeve të Tokës rreth boshtit të vet dhe Diellit për njerëzit dhe botën e gjallë;
- Të njihen me hartat, sistemin e koordinatave, përcaktimin e pikave, vendeve, largësive dhe shenjave hartografike;
- Të njihen me sferat e Tokës, përbërësit kryesor, raportet në mes tyre dhe rëndësinë për njerëzit dhe botën e gjallë;
- Të dinë për përhapjen jo të barabartë të njerëzve në Tokë, për rritjen e popullsisë, shtimin natyror, migrimet, dallimet në
- përkatsinë etnike, racore, fetare, organizimin shtetëror e ndërkom-bëtar, zhvillimin ekonomik e social në përgjithësi;
- ta njohin natyrën dhe shoqërinë e Kosovës, nivelin e zhvillimit dhe bashkëpunimin me vendet fqinje dhe tjera.

OBJEKTIVAT E VEÇANTA

Nxënësit duhet:

- të jenë në gjendje të përshkruajnë, formën e Tokës, shtrirjen e kontinenteve dhe deteve, raportet në mes tyre;
- të tregojnë në mënyrë grafike raportet në mes tokës dhe ujit;
- t'i njohin dallimet në mes trupave qiellorë;
- t'i kuptojnë llojet e lëvizjeve të Tokës rreth boshtit dhe Diellit dhe pasojat e tyre (ndërrimin e ditës dhe natës, stinëve të vitit, kohën lokale e zonale, kufirin e datës);
- t'i njohin ligjshmëritë themelore të pozitës dhe lëvizjes së Tokës në Gjithësi;
- t'i dallojnë brezat e nxehtësisë, brezat e vegjetacionit dhe rolin e tyre për jetën e njerëzve;
- të kuptojnë meridianet dhe paralelet dhe rëndësinë tyre për përcaktimin e pozitës gjeografike të vendeve dhe shteteve;
- të dinë se Toka mund të paraqitet edhe në rrafsh, hartë;
- të kuptojnë çka është shkalla e zvogëlimit, shkalla numerike e grafike, çka janë planet, hartat dhe llojet e tyre;
- të njihen me shtresat kryesore të Tokës, me dukuritë e vullkaneve e termeteve, me format kryesore të korës së Tokës, me krijimin e formave, me rolin e forcave nga brendia dhe veprimin e forcave të jashtme;
- të dallojnë lartësinë absolute dhe relative dhe llogaritjen e tyre;
- të kuptojnë ndërtimin e atmosferës, strukturën vertikale, proceset termike, dinamike, motin dhe klimën;
- të dinë për objektet ujore, për qarkullimin e ujit në natyrë, vetitë e ujit, rëndësinë e ujit për proceset natyrore dhe shoqërinë, shpërndarjen jo të njëjtë në sipërfaqen e Tokës dhe nevojën për ruajtje nga ndotja;
- të kuptojnë se bota bimore e shtazore varet prej kushteve klimatike, hidrografike e tokësore, se ato kanë shtrirje zonale horizontale e vertikale dhe përfaqsohen nga llojet e ndryshme;
- të kuptojnë proceset ekstreme në natyrë dhe shkaqet e zhvillimit të tyre, të identifikojnë dhe klasifikojnë dukuritë kryesore të fatkeqësive natyrore dhe rrethinën ku jetojnë e më gjërë;
- të kuptojnë dhe interpretojnë rritjen e numrit të njerëzve në ekumenë dhe zgjerimin e saj, shpërndarjen jo të barabartë të popullsisë në ekumenë varësisht prej kushteve natyrore dhe shkallës së zhvillimit shoqëror-ekonomik;

- të kuptojnë dhe interpretojnë shtimin natyror dhe mekanik, komponentet e shtimit, strukturat themelore të popullsisë, migrimin e njerëzve, kuptimin, llojet, shkaqet, pasojat e migrimëve;
- të dinë për veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese, për degët ekonomike, joekonomike, për mostrën e tyre hapësinore;
- të dinë për kuptimin e vendbanimit, për objektet që e përbëjnë, për formën (e shpërndarë, e dendur), tipin (fshat, qytet), madhësinë (vogël, mesem, i madh), planin (strukturën fizike), funksionin dhe raportin me rrethinën;
- të kuptojnë pozitën gjeografike të Kosovës dhe rolin e saj në ngjarjet kulturore, ekonomike e politike;
- të krijojnë kuptimin mbi karakteristikat natyrore të Kosovës dhe rolin e tyre në shpërndarjen e popullsisë, vendbanimeve dhe ekonomisë;
- të aftësohen për të analizuar dinamiken, strukturat e popullsisë, migrimet, vendbanimet dhe tipat e tyre;
- të dinë të shpjegojnë kushtet dhe faktorët e zhvillimit ekonomik, strukturat e ekonomisë dhe rajonet tipike të Kosovës.

SHKATHTËSITË E SYNUARA

Zhvillimi i shkathtësive, shprehive dhe vlerave

Nxënësit duhet

- të jenë në gjendje t'i dallojnë shenjat konvencionale të legjendës së hartës, t'a përdorin shkallën e zvoglimit, të përcaktojnë largësitë në mes objekteve në hartë, t'i përdorin simbolet dhe ngjyrat;
- të ndërtojnë dhe lexojnë grafikët, diagramet, tabelat, hartat dhe modelet e përpiluara për qëllime të caktuara mësimore,
- të aftësohen për përshkrimin, hulumtimin, shpjegimin, regjistrimin e tipareve natyrore të Tokës si përmbajtje madhore të gjeografisë, të cilat përcaktojnë veçoritë e vendit (format e ndryshme relievo-re, objektet ujore, elementet e motit e klimës);
- të demonstrojnë të kuptuarit e nocioneve të lartësisë relative dhe absolute, duke përdorur harta fizike me shkallë të ndryshme;
- të ndërtojnë modele të thjeshta për format e ndryshme të relievit;
- të ndërtojnë grafike dhe diagrame për elementet klimatike e hidrografike dhe të dinë t'i interpretojnë ato;
- të zbulojnë informacione gjeografike për popullsinë, mjediset urbane, rurale nga burimet e drejtpërdrejta (p.sh. vëzhgimet, inter-

vistat), nga burimet dytësore (hartat, grafikët, modelet, tabelat, CD-të etj.);

- të lokalizojnë në hartë vendbanimet kryesore urbane dhe shpërndarjen e popullsisë në regjione të ndryshme të botës;
- të ndërtojnë dhe të interpretojnë lloje të shumta grafikësh, hartash, grafikone etj. me karakter mësimor (psh. në lidhje me numrin dhe shpërndarjen e popullsisë, qendrat e banuara, objektet dhe prodhimet e degëve të ndryshme ekonomike etj.);
- të paraqesin rezultatet e kërkimeve dhe vëzhgimeve, duke përdorur mjetet e mediave, raportimet gojore e me shkrim, tabela, grafikë, harta etj.;
- të mbajnë qëndrim kritik ndaj shfaqjeve negative të ndërhyrjes së njerëzve në mjedisin ku ata jetojnë;
- të përcaktojnë në hartë shtrirjen e hapësirës së Kosovës, kufijtë dhe madhësinë;
- të krahasojnë Kosovën me vendet tjera, duke përdorur harta, tabela, diagrame në lidhje me sipërfaqen, klimen, relievin, hidrografinë, popullsinë, ekonominë, kulturën, gjuhën etj.;
- të paraqesin informacione gjeografike për lidhjet e ndërsjella të Kosovës me vendet tjera të botës, duke përdorur mjetet e mediave, raportimet gojore, me shkrim, hartat, skicat, tabelat, grafiket etj.;
- të ndërtojnë dhe interpretojnë harta të thjeshta tematike të Kosovës;
- të përdorin fjalorin e mësuar të nocioneve për vendin, hapësirën e Kosovës, mjedisin fizik, human, regjionet etj.

Struktura e përmbajtjeve programore:

Kategoritë	Numri i orëve gjithsej	%
Hapsira dhe sistemet fizike	22	30
Sistemet humane	10	13
Rajonet-Kosova	22	30
Mësim zgjedhor	6	8
Përsëritje	14	19
Gjithsej	74	100

Tabela e përmbajtjeve-temave, rezultateve të pritura, kuptimeve dhe lidhjeve ndërlëndore

Përmbajtjet Temat	Rezultatet e pritura	Nocionet themelore	Lidhjet ndërlëndore
Gjeografia, lënda e studimit, lidhja me shkencat tjera	Nxënësi duhet të shpreh kuptimin e gjeografisë si shkencë, ndarjen e saj dhe t'i bëjë ndërlidhjet me shkencat tjera	Disiplinat e gjeografisë fizike dhe humane	Ndërlidhjet në mes disiplinave të gjeogra fisë, gjeologjisë, biolo gjisë, fizikës.
Forma dhe madhësia e Tokës	Nxënësi duhet të dijë t'a shprehë formën, madhësinë, dimensionet e Tokës dhe figurativisht t'a demonstrojë formën e saj	Forma e sferës, gjeoidit, rrethi i ekuatorit, rrethi i meridianit, diametri i poleve.	Ndërlidhja me fizikën, astronominë, matematikën
Toka dhe Gjithësia	Nxënësi duhet të shprehë kuptimin e Gjithësisë, Galaktikës, kupës qiellore, trupave qiellorë dhe të paraqesë figurativisht pozitën e Tokës në Sistemin Diellor.	Kupa qiellore, zeniti, kozmosi, planetet, yjet, satelitet, meteoret,asteroidet, kometet, galaktika,viti i drites	Ndërlidhet me fizikën, matematikën, gjeologjinë.
Levizjet e Tokës dhe rrjedhimet	Nxënësi duhet të shprehë kuptimet e rrotacionit, revolucionit, të jetë në gjendje të tregojë me mjete vizuele (glob, planetarium, qiri etj.), ndërrimin e ditës e natës, stinëve të vitit dhe bre zave të nxëhtësisë si rrjedhojë e lëvizjeve të Tokës.	Rrotacioni, revolucionit, boshti i Tokës, ekliptika, orbita, ekuinoksi, solstici, brezat e nxëhtësisë.	Lidhja me matematikën, astronominë, biologjinë.

Paraqitja e sipërfaqës së Tokës në glob dhe hartë	Nxënësi duhet të shpreh kuptimin e hartës, globit, rrjetit të paraleleve dhe meridianeve, shkallës së hartës, izohipseve, izobateve, lartësinë absolute, relative, të dijë të përdorë globin dhe hartën gjeografike për të paraqitur sipërfaqen e Tokës në rrafsh, përcaktimin e vend ndodhjes, të pikave në tokë, përcaktimin e largësive në plan dhe hartë, përdorimin e shenjave hartografike.	Harta, globi, paralelet, meridianet, hemisfera, tropiku, rrethi polar, rrjeti koordinativ, shkalla e hartës, gjerësia, gjatësia gjeografike, projektioni, plani, shenjat hartografike, atlasit, izohipset, izobarët, koha lokale, zonale, kufiri i datës.	Lidhja me hartografinë, matematikën, gjeodezinë
Harta, elementet, përmbajtja dhe përdorimi	Nxënësi duhet të jetë në gjendje të paraqesë, të përdorë, sqarojë elementet e hartës dhe të dallojë llojet e hartave.	Planiglobi, projektioni, shkalla e zvogëlimit, shkalla numerike, grafike, plani, harta, shenjat hartografike, llojet e hartave, atlasit.	Lidhja me hartografinë, gjeodezinë, matematikën
Shpërndarja e masave tokësore dhe ujore në Tokë	Nxënësi duhet të shprehë dhe krahasojë sipërfaqen e Tokës dhe ujit përmes globit dhe hartës.	Sferat e Tokës, atmosfera, hidrosfera, litosfera, biosfera, kontinentet, deti botëror, ujdhesat, siujdhesat, arqipelagu.	Lidhja me gjeologjinë, hidrologjinë, fizikën, biologjinë.
Përbërja dhe ndërtimi i Tokës	Nxënësi duhet të dijë për koren e tokës, mbështjellsin, bërthamen, shkëmbijtë, kontinentet, oqeanet, format e relievit, vullkanet, termetet, fuqitë e brendshme, të jashtme dhe të dijë të paraqesë këto përmes skicave e modeleve të thjeshta	Format e relievit, fuqitë e brendshme, të jashtme, lëvizjet tektonike, orogjene, epirogjene, korja, mbështjellsin, bërthama, vullkani, krateri, magma, llava, erupcioni, termeti, epiqendra, sizmografi.	Lidhjet me gjeologjinë.

Relievi, krijimi dhe format	Nxënësi me ndihmen e skicave, modelve dhe hartave duhet të dijë të shprehë dhe tregojë format e relievit.	Malet, vargmalet, fushat, luginat, lartësia absolute, relative, malet e reja, molloke, grykë, kanjon, deltë, klif, cirk, luginë akullnajore, dynë etj.	Lidhjet me gjeologjinë, hartografinë.
Roli i relievit në jetën dhe veprimtarinë e njerëzve	Nxënësi përmes shembujve konkret të tregojë rolin e relievit në shpërndarje, jetën e njerëzve dhe veprimtaritë e tyre.	Format relievore dhe shpërndarja e popullsisë, format dhe tipat e vendbanimeve, format dhe llojet e ekonomisë.	Lidhjet mes gjeomorfologjisë, popullsisë, vendbanimeve dhe ekonomisë.
Atmosfera, moti dhe klima	Nxënësi duhet të dijë të shprehë kuptimin për atmosferën, përbërjen e saj, motin dhe klimën, shpërndarjen e pabarabartë të nxehtësisë në Tokë dhe shfaqjen e brezave të nxehtësisë	Shtresat e atmosferës (troposfera, stratosfera, mezosfera, jonosfera, termometri, barometri, erëmatsi, pluviometri, anemometri, izoterma, presioni atmosferik, pasatet, antipasatet, meteorologjia, harta sinoptike.	Lidhjet me fizikën, kiminë, hartografinë
Ujrat tokësorë dhe nëntokësorë	Nxënësi me ndihmen e hartës, vizatimeve dhe mjete ve tjera duhet të shprehë format e ndryshme të ujit, objekteve ujore, shpërndarjen jo të barabartë të tyre, të demonstrojë të kuptuarit e nocioneve salinitet, baticë, zbaticë, valë, ishull, gadishull, gji, fjord, estuar, ngushticë detare, tokësore, lum, rrjet lumor, liqe, akullnaja, ujra nëntokësor.	Deti botëror, oqeanet, detet mesdhetare, anësore, kripësia, batica, zbatica, rrymat detare, desalimizimi, gji, ishull, gadishull, fjord, estuar, ngushticë detare, ujëndarës, ujëmbledhës, gejzer, etj.	Lidhjet me fizikën, kiminë, gjeofizikën.

Biosfera	Nxënësi përmes hartave duhet të jetë në gjendje të shprehë shpërndarjen e pabarabartë të formacioneve bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.	Zonat bimore, ekuatoriale, tropike, subtropike, mesatare, subpolare, polare, xhungla, savana, stepa, pampa se, lanose, kampose, tajga, tundra, oaza etj.	Lidhjet me biologjinë, bio dhe zoogjeografinë.
Numri i banorëve në Tokë, dendësia e banimit, shtimi natyror e mekanik dhe politika populluese	Nxënësi përmes hartave dhe numrave duhet të jetë në gjendje të shprehë rritjen dhe dendësinë jo të barabartë të popullsisë, shkallën e ndryshme të shtimit natyror, migrimet dhe format e migrimeve, njohuritë elementare për politiken popullore, të shprehë kuptimet për ekumenen, semi dhe anakumenen.	Ekumena, semiekumena, anakumena, dendësia, shtimi absolut, relativ i popullsisë, migrimi, emigrimi, imigrimi, natalitet, mortalitet, shtim natyror, fertilitet, shtim mekanik, politika popullore	Lidhjet me sociologjinë, ekonominë, hartografinë, statistikën, matematikën.
Vendbanimet, fshatrat dhe qytetet, dallimet në mes tyre.	Nxënësi duhet të shprehë kuptimin për vendbanimet, të kuptojë dallimet dhe ngjashmëritë në mes fshatrave dhe qyteteve përmes krijimit, forma, fizionomia, funksionet, raportet në mes tyre, procesin e rritjes së qyteteve dhe barazimit në mes tyre.	Kuptimi i fshatit dhe qytetit, lloji shpërndar, ngjeshur, format e vendbanimeve, funksionet, fizionomia, urb anizimi.	Ndërlidhja me historinë, arkitekturën, ekonominë.
Ekonomia, faktorët e zhvillimit, veprimtaritë, degët ekonomike dhe veçoritë e tyre	Nxënësit duhet të shprehë kuptimin e ekonomisë, veprimtarive, sektorët dhe degët e ekonomisë, faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe ngecjen e saj, të dinë të interpretojnë grafikët dhe diagramet në lidhje me të dhënat ekonomike.	Ekonomia, joekonomia, veprimtaritë, sektori parësor, dytësor, tretësor, degët, faktorët e zhvillimit.	Lidhjet ekonomia, sociologjia, politika
Pozita, kufijtë dhe madhësia e Kosovës	Nxënësi duhet të kuptojë pozitën qendrore të Kosovës në Evropën JL, kufijtë natyror e etnik, formën dhe madhësinë e sipërfaqës në krahasim me shtetet fqinje.	Pozita absolute dhe relative gjeografike, pozita qendrore, kufiri natyror, etnik, forma gati rrethore.	Lidhja me matematikë, gjeodezi

Natyrë e Kosovës dhe veçoritë e saj	Nxënësit duhet të shprehin të kuptuarit e veçorive dhe formave relivore, pasurive natyrore, veçorive klimatike, hidrografike, pedologjike dhe biogeografike, të analizojnë rëndësinë e veçorive natyrore përmes diagrameve, grafikoneve, tabelave dhe hartave.	Malet, vargmalet, Bjeshkët e Nemuna, Alpet Lindore Shqiptare, malet Qendrore, Lindore, Jugore, grykat, emrat e disa maleve, fushat, fushë gropat, luginat, emrat e tyre.	Lidhja me gjeologjinë, toponomastiken, biologjinë.
Popullsia dhe vendbanimet	Nxënësistë të bëjnë analizën e dinamikës popullore, shkaqet dhe pasojat, dendësinë e lartë, rolin e saj në migrime dhe zhvillim, llojet e vendbanimeve, raportet fshat – qytet	Rritja absolute, relative, rritja e shpejtuar, dendësia, llojet, fshatrat, qytetet, llojet dhe veçoritë e tyre.	Lidhjet me demografi, statistikë, arkitekturë.
Ekonomia dhe veçoritë e saj në Kosovë	Nxënësistë të shprehin të kuptuarit e veprimtarive prezente në Kosovë, niveli i zhvillimit të tyre, shkaqet dhe pasojat e nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik.	Veprimtaritë parësore, dytësore, tretësore, shërbimet, shkalla e zhvillimit, struktura e degëve.	Lidhjet me ekonominë.
Organizimi administrativ-politik	Nxënësistë duhet të kuptojnë ndarjen administrativ-politike të Kosovës, njësitë e ndarjes, nivelet e ndarjes dhe organizimit	Lokaliteti, bashkësia lokale, komuna, qendrat regjionale.	Lidhjet me jurisprudencën, politikën
Regjionet e Kosovës dhe veçoritë specifike të tyre	Nxënësistë duhet të kuptojnë se Kosova përbëhet prej disa regjioneve të cilët dallohen për nga veçoritë natyrore, sociale, kulturore, ekonomike.	Regjionet, krahinat, viset, trevat, Kosova, Dukagjini, Anamorava, Drenica, Llapi, Gollaku, Rugova, Hasi, Shala, Opoja, Gora, Siriniqi, Anamalet etj.	Lidhjet me gjeologji, morfologji, etnografi.

Vërejtje: 6 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, gjeografisë lokale etj. Në kuadër të këtyre orëve mund të bëhen vizita objekteve dhe dukurive natyrore, muzeve ose institucioneve më rëndësi për lëndën e gjeografisë.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Lënda e gjeografisë mund të mësohet dhe interpretohet përmes metodave dhe teknikave të ndryshme. Metodologjia e mësimdhënies dhe e nxënies ka rëndësi të madhe sepse e bën nxënësin më të aftë për të vëzhguar dhe gjykuar drejt objektet dhe dukuritë gjeografike pavarësisht nga forma e paraqitjes së tyre.

Mësimdhënësi bën zgjedhjen e metodave dhe teknikave të mëimit varësisht nga aftësitë psiko-motorike të nxënësve. Zgjedhja e metodave dhe teknikave duhet të jetë në përputhje me shkallën e arritshmerisë së objektivave në procesin mësimor.

Baza materiale e mëimit të gjeografisë

Mësimi bashkëkohor i gjeografisë mund të realizohet në tërësi duke përdorur:

- objektet mësimore (shkollën, klasën, kabinetin dhe natyrën);
- mjetet mësimore (vizuele dhe audio-vizuele);
- mjetet teknike ndihmëse (dërrasa e zezë, aparatet projektuese, TV, radio, arka e rërës) etj.;
- bibliotekën e shkollës;
- mjetet e punës së nxënësve (libri mësimor, libër leximi i gjeografisë, fletorja e punës, materialet ilustrative, treguesit hartografik, fotografitë, diagramet, grafikonet, tabelat, fjalori gjeografik, atlasit gjeografik, hartat konturë dhe memece, prerjet, bllok diagramet, skemat etj.);
- libër leximi i gjeografisë, i cili mund të shfrytëzohet si në mësimin e rregullt, plotësues dhe shtues.

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë kanë rëndësi të madhe, ngase lënda e gjeografisë ka karakter vizuel. Paraqitja indirekte e të vërtetës gjeografike si qasje didaktike më së shpeshti përciellet me **fjalën e gjallë**, ndërsa rol të rëndësishëm në procesin e nxënies të diturive të reja kanë **mjetet mësimore**. Kjo do të thotë se **demonstrimi** është detyrë e arsimtarit, kurse **vëzhgimi** është obligim i nxënësit.

Aty ku nuk është i mundshëm vëzhgimi i drejtpërdrejtë, nxënësit duhet t'i mundësohet vëzhgimi indirekt me përdorimin e:

- fotografive, filmit, emisioneve televizive, kompjuterit, modeleve, maketave, globit, hartave me shkallë të madhe (plane), të mesme, të vogël, gjeografike, fizike, shoqërore, ekonomike, memece etj.;
- vizatimeve gjeografike (vizatime lëndore, diagrame, grafikone, hartograme);
- vlerave numerike (përmes tabelave etj.);
- librave mësimore, librave të leximit, revistave gjeografike etj.

Format e punës në mësimin e gjeografisë

Në procesin mësimor përdoren disa forma të punës, të cilat kanë për qëllim t'i aktivizojnë subjektet e procesit mësimor dhe t'a bëjnë mësimin sa më të efektshëm, e këto janë:

- forma frontale e punës;
- forma e punës në grupe;
- forma e punës në çifte;
- forma individuale e punës;
- format e veçanta si mësimi i programuar, mësimi i shtuar apo suplementar, mësimi plotësues, mësimi vazhdues, aktivitetet e lira, mësimi ekipor etj;
- ekskursionet mësimore gjeografike.

Metodat dhe teknikat e punës në mësimin e gjeografisë

Metodat dhe teknikat e punës mësimore janë mënyra dhe qasja me ndihmën e të cilave realizohen disa detyra në procesin mësimor, ndërsa cilësia e mësimit varet nga ato dhe nga zgjedhja e drejtë e tyre me rastin e organizimit të procesit mësimor.

Varësisht nga përmbajtjet programore, metodat mësimore ndahen:

- **metodat verbale** (metoda parafolse, bashkëbiseduese, dialogu dhe diskutimi);
- **metoda tekstuale,**
- **metoda demonstrative ilustrative** (demonstrimi i ilustrimeve, modeleve, lëndëve, objekteve);
 1. demonstrimi në mjedisin jetësor;
 2. demonstrimi në klasë apo në kabinetin gjeografik;
 3. vëzhgimi i drejtpërdrejtë gjeografik;
 4. vëzhgimi fiziko-gjeografik;
 5. vëzhgimi socio-gjeografik

- **metoda laboratorike-eksperimentale** (eksperimentet gjeografike, demonstrimi i eksperimenteve, eksperimentet e nxënësve, koleksionet e lëndëve natyrore).

Përveç metodave mësimore të lartpërmendura, gjatë procesit mësimor mund të përdoren edhe **teknika të ndryshme të mësimdhënies**, si:

- brainstormingu (stuhi mendimesh);
- diskutimi që zgjidh problemin;
- mësimi zbulues;
- teknika e hartimit dhe drejtimit të pyetjeve;
- pema e mendjës (harta e mendimit, teknika klaster);
- gjuha grafike e komunikimit;
- inserti;
- tabela (harta) e koncepteve;
- grupet e ekspertëve (xhikso me ndërthurje);
- rrjeti i diskutimit;
- di-dua të dijë – mësojë;
- ditari dy pjesësh;
- termat paraprake;
- eseu (studimi i vogël);
- diagrami i Venit;
- programi televiziv

VLERËSIMI

Me verifikim nënkuptojmë grumbullimin e informatave të rezultateve të punës edukative-arsimore në dritën e kërkesave të veçanta të mësimin të gjeografisë. **Verifikimi, vlerësimi dhe notimi** janë ndër detyrat më të vështira të punës sonë pedagogjike. Çdo efekt dhe rezultat i nxënësve duhet vlerësuar, por jo edhe notuar. Përkitazi me verifikimin e diturive të nxënësve duhet trajtuar këto çështje:

- funksionin,
- kohën,
- format e verifikimit,
- mënyrën e notimit.

Funksioni i vlerësimit të diturive gjeografike

Një ndër çështjet më të rëndësishme didaktike është: **çka duhet vlerësuar?**

Pa mëdyshje **sasia dhe cilësia e diturive** janë kriteri më i pranueshëm. **Nxënësi duhet të disponojë me një sasi të caktuar të diturisë gjeografike.** Nga nxënësit mund të kërkojmë të njohin:

- **faktet gjeografike;**
- **objektet gjeografike;**
- **dukuritë dhe proceset gjeografike** si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore;
- **lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike** që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive;
- **të përcaktojnë aftësitë, shkathhtësitë e shprehitë,** të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik.

Funksionet e vlerësimit janë:

Verifikimi (konfirmimi), zbulimi i zbrazëtirave në dijën e nxënësve dhe informata kthyesë për arsimtarin. Dituritë e nxënësve **duhet verifikuar për çdo orë.** Në fazën e verifikimit **kontrollimi** mund të bëhet frontalisht duke i nxitur nxënësit më pyetje të shkurta, të shpejta, që kërkojnë dije faktike, gjeturi topografike, njohje të disa shënimeve.

Format e vlerësimit

Gjatë vitit shkollor duhet zbatuar disa forma të kontrollit:

- **vlerësimi me gojë** mund të jetë individual dhe grupor në çdo orë mësimore;
- **vlerësimi me shkrim,** po ashtu mund të jetë frontal dhe individual. Kjo formë e verifikimit disa nxënësve iu përgjigjet më shumë. Detyrën, problemin e dhënë nxënësit duhet t'a zgjedhin brenda kohës së caktuar;
- **vlerësimi përmes detyrave tekstuale-grafike.** Në praktikën mësimore detyrat e këtilla paraqiten në listat kontrolluese dhe në testet e diturive;

- **vlerësimi përmes zgjedhjes së punëve praktike** arrihet përmes verifikimit të diturive, fakteve, mënyrën e të menduarit gjeografik, shkallën e përvetësimit të shkathësive e shprehive;
- **vlerësimi i detyrave shtëpiake.** Për notim veçanërisht janë të përshtatshme punimet e pavarura, referatet, zgjidhja e ndonjë problemi praktik në mënyrë të pavarur.

Vlerësimi dhe notimi

Vlerësimi i rregullt dhe notimi i drejtë është një ndër mjetet më të rëndësishme në duart e arsimtarit për kualifikimin dhe orientimin e punës së nxënësve, prandaj çdo shprehje e nxënësit me gojë, me shkrim apo praktik, e që ka të bëjë me mësimin e gjeografisë do të duhej vlerësuar. Vlerësimi përfshin notimin për punën dhe dijën e shfaqur. Pas vlerësimit pason notimi.

Kushtet për notim të mirë janë: besimi reciprok, koka e qetë, drejtësia, objektiviteti dhe konsekuenca e arsimtarit, qëndrimi vetëkritik i nxënësve. Notimi duhet të jetë **publik dhe me nota të plota**. Puna mësimore duhet të vlerësohet në mënyrë sistematike. Thelbi i vlerësimit është zbatimimi efikas i evidencës, i verifikimit dhe notimit. Në mësimin bashkëkohor sistemi i vlerësimit ka pasur ndryshime të rëndësishme, ku krahas metodave subjektive zbatohen edhe ato objektive.

Tipet e vlerësimit

- **Vlerësimi formues** ka për qëllim të udhëzojë mësuesin në planifikim dhe të nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotsojë nevojat e tyre për nxënie të suksesshme.
- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim që të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mesimdhënies p.sh.pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti ...etj.
- **vlerësimi në bazë të kriterëve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara psh.krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimdhënësit të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë përmirësimin e tyre.

- **Vlerësimi diagnostifikues** përcakton te nxënësitë dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.
- **Vlerësimi formues dhe diagnostikues** nuk vlerëson me nota, por në bazë të tyre mësimdhënësi planifikon punën e tij.
- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor, veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.
- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë).
- **Vlerësimi i përditshëm** bazohet në bazë të kontrollit të punës të nxënësve në klasë.
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.
- **Vlerësimi si proces** bazohet në vlerësimin e mbikçyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune apo detyre në zhvillim.

Veprimtaritë kryesore të vlerëimit në klasë

- *Kontrulli i zakonshëm i veprimtarive në klasë*
- *Detyrat e shtëpisë*
- *Testet*

Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përpëparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.

Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurojnë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë, në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherit mund të jetë edhe e padobishme në rast se në vend që të hulumtojë për zgjedhjen e detyrës nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

Format e testeve janë:

- **Me gojë**
- **Me shkrim**
- **Përmes paraqitjes grafike etj.**

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anë negative për arsye se të nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj.

- Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdoren edhe mënyra tjera, p.sh.
 - **Vlerësimi i eseve**
 - **Vlerësimi me dosje**
 - **Vetvlerësimi... etj.**

Në fund të klasës së VI-të nxënësit duhet

- të kuptojnë dhe dallojnë gjeografinë si lëndë mesimore;
- të kuptojnë Tokën si planet, si pjesë e Sistemit Diellor dhe të Gjithësisë;
- të kuptojnë rolin e formës, madhësisë së Tokës, levizjet e saj rreth boshtit dhe Diellit, rrjedhojat e tyre për jetën e njerëzve dhe botën e gjallë;
- të dinë për sferat e Tokës, përbërësit themelor, relacionet në mes sferave dhe dukuritë që rrjedhin nga ato;
- të dinë për numrin e popullsisë, shpërndarjen, dendësinë, shtimin natyror e mekanik, për dallimet etnike, racore, fetare, kulturore, ekonomike në mes të njerëzve në botë;
- të dinë për karakteristikat e natyrës, popullsisë, vendbanimeve, ekonomisë dhe tërësive gjeografike të Kosovës;
- të aftësohen t'a përdorin busullën, hartat, atlaset, librat, fotografitë, CD-të dhe mjetet tjera mësimore.

TEKSTET DHE MJETET MËSIMORE

1. **Riza Çavolli:** *Gjeografia e Kosovës 8*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003
2. **Ruzhdi Pllana:** *Gjeografia 5*, Libri Shkollor, Prishtinë,
3. **Ruzhdi Pllana:** *Gjeografia fizike*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
4. **Asllan Pushka:** *Gjeografia shoqërore*, Libri Shkollor, 2002
5. **Murat Meha:** *Atlasi gjeografik shkollor*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2000
6. **Asllan Pushka:** *Gjeografia për klasën VI*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
7. **Esat Haskuka:** *Gjeografia fizike e pergjithshme I, II*, Prishtinë 2000, 2001
8. **Bardhyl Musai:** *Metodologjia e mësimdhënies*, Tiranë, 2003

HYRJE

Lënda Edukatë qytetare mundëson nxënësve që të njihen me disa koncepte e përmbajtje themelore dhe shumë të rëndësishme nga fusha e qytetarisë. Përpilimi i planit dhe programit mësimor të kësaj lënde është bërë duke pasur parasysh edhe të arriturat nga mësimi i kësaj lënde në klasat e mëparshme, por edhe faktin se te fëmijët e kësaj moshe fillon një cikël i ri jetësor - puberteti, i cili përveç ndryshimeve fizike e psikike te fëmijët, përcillet edhe me ndryshimin e sjelljeve të tyre në familje e shoqëri. Materia e kësaj lënde vë në pah lidhjet shumë të rëndësishme ndërmjet moshës, sjelljeve dhe përgjegjësisë në njërin anë dhe njohurive, aftësive dhe shkathtësive për jetë në anën tjetër. Zgjerimi i lidhjeve sociale të fëmijëve të kësaj moshe, krijon nevojën për njohjen dhe zbatimin e ligjeve shoqërore, të të drejtave të tyre, vlerave kulturore, ambientit jetësor e patjetër edhe të përgjegjësisë njerëzore.

QËLLIMET

- Zhvillimi i ndjenjës së vetëbesimit dhe përgjegjësisë individuale dhe sociale te fëmija;
- Zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë për t'u angazhuar për qytetari aktive dhe jetë demokratike;
- Aftësimi i fëmijës që të bëjë zgjedhje të përshtatshme dhe të marrë vendime të dobishme në lidhje me dimensionin personal, shëndetësor dhe social të jetës tash dhe në të ardhmen;
- Njohja e ligjeve shoqërore, e të drejtave njerëzore dhe e të drejtave të fëmijëve si dhe krijimi i shprehive për të kundërshtuar dhe mospranuar kurrfarë forme të diskriminimit njerëzor;
- Të aftësohet fëmija që të njohë dhe të respektojë diversitetin njerëzor dhe kulturor dhe të çmojë e kuptojë ndërvarshmërinë e jetës dhe botës

- Njohja e ndryshimeve mjedisore dhe krijimi i shprehive për ruajtjen e mjedisit jetësor

STRUKTURA PROGRAMORE E PËRMBAJTJEVE

Edukata qytetare realizohet përmes 37 orëve mësimore.

Zhvillimi individual dhe identiteti	(9 orë)
Qeverisja dhe qytetaria	(8 orë)
Të drejtat dhe përgjegjësitë	(10 orë)
Kultura	(10 orë)

ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI

Objektivat e përgjithshme

Nxënësi duhet:

- t'i kuptojë ndryshimet fiziologjike dhe psikike të moshës së pubertetit dhe të harmonizojë sjelljet e tij në përputhje me rregullat dhe normat e mjedisit, ku jeton,
- të krijojë dhe të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme me shokët e tij dhe me mjedisin ku jeton,
- të dijë të ruajë shëndetin e vet dhe me sjelljet e veta të mos e dëmtojë edhe shëndetin e të tjerëve

Objektivat e veçanta

Nxënësi duhet:

- të bëhet i vetëdijshëm për domosdoshmërinë e lidhjeve me të therët dhe për nevojën e shoqërimit me shokë
- të bëhet i vetëdijshëm për dallimet dhe specifikat e shoqërimit me persona të grupmoshave, gjinive ose përkatësive të ndryshme shoqërore e kulturore
- të praktikojë kujdesin dhe mirësjelljen në lidhjet dhe shoqërimin me të tjerët
- të ruhet nga përdorimi i materieve të ndryshme që shkaktojnë varësi dhe e rrezikojnë shëndetin si: duhani, alkooli, droga etj.

Përmbajtjet mësimore

Përmbajtjet mësimore të kësaj kategorie do të shtjellohen nëpër këto njësi:

- Identiteti personal
- Identiteti grupor
- Ndryshimet fizike dhe emocionale
- Ndryshimet sociale
- Shëndeti fizik dhe mendor
- Sjelljet njerëzore dhe shëndeti

Rezultatet e pritura

Nxënësi:

- **Shpjegon** dhe **analizon** ndryshimet e rëndësishme fiziologjike, emocionale dhe sociale të moshës së pubertetit dhe **zbaton** rregullat dhe normat e sjelljes në familje, në shkollë, në komunitet dhe në shoqëri
- **Shpjegon** se si identiteti personal është i lidhur ngusht me zhvillimin individual si dhe me jetën dhe ndërveprimet në familje e në shoqëri dhe **përdor** talentin dhe aftësitë që e bëjnë të veçohet prej tjerëve.
- **Shpjegon dhe analizon** format dhe funksionet e lidhjeve shoqërore si dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e identitetit personal dhe grupor
- **Dallon** përgjegjësitë personale (individuale) prej atyre grupore ose kolektive.
- **Krijon shprehitë** e ruajtjes së shëndetit personal si një kusht për jetë të shëndoshë.
- **Identifikon** sjelljet deviante në shoqërinë bashkëkohore dhe **analizon** shkaqet dhe pasojat e këtyre sjelljeve në shoqëri.

QEVERISJA DHE QYTETARIA

Objektivat e përgjithshme

Nxënësi duhet:

- të njohë format e ndryshme të qeverisjes dhe rëndësinë e qeverisjes demokratike,
- t'i njohë konceptet si: ligj, kushtetutë e sistem ligjor;

- të jetë i vetëdijshëm për pabarazitë e ndryshme shoqërore në komunitetin vendas dhe të jetë në gjendje të diskutojë për çështjet si: varfëria, nevojat materiale, paragjykimet dhe format e ndryshme të diskriminimit;
- të jetë i vetëdijshëm për domosdoshmërinë e barazisë ligjore të të gjithë qytetarëve të një vendi

Objektivat e veçanta

Nxënësi:

- Të kuptojë rolin e rregullave, normave dhe ligjeve për rregullimin e marrëdhënieve në grup e në komunitet dhe të jetë në gjendje të kontribuojë në marrjen e vendimeve demokratike
- Të marrë vendime, të zgjidhë probleme dhe të ndërmarrë veprime të përshtatshme në kontekste të ndryshme shoqërore
- T'i respektojë ligjet dhe normat e sjelljes në komunitet

Përmbajtja mësimore

Përmbajtjet mësimore të kësaj kategorie do të shtjellohen nëpër këto njësi:

- Ç'është ligji?
- Llojet dhe funksioni i ligjeve
- Kushtetuta
- Përgatitja dhe nxjerrja e ligjeve
- Organet e drejtësisë
- Sistemet ligjore dhe llojet
- Ligji në shtetet totalitare dhe demokratike

Rezultatet e pritura

Nxënësi

- **Shpjegon** format dhe nivelet e ndryshme të qeverisjes si dhe përgjegjësinë qytetare për të ndihmuar për një qeverisje funksionale demokratike në të gjitha nivelet e shoqërisë.
- **Shpjegon** se ç'janë ligjet, rregullat, adetet, zakonet. Pastaj, cilat janë llojet e ligjeve, ç'është kushtetuta.
- **Përshkruan** procedurat e nxjerrjes së ligjeve dhe instancat ligjvënëse si dhe
- **analizon** pasojat e shkeljes së ligjit dhe **identifikon** organet përgjegjëse për sanksionimin e shkeljes së ligjit.

- **Përshkruan dhe analizon** sistemet e ndryshme ligjore dhe **krahason** karakteristikat e ligjeve në shoqëritë totalitare dhe atyre demokratike.
- **Bën dhe praktikon** ankesën para personave dhe organeve kompetente në rast të shkeljes së të drejtës së tij ligjore ose të diskriminimit të çfarëdo lloji.

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

Objektivat e përgjithshme

Nxënësi duhet:

- të kuptojë se ç'është e drejta dhe ç'është përgjegjësia;
- të bëhet i vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e veta;
- të jetë në gjendje që në mënyrë ligjore t'i mbrojë të drejtat e veta, por edhe t'i respektojë të drejtat e tjetrit;
- të demonstrojë në vete ndjenjën e përgjegjësisë;
- të identifikojë çështjet si: të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve, zyrtarëve, konsumatorve etj.

Objektivat e veçanta

Nxënësi duhet:

- t'i njohë dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut
- t'i njohë dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve
- të dijë se cilat janë organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe cilat prej tyre veprojnë në Kosovë
- të jetë në gjendje të identifikojë ose të përmendë raste eventuale të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në familje, bashkësi ose shoqëri
- të dijë t'i shpjegojë se cilat janë përgjegjësitë e qytetarit në shoqërinë demokratike
- të dijë të shpjegojë lidhjen ndërmjet lirisë dhe përgjegjësisë

Përmbajtjet mësimore

Përmbajtjet mësimore të kësaj kategorie do të shtjellohen nëpër këto njësi:

- Ç'janë të drejtat e njeriut?
- Dokumentat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut
- Ç'janë të drejtat e fëmijëve?
- Dokumentat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve

- Diskriminimet dhe paragjykimet
- Detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarit
- Ndjenja e përgjegjesisë
- Liria dhe përgjegjësia

Rezultatet e pritura

Nxënësi:

- **Shpjegon** të drejtat elementare të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve
- **Identifikon** rastet e shkeljes së të drejtave njerëzore në bashkësi dhe shoqëri
- **Identifikon** rastet eventuale të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe shoqëri
- **Flet** për shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve në Kosovë dhe për rezultatet e punës së tyre.
- **Kundërshton** shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve si dhe çdo lloj diskriminimi njerëzor që bëhet mbi baza gjinore, gjenerative, sociale, etnike, fetare e racore.
- **Bën dhe praktikon** ankesën për shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre ose për çfarëdo lloj diskriminimi që mund t'u bëhet nga të rriturit ose shokët e tyre.

KULTURA

Objektivat e përgjithshme

Nxënësi duhet:

- t'i njohë elementet bazë që përbëjnë kulturën njerëzore;
- të vlerësojë dhe të respektojë diversitetin njerëzor e kulturor dhe ndërvarshmërinë ndërmjet njerëzve, grupeve shoqërore, ambientit jetësor dhe botës në tërësi;
- të kuptojë rëndësinë e mbrojtjes ligjore të ambientit dhe diversiteteve ekologjike në natyrë.

Objektivat e veçanta

Nxënësi duhet:

- t'i identifikojë faktorët mbi të cilët ngriten diversitetet kulturore (gjinia, gjenerata, religjioni, etnia e regjioni);
- të kuptojë rëndësinë e llojllojshmërisë dhe nevojën për bashkëpunim e komunikim ndërkulturor;

- të respektojë vlerat dhe besimet e komunitetit ku jeton, por edhe të komuniteteve tjera;
- të kuptojë lidhjet dhe ndërvarshmërinë e njerëzve me mjedisin, ku jetojnë dhe natyrën nëpër tërësi;
- të demonstrojë vetëdije dhe sjellje ekologjike.

Përmbajtjet mësimore

Përmbajtjet mësimore të kësaj kategorie do të shtjellohen nëpër këto njësi:

- Vlerat kulturore dhe llojet e tyre
- Besimet dhe llojet
- Ç'është diversiteti kulturor?
- Ç'është diversiteti ekologjik?
- Mbrojtja ligjore e ambientit

Rezultatet e pritura

Nxënësi

- **Identifikon** se cilat janë elementet kryesore që bëjnë një kulturë të dallohet prej tjetrës (si gjuha, besimi, folklori, arti, stili i jetës, zakonet, traditat etj.)
- **Krahason** modelet kulturore të së kaluarës me ato aktuale dhe **identifikon** ndryshimet e reja kulturore që po ndodhin në komunitet e shoqëri
- **Zbaton** rregullat dhe normat e sjelljes kulturore në familje, në rrugë, në shkollë dhe komunitet
- **Përshkruan dhe analizon** llojllojshmërinë (diversitetin) kulturor dhe **shpjegon** se cila është rëndësia e respektimit të diversiteteve kulturore.
- **Përshkruan dhe analizon** llojllojshmërinë (diversitetin) ekologjik dhe **shpjegon** se cila është rëndësia e ruajtjes së diversiteteve ekologjike.
- **Zbaton** normat ligjore për mbrojtjen e ambientit

QASJA LËNDORE DHE NDËRLËNDORE

Programi i Edukatës qytetare në klasën e gjashtë ndërlidhet me lëndët: Gjuhë amëtare, Gjuhë e huaj, Histori, Gjeografi, Edukatë fizike, Art figurativ dhe Muzikë.

Zhvillimi individual dhe identiteti

Në trajtimin e kësaj kategorie nevojitet një qasje ndërlëndore. Edukata fizike në kuptimin e zhvillimit të aftësive dhe shkathtësive fizike e psiko-motorike mund ta vë në pah jashtëzakonisht shumë çështjen e zhvillimit individual dhe identitetit personal. Poashtu edhe muzika, arti figurativ, gjuha amtare janë lëndë të cilat ndërlidhen me përmbajtjen e kësaj kategorie. Zhvillimi i talentit për muzikë, vizatim, poezi etj. janë aspekte shumë të rëndësishme të identitetit personal.

Qeverisja dhe qytetaria

Kjo kategori ndërlidhet edhe me lëndët Histori dhe Gjeografi. Disa aspekte të zhvillimit historik të formave të qeverisjes dhe sistemeve ligjore do të ishin shumë të rëndësishme për njohjen më të plotë të kësaj kategorie. Po ashtu, në lidhje me këtë kategori, kur është fjala për çështjet e organizimit territorial të administratës qeveritare edhe gjeografia do të ndërlidhej shumë me edukatën qytetare.

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Për t'u kuptuar më mirë kjo kategori do të duhej të paraqitej edhe aspekti historik i të drejtave dhe përgjegjësive, pastaj proceset dhe rrethanat historike që kanë ndikuar në nxjerrjen e dokumenteve të njohura ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe atyre të fëmijëve, gjë e cila e bën edukatën qytetare të ndërlidhet me historinë.

Kultura

Shtjellimi i kësaj kategorie e vë në ndërlidhje të ngushtë Edukatën qytetare me lëndët si Gjuha amtare, Gjuha e huaj, Historia, Gjeografia, Arti figurativ, Muzika, Edukata fizike etj. Njohuritë e fituara nga gjuha amtare, pastaj nga letërsia, komunikimi në gjuhë të huaj dhe njohuritë e fituara për popujt dhe kulturat e besimet e tyre, në të kaluarën dhe tash i ndihmojnë shumë edukatës qytetare në shtjellimin e kësaj kategorie. Poashtu talenti dhe shkathtësitë në artin muzikor dhe atë figurativ, recitim, aktrim etj. i ndihmojnë shumë nxënësit, në njohjen e kulturës dhe të gjitha elementeve artistike si pjesë përbërse të saj.

METODOLOGJIA

Metodologjia e mësimdhënies dhe e mësimnxënies është jashtëzakonisht e rëndësishme për punën në Edukatën qytetare. Për të zhvilluar një përparim të fuqishëm të nxënësve do të duhej që arsimtarët të përdorin një sërë metodash, varësisht nga përmbajtjet, por edhe nga detyrat që duhet t'i realizojnë nxënësit në kuadër të kësaj lënde. Shpjegimi i arsimtarit, leximi i literaturës, diskutimet në klasë, puna në grupe, puna individuale, aktivitetet praktike, shfrytëzimi i internetit, aktiviteteve skenike, shfrytëzimi i multimedive, vëzhgimet në komunitet, mbledhja, përpunimi dhe paraqitja e të dhënave përbënë shportën e metodave që do të përdoren në mësimdhënien dhe mësimnxënien e Edukatës qytetare

Zhvillimi individual dhe identiteti

Për shtjellimin e temave të kësaj kategorie arsimtari mund të shërbehet me literaturë që ka të bëjë me fiziologjinë e njeriut e sidomos me psikologjinë e fëmijëve dhe të rriturve. Pastaj, në bashkëkuvendim me nxënësit do të identifikohen karakteristikat personale fizike, mendore dhe emocionale mbi të cilat mbështetet identiteti personal. Po ashtu në bashkëbisedim me nxënësit do të identifikohen sjelljet, aktivitetet, prirjet, preferencat, qëndrimet etj, të cilat po ashtu krijojnë identitetin personal të nxënësit. Duhet të zhvillohen diskutime në klasë edhe për gjërat, të cilat janë të rëndësishme për identitetin grupor ose kolektiv, si: jeta e përbashkët, qëndrimet e përbashkëta, aktivitetet, simbolet, amblemat, logot etj.

Nëpërmjet diskutimeve, vrojtimit dhe vetëvrojtimit do të kuptohen ndryshimet fizike, emocionale dhe sociale që janë si rezultat i procesit të rritjes dhe zhvillimit individual të njeriut. Po ashtu, me shembuj konkret do të demonstrohen dhe përshkruhen pasojat për shëndet nga veprimet e caktuara si pirja e duhanit, konsumimi i alkoolit, drogës etj.

Qeverisja dhe qytetaria

Arsimtari për t'u ndihmuar nxënësve, që ta kuptojnë ligjin dhe rëndësinë e ligjit për shoqëri duhet t'i udhëzojë ata që të gjejnë publikime të ligjeve dhe të diskutojnë pjesë të ndryshme të ligjeve si, dokumente të ndryshme, fletushka ose broshura që përmbajnë ligje të ndryshme, p.sh. Ligjin për arsim, Ligjin për mbrojtje të ambientit etj. Pastaj duhet të

zhvillohen diskutime, bashkëbisedime, punë në grupe etj. lidhur me funksionin e ligjeve, nxjerrjen e ligjeve, shkeljen e ligjeve, ndryshimin e ligjeve etj.

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Për t'i pasur të qarta nxënësit, konceptet elementare mbi të drejtat, liritë dhe përgjegjësitë e njeriut duhet të demonstrohen dhe mundësisht t'u shpërndahen nxënësve broshura ose materiale që përmbajnë dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe fëmijve. Të lexohen pjesë nga këto dokumente dhe të diskutohet në klasë lidhur me respektimin ose shkeljen e këtyre të drejtave në familje, në shkollë, në komunitet dhe shoqëri. Në realizimin e temave të kësaj kategorie nxënësit duhet të punojnë në projekte individuale dhe grupore. Nisur nga përvoja e vet secili nxënës do të demonstrojë raste të diskriminimit ose paragjyqimeve të ndryshme. Në projektet grupore nxënësit do të mbledhin të dhëna mbi diskriminimin e fëmijëve ose të grave ose forma tjera të diskriminimit në komunitetin, ku jetojnë. Me ndihmën e arsimtarit duhet të përpunohen dhe analizohen këto të dhëna dhe pastaj të prezentohen në klasë.

Kultura

Fillimisht nxënësit duhet të njihen me konceptin e kulturës si dhe elementet bazë të çdo kulture, pastaj të diskutohet për karakteristikat dhe dallimet ndërmjet kulturave të veçanta, për shkaqet e ndryshimeve kulturore dhe për trendet aktuale të ndryshimeve. Nxënësit duhet të zhvillojnë aktivitete në terren me qëllim të vrojtimit dhe mbledhjes së të dhënave mbi elementet arkaike të kulturës si veglat e punës, veshmbathjet, bestytinitë, këngët etj. por edhe lidhur me elementet më të reja që kanë ardhë si pasojë e lidhjeve globale, ndryshimeve sociale, shkencore e teknologjike. Të dhënat e mbledhura duhet të sistematizohen me ndihmën e arsimtarit dhe pastaj të prezentohen në klasë dhe në shkollë. Nxënësit duhet të njohin rëndësinë e ruajtjes, dhe respektimit të diversiteteve kulturore dhe ekologjike e pastaj të diskutojnë, identifikojnë dhe analizojnë faktorët që përbëjnë, mundësojnë dhe zhvillojnë këto diversitetete.

VLERËSIMI

Vlerësimi është moment shumë i rëndësishëm për punën në shkollë. Ai është moment i rëndësishëm edhe për nxënësit, edhe për arsimtarët e edhe për prindërit e komunitetin. Mënyra e vlerësimit duhet të jetë e shumanshme dhe e vazhdueshme. Përparimi i nxënësve në Edukatën qytetare nuk mund të matet vetëm me momentin e pyetjes, por në gjithë procesin e angazhimit dhe pjesëmarrjes aktive në klasë, në shkollë, në komunitet. Me rastin e vlerësimit të nxënësve në Edukatën qytetare nuk duhet mbështetur vetëm në informatat njohëse, por edhe në shkathtësitë e treguara në aktivitetet e ndryshme praktike si, vrojtimet në bashkësi (komunitet), mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të rëndësishme për shpjegimin e temave të parapara me plan-program të kësaj lënde

Vlerësimi i arsimtarit për nxënësit duhet të bazohet në:

Vrojtimin e arsimtarit

Detyrat dhe testet

Projektet

Vrojtimi i arsimtarit, do të duhej të fokusohet në shkathtësitë e nxënësit për të punuar në grupe dhe për të punuar në mënyrë të pavarur, në raportet joformale të fëmijve ndërmjet veti, por edhe të fëmijëve me të rriturit, në cilësinë e paraqitjes së punës, në shprehjen e interesimeve për aktivitete të veçanta, në pjekurinë fizike, emocionale dhe mendore të nxënësit.

Detyrat, do të ishin krijimi i situatave, kur nxënësit do të duhej të merrnin ndonjë vendim të caktuar, ose do të duhej të mbronin dhe argumentonin mendimet ose qëndrimet e caktuara etj.

Testet, janë instrumente me të cilat në intervale të caktuara matet dija përkatësisht përparimi në njohuritë e nxënësve të fituara gjatë mësimin në klasë dhe jashtë klase.

Projektet, janë punë grupe, por edhe individuale e nxënësve që kanë të bëjnë me mbledhjen e të dhënave të caktuara, përpunimin ose publikimin e tyre.

Vlerësimi nuk duhet të jetë vetëm proces i njëanshëm (arsimtar – nxënës), por ai duhet të jetë proces i shumanshëm. Te nxënësit duhet të kultivohen shprehitë e vlerësimit kritik për përmbajtjet dhe për metodologjinë e mësimdhënies e të vlerësimit. Për të mirën e shkollës, komunitetit e sidomos të vet nxënësve, do të duhej që shkolla të krijojë kushte që nxënësit jo vetëm të vlerësohen, por edhe vetë të vlerësojnë.

TEKSTET DHE MJETET MËSIMORE

1. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 5**, Prishtinë, 1999
2. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 6**, Prishtinë, 1999
3. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 7**, Prishtinë, 1999
4. Dr. Fatmira Myteberi & Astrit Dautaj & Majlinda Keta, **Qytetaria 1**, Tiranë, 2000
5. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Standardet për nxënësit dhe mësuesit në lëndën e Edukimit Qytetar**, (DRAFT), Tiranë 1997
6. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Kurrikula dhe shkolla** (Lëndët shoqërore 2), Tiranë, 2002
7. Grup autorësh, **Të gjitha qeniet njerëzore ...**, doracak për mësimin e të drejtave të njeriut, UNESCO, Belgjikë, 1998
8. David Keri, Fondacioni kombëtar për Kërkime Arsimore NEER, **Edukimi i të Drejtës për QYTETARI në Kurrikul**, Vështrim Ndërkombëtar, Londër 1999
9. Prof. François Andiger, **Edukimi për të Drejtën Demokratike të Qytetarisë**, Strasburg, 2000,
10. Graham Haydon, Instituti i Arsimit, **Agjenda e Edukimit Moral**, Londër 2001
11. Korniza Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohshme në Kosovë
12. Erleta Mato & Robert Gjedia & Marjana Sinani & Astrit Dautaj, **Standardet e arritjes së lëndës së edukimit qytetar**, Tiranë prill 2003
13. Xhemajli Beluli, **Kultura qytetare**, Shkup 2002
14. www.dadalos.org

HYRJJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut. Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e tij duke ia formuar ambientin tingëllor. Nisur nga roli i muzikës në jetën e njeriut dhe ndikimit që ka në të, del edhe rëndësia e formimit edukativ-muzikor. Edukata muzikore në shkollën fillore dhe të mesme të ulët ka për detyrë t'u japë mundësi nxënësve të aftësohen para së gjithash për:

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikes në programet e mjeteve të informimit dhe shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale dhe veprimtari tjera muzikore;
- arsimim të mëtejshëm që nënkupton interesim më të gjerë me përgatitje për ndonjë profesion ku muzika është pjesë përbërëse.

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Të sjellë gëzim, emocione pozitive dhe të zgjojë interes për veprimtari të ndryshme muzikore;
- të formojë qëndrim pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;
- të zhvillojë përgjegjësinë dhe kuptimin për pjesëmarrje në muzikimin e përbashkët;
- të këndohen dhe të luhen përmbajtje muzikore;
- të bëhet dëgjimi aktiv i muzikës duke i përjetuar dhe njohur cilësitë e saj;
- të aftësojë për zgjedhjen e programeve muzikore dhe të edukojë për ambient të shëndoshë tingullor ;
- të zhvillojë kritere për vlerësim dhe mendim kritik;

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË LËNDËS

- të zhvillojë aftësitë muzikore (ndjenja ritmike, melodike e harmonike, formimi estetik dhe muzikalitetit) si dhe shkathtësitë interpretuese (teknikat e këndimit dhe luajtjes në veglat muzikore)
- të njohin vepra muzikore, krijues dhe interpretues;
- të kuptohen konceptet themelore, ligjshmëritë dhe informacionet mbi mjetet, shprehjet elementare muzikore, format dhe llojet, të cilat mundësojnë të kuptuarit e muzikës;
- të krijojë muzikë dhe të shpreh imagjinimet tingullore personale (individuale);
- të shprehë përjetime dhe përfytyrime muzikore përmes lëvizjes, vallëzimit, shprehjes figurative dhe gjuhësore;
- të mundësojë njohjen e ndërlidhjes së muzikes me gjuhën amtare, të huaj dhe me artet tjera;
- të njihen shenjat themelore të shkrimit muzikor si dhe orientimi elementar në te;
- të ushtrohet zbatimi i teknologjisë bashkëkohore muzikore;
- të jepen informacione aktuale mbi shkollimin muzikor dhe profesionet muzikore.

	VEPRIMTARITË MUZIKORE	PËRMBAJTJE TË PROPOZUARA TEMATIKE-INFORMATIVE	MUZIKORE-ARTISTIKE
I N T E R P R E T I M	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit këndojnë këngë të zgjedhura popullore dhe artistike shqipe si dhe këngë të popujve tjerë; • nxënësit i bëjnë shoqërime instrumentale këngëve si dhe interpretojnë tërësi të veçanta instrumentale; • nxënësit vallëzojnë me muzikë përkatëse; • Shoqërimi i këndimit dhe ligjërimeve ritmike me lëvizje. 	Muzika vokale <ul style="list-style-type: none"> • Këngë dhe melodi në dur dhe mol; • Domethënia e tekstit notal; • zërat dhe formacionet: solistët, ansamblet vokale, koret; • Kënga dhe melodia; • Kënga ka përmbajtje • dhe formë; • Këngë me shoqërim instrumental. 	Këngë për këndim: Kënga e Flamurit, T. Daija E zuri gjumi, popullore Lumenjt e vendit tim, A. Tegnej Kori gazmor, B. Shehu Kanon Flutura G. Zajmi Asaman o moj lule, popullore Oj lum e lum o vjen Shën Gjergji Ninullë, Halin Pse jemi të ndarë, R. Dhomi Kur buzëqesh nëna (dy zërëshe) R. Rudi Shqiponja dhe balona, F. Ibrahim Happy birthday Alfabeti shqip Këngë e cicërrime, F. Seli Qëndisja e flamurit, K. Mulalli Zogitë dhe vargjet, M. Piperku Loja e shqiponjave A kan' uj' ato burime, popullore Flamuji e festës, M. Piperku Panvera, N. Arra Fluturojmë të dy tok, L. Dizdari Dhuratë për nënën, A. Kareco Sa bukur, sa ëmbël, (dy zërëshe), Moxart Përsëndetje shkollës, K. Hysniu Kanon, Mora rrugën për Janinë, popullore Këngë me shoqërim instrumental: Erdhi Viti i Ri, K. Kono Interpretime instrumentale: Pjesë për dy blokflauta-Çajkovski; pjesë instrumentale-N. N Pjesë instrumentale-R. Rudi Bisedë instrumentale-T. Morli Interpretimi i temave të veprave për dëgjim dhe të tjera: Marshi nga Opera "Aida", Verdi Melodi, K. Laro Serenata (I), Moxart Temë nga Simfonia V, Çajkovski

<p>D Ë GJ I M</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit dëgjojnë duke përjetuar dhe analizuar krijime popullore dhe artistike; • dëgjojnë vepra me përmbajtje formë, gjini, zhanre të ndryshme të kompozitorëve botërorë dhe kombëtarë. 	<p>Muzika vokale dhe vokale-instrumentale</p> <p>Muzika instrumentale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngjyrat tingullore në veprat e krijuesve të njohur • Harkorët dhe instrumentet tjerë me tela; • Instrumentet me të fryer; • Instrumentet me tastierë; • Instrumentet me të goditur-perkusionet; • Instrumentet elektronike; • Formacione instrumentale, solistë, formacione kamertale, orkestra; • Emërtimi i veprave instrumentale; <p>Përmbajtje muzikore Muzika me program</p> <p>Muzika absolute Muzika e popullarizuar klasike lehtë, pop, rok etj</p>	<p>Vepra vokale dhe vokale-instrumentale</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trofta Shubert-këngë solo 2. I varfëri mërgimtar, Shubert- dyzërëshe 3. Puna e mbarë, L.Antoni 4. Kënga e Rexhës, L.Antoni 5. Një kokë ,një tokë, R. Rudi 6. Drandofilja e vogël, M.Kaçinari <p>Vepra instrumentale</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. B. Britën: Sheti nëpër orkestër 2. A. Vivaldi: Pranvera 3. È. A. Moxart: Muzikë e vogël nate(k. III) 4. A. Dvorzhak: Simfonia nga Bota e Re (largo) 5. Gershëin: Rapsodia në të kaltër 6. Chopin: Poloneza në A dur 7. Scarlati: Sonata në C-dur 8. J. S.Bach: Trio Sonata, Menuet (G –dur, gmol) 9. R. Schuman: Ëndërrime-piano 10. L. V. Beethoven: Sonatë për violinë dhe piano (A dur, F dur) 11. J.Hajdn: Kuarteti harkor() 12. Hajdn: Simfonia 104 13. Handel: Muzika në ujë 14. Beethoven: Simfoni(III,V, VI,) 15. Brahms: Valle Hungareze nr.6 16. Bartok: Valle Rumune 17. F. Beqiri: Marshi ala turca 18. E. Rizvanolli: Suita dasmore 19. R. Mulliqi: Muzikë nga Baleti “Nita” 20. R. Dhomi: Rondo për violonçel e piano 21. Z. Ballata: suita për flaut- solo 22. V. Gjini: Tema me variacionet për klarinetë dhe piano 23. B. Smetana: Velltava, 24. E .Grieg: Per Gynt <p>Simfoni, sonata etj</p> <ol style="list-style-type: none"> 25. J. Strauss: Në Danubin e Kaltër 26. J. Strauss: Uvertyra nga opereta :Lakuriqi i natës 27. Bernstajjn :Tregimi nga Perëndimi-mjuzikëll 28. Beatles, 29. A. Mula: Valsi i lumturisë, 30. Kapsamun: Ëndërrime, etj.
-----------------------------------	---	--	---

K R I J I M	<ul style="list-style-type: none"> • përmes këndimit dhe ligjërit ritmik shprehin imagjinimet dhe përjetimet individuale • Sajojnë shoqërime dhe tërësi të tjera muzikore 		
	Përmes komentimit shprehin në mënyrë kreative përjetimin muzikor në format shprehëse lëvizëse, figurative dhe letrare		

MËNYRAT DHE FORMAT E VLERËSIMIT

Vlerësimin e arritjeve në edukimin muzikor e bënë mësimsdhënësi në kuadër të grupit, duke e vlerësuar zhvillimin muzikor të secilit nxënës si në interpretimin vokal dhe instrumental, ashtu dhe në dëgjimin aktiv dhe në punën krijuese.

Gjatë vlerësimit vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet përjetimit të veprave muzikore, si dhe shoqërimeve të tyre. Mësimsdhënësi evidenton dhe vlerëson me kujdes aftësitë muzikore, shkathtësitë si dhe dituritë informative, ndjeshmërinë dhe intereset e nxënësit. Bazuar në synimin e lëndës, mësimsdhënësi e vlerëson zhvillimin e nxënësve në mënyrë objektive. Përveç formave klasike të vlerësimit mund të përdoret edhe testi muzikor.

UDHËZIMET DIDAKTIKO - METODIKE

Edukimi muzikor në këtë klasë përmban disa njësi të veçanta. Niveli më i lartë i kërkesave të zhvillimit muzikor të nxënësve, kërkesat e veprimtarisë muzikore dhe përmbajtjeve kërkojnë një përgatitje të menduar mirë nga ana e mësimsdhënësit për çdo njësi. Mësimsdhënësit duhet të përdorin metoda dhe forma ndërvepruese (interaktive) të të mësuarit.

Duke marrë parasysh faktin që në artin muzikor ndërlidhja e krijimit (të shprehurit krijues), interpretimit dhe dëgjimit është e domosdoshme dhe mundëson një vazhdimësi në zhvillimin muzikor të nxënësve, mësimsdhënësia muzikore në këtë cikël është e konceptuar nga një kompleks çështjesh sipas fushave të veprimtarisë muzikore.

Plani dhe programi mësimor i përpiluar me synime të qarta tregon shtrirjen dhe gjerësinë e tri përmbajtjeve themelore muzikore-didaktike.

- Literaturë muzikore për interpretim dhe dëgjim përzgjedhet nga mësimsdhënësi nga përmbledhjet ekzistuese të këngëve dhe incizimeve muzikore,
- Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore, të cilat e shpjegojnë muzikën dhe të kuptuarit e saj (shkallët, tonaliteti, ritmi, shkrim-leximi muzikor, format etj.),
- Të dhënat (informacionet e ndryshme) për kulturën muzikore, rëndësinë e saj në këtë cikël orientohen në jetën muzikore të nxënësve në ambientin e tyre të ngushtë, në jetën muzikore në kontekst më të gjerë në trevat e ndryshme deri tek krijimtaria botërore.

Këto përmbajtje didaktike janë të gërshetuara mes vete, sepse literatura muzikore u mundëson atyre fitimin e përvojës dëgjuese në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Të kuptuarit e saj (muzikës) realizohet përmes koncepteve, ligjshmërive dhe dukurive, kurse informacionet që ata i marrin zgjerojnë horizontin e tyre mbi sistemin e vlerave në ambientin kulturor.

INTERPRETIMI

Mësimdhënësi e realizon lëndën përmes interpretimit dhe ndërlidhjes edhe me përmbajtjet tjera didaktike muzikore duke kombinuar **metodën e imitimit (sipas veshit) dhe atë sipas tekstit notal**.

Duke respektuar parimin e individualizmit në mësimdhënien e muzikës dhe mundësitë interpretuese të nxënësve, i përfshin ata në këndim dhe luajtje instrumentale.

DËGJIMI

Për të realizuar përmbajtjen e dytë dhe të tretë didaktiko-muzikore të përcaktuar si më lart, mësimdhënësi zgjedh literaturën muzikore për dëgjim. Procedura metodike duhet të mundësojë largim nga stereotipi dhe t'i shmanget pasivizimit të nxënësve. Me hyrje motivuese para dëgjimit të muzikës ose me komentim të dëgjimeve, pasurohet forma e punës me veprimtari interesante për nxënësit dhe në këtë mënyrë dëgjimi i muzikës bëhet i nevojshëm për ta.

KRIJIMI

Fusha e veprimtarisë së krijimtarisë (të shprehurit krijues) përfshin tri format kryesore

- Mësimdhënësi nxit nxënësit që tërësitë (përmbajtjet) e mësuara (përvetësuara t'i interpretojnë në mënyrë përjetuese dhe estetike.
- Nxënësit me vegla të thjeshta muzikore krijojnë shoqërime të ndryshme melodike e ritmike dhe forma të ndryshme muzikore (këngë, rondo, variacione).
- Të shprehurit muzikor krijues ndërlidhet me shprehjen figurative, lëvizjen dhe vallëzimin si dhe me shprehjen letrare. Hulumtimet rezultojnë se nxënësit e kësaj moshe posaçërisht janë të prirur të shprehin përshtypjet muzikore përmes shprehjes figurative.

ARRITJET E ZHVILLIMIT MUZIKOR TË NXËNËSVE

- **Aftësitë**

Ky cikël i takon periudhës kur zhvillohet ndjenja harmonike dhe vetëdijësohen për këndimin homofonik, dy e shumëzërësh të këngëve popullore, artistike, kanoneve me shoqërime ostinato dhe të lëvizshme

Njohuritë më të rëndësishme janë ndjenja melodike dhe përvoja e tyre tingëllore e më parshme.

Në këtë moshë, edukimi muzikor i përgjithshëm zhvillohet përmes aftësimin të nxënësve që në mënyrë analitike të njohin dhe kuptojnë raportet mes tingujve përnga gjatësia dhe lartësia dhe në këtë mënyrë mundëson një zhvillim cilësor të ndjenjës ritmike, melodike dhe asaj harmonike. Komunikimi muzikor është orientimi primar dhe mbizotëron metoda e të mësuarit (interpretuarit) sipas tekstit notal. Të menduarit analitik muzikor i drejton nxënësit kah dëgjimi cilësor, vëmendja, dhe zhvillimi i kujtesës së përgjithshme dhe asaj muzikore. Gradualisht rritet aftësia e tyre për sajim estetik që arrihet me pjekurinë e përvojës së tyre dhe nxitjeve.

- **Shkathtësitë**

Shkathtësitë psiko-motorike të nevojshme për interpretimin vokal dhe instrumental si dhe për reagimet ndaj muzikës përmes lëvizjes shprehen me një dualizëm.

Me një program të zgjedhur për interpretim dhe me procedurat metodike shkathtësia e interpretimit arrin të zhvillohet në një shkallë më të lartë, por në të njëjtën kohë paraqitet edhe mutacioni si dukuri (sidomos tek djemtë) dhe kjo kërkon një trajtim të shëndoshë. Mësimdhënësi i udhëzon me kujdes dhe shpjegon arsyen, i këshillon si të këndojnë më lehtë dhe të marrin pjesë në këndim edhe kur paraqitet ky fenomen-vësh-tirësi. Në këtë rast ai mund t'i orientojë ata për luajtje instrumentale.

Mësimdhënësi shkallëzon këto shkathtësi përmes ushtrimeve për të shprehur, frymëmarrjen, formimin e tingujve, frazat muzikore, të cilat i përfundon në mënyrë logjike me njësi të veçanta. Atë që është realizuar në trevjetëshin e parë përmes interpretimit të përbashkët dhe lojërave didaktiko-muzikore, tash e ndërlihim edhe me informacione për higjienën e zërit dhe këndimit të drejtë.

- **Njohuritë informative**

Nxënësit:

- Njohin elementet shprehëse
- Njohin përgjithësisht dhe sistemojnë mjetet shprehëse (interpretuese) në veprat vokale, vokale-instrumentale dhe instrumentale
- Kuptojnë përbërjen themelore të formës muzikore
- Dallojnë përmbajtjet muzikore programore nga ato absolute
- Njohin lloje (gjini) të ndryshme muzikore

Mësimdhënësi zgjedh nga përvoja e tyre muzikore njohuritë e domosdoshme, të cilat i orienton gjatë interpretimit, dëgjimit ose të shprehurit krijues. Ata njihen edhe me disa koncepte thelbësore teorike, ligjshmëri dhe informacione mbi kulturën muzikore. Me rëndësi është që ato nxënësi nuk i përvetëson në mënyrë verbale dhe përmes teorisë, por përmes procedurave metodike të përpunuara me kujdes, nga përjetimi muzikor arrijnë deri te komunikimi i metutjeshëm, dhe i vetëdijshëm përmes muzikës.

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

- Përmbajtjet vokalo-instrumentale nga krijimtaria popullore dhe artistike i njohin me vlerat kulturore kombëtare e botërore (Gjuha amtare, Gjuha e huaj, Historia, Gjeografia)
- Përmbajtje të caktuara muzikore janë të ndërlidhura me natyrën, shoqërinë (Gjeografia, Historia);
- Aktivitetet muzikore nxisin të shprehurit kreativ përmes arteve tjera (arti figurativ, letërsia, lëvizja, vallëzimi);

REZULTATET E PRITURA

Nxënësit pas realizimit të programit duhet:

- të njohin repertoarin e veprave, të cilat janë bazë për dëgjim aktiv të programeve koncertale dhe produksionit muzikor;
- të dallojnë karakteristikat themelore të veprave sipas stileve, gjinive, zhanreve, formave dhe përmbajtjeve;
- të njohin informacionet themelore mbi krijuesit dhe interpretët si dhe shprehjet elementare muzikore;
- Varësisht nga mundësitë dhe përcaktimet e nxënësve realizojnë detyrat krijuese të propozuara.

FORMAT E VEÇANTA TË OBLIGUESHME TË MËSIMDHËNIES PËR MUZIKËN

Puna me kor dhe orkestër është formë e veçantë dhe e obligueshme e edukimit muzikor në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Në kor dhe orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe në bazë të interesit të tyre. Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë të interpretimit muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore të niveleve të ndryshme, ora në kor zgjat sa ora mësimore, 45 minuta. Kjo punë e mësimdhënies llogaritet në normën javore mësimore të tij me fond javor prej 2- 4 orë (varësisht nga niveli). Gjatë vitit shkollor kori përgatit dhe prezenton program me kritere artistike dhe pedagogjike.

HYRJJE

Arti figurative, përmban vlerën universale të njerëzimit – HUMANIZMIN – prandaj është i devotshëm dhe i pakufi. Arti është ushqim shpirtëror për zhvillimin e personalitetit që nga fëmijëria e deri në devotshmëri. Gjuha figurative është e qartë dhe e barabartë për të gjithë njerëzit pa dallim race, etnie apo gjinie. Artit figurativ i duhet kushtuar kujdes e rëndësi si integrim në kulturën e përgjithshme dhe fondin e dijes për zhvillimin dhe përparimin e mëtejshëm njerëzor e shoqëror.

QËLLIMET

- Zhvillim i gjuhës figurative përmes komunikimit vizuel për tolerancë e njohje me kulturën artistike të komuniteteve dhe vendeve të ndryshme;
- Nxitja e vazhdueshme e të menduarit estetik mbi ambientin hapësinor ku jetohet e punohet, duke u fisnikëruar me të arriturat e përgjithshme njerëzore;
- Është i domosdoshëmi kabineti i artit figurativ në çdo shkollë;
- Zhvillim i punës më intensive përmes aktiviteteve të lira me talentet e rinj figurativ si dhe nxënës që kanë aftësi të kufizuara mendore dhe fizike;
- Organizim i lirë i jetës kulturore figurative në shkollë përmes galerisë shkollore, me ekspozita individuale dhe kolektive të krijimtarisë figurative shkollore apo jashtë shkollore;
- Organizimi i ekskursionit si metodë mësimore- shkencore për njohjen e bashkëpunimin mes të arriturave dhe kulturave të vendeve e komuniteteve të ndryshme. Me këtë zhvillohet po ashtu toleranca dhe bashkëpunimi artistik mes moshatarëve dhe popujve në përgjithësi.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Zhvillim i aftësive të venerimit dhe perceptimit të formave, hapësirës dhe dukurive natyrore;
- Zhvillim i ndjeshmërisë për të krijuar përjetimin e motivin e përmbajtjeve të trajtuara në harmoni me elementet estetike të pasqyruara figurativisht në lëmenjtë e ndryshëm figurative;
- Përvetësimi dhe zhvillimi i njohurive përmes ushtrimeve me teknikat dhe materialet e llojllojshme bashkëkohore si dhe përmes mediave pamore e kriterëve estetike;
- Kultivimi i komunikimit konvencional ndërveprues përmes analizës e sintezës së vlerave të krijuara artistike për vetëdijësim, gjykim e vlerësim estetik si dhe mendim kreativ si avancim në shkathtësitë intelektuale të nxënësi.

PËRMBAJTJET PROGRAMORE

37 orë (1 orë në javë)

Lëmitë figurative	Temat	Elementet figurative	Trajtat e punës
Vizatim (4 orë)	- Luftëtari i lirisë - Biçiklisti në garë - zogu në fole - Druprerësi në pyll - Muratori në punë - Natyrë e qetë	Ndjeshmëria ndaj vijës preciziteti, proporcioni vrojtimi vizuel karakteri dhe teksti	- puna tematike - ilustrimi - sipas natyrës
Pikturë (12 orë)	- Dasma - Cirku - Maskembali - Tregu - Korrja - Shpezët shtëpiake - Natyrë e qetë - Portreti - Akuariumi me peshqit - Festa e vitit të ri - Peisazhi - Shitorja e luleve - Vrapimet në atletikë - Lojrat sportive - orkestri muzikor	komponimi intenziv, sipërfaqja valeri, ritmi, volumeni saktësia, ritmi...	- puna tematike - sipas natyrës - ilustrimi

Skulpturë (5 orë)	- Shitësi në treg (perimet) - Kukullat - Balerina - Shtazët shtëpiake - portret	vrojtimi, karakteri preciziteti dhe plasticiteti	- puna tematike
Grafikë (4 orë)	- natyrë e qetë - kopshti - Rruga ime - peshqit - shpezët shtegëtarë - Maskat	ritmi në grafikë vija, sipërfaqja kompozicioni	- puna tematike - sipas natyrës - ilustrimi
Arti aplikativ (10 orë)	- çilimi në dhomë - fustani i dasmës - shamia popullore - rrethoja e shtëpisë - dhoma ime - kopertina e librit - urimi i vitit të ri - pllakati - ilustrimi i tregimit - shenjat e trafikut - mozaik – temë e lirë - kolazh – temë e lirë	stilizimi ornamental dekorues vija në sipërfaqe kompozicioni preciziteti	- puna tematike dhe ilustrimi
Vlerësimi (2 orë)	- vlerësimi i punimeve të nxënësve - reproduktionet e punimeve të caktuara - vizitë ekspozitave – analizë e elementeve figurative - galeria – muzeu		gjykimi në të vlerësuar

REZULTATET E PRITURA

Vizatim:

- a) Vija në fushën e të pamurit hapësinor
- b) Vija në forma të sipërfaqës
- c) Vija në lëvizje e ritëm
- ç) Vija në natyrë e tekstura
- d) Vija llojet e veçoritë

Pikturë:

- a) Ngjyra si dukuri fizike e spektrit të dritës në frekuencat e rezeve elektromagnetike

- b) Ngjyra kromatike e akromatike
- c) Ngjyra valeri e kontrasti
- ç) Ngjyra themelore e komplimentare
- d) Ngjyra sipërfaqe e strukturore materialesh
- e) Ngjyra si harmoni dekorative
- f) Ngjyra si njollë e shprehjes figurative
- g) Ngjyra e ngrohtë dhe e ftohtë.

Skulpturë

- a) Forma tridimensionale
- b) Vëllimi i formave konkave e konvekse.
- c) Riljevore
- ç) Prodhim natyror
- d) Prodhim ideor

Grafikë

- a) Teknikë e reprodukimit të vizatimit
- b) Një, dy e më shumë ngjyrëshe
- c) Kompozicioni i kontrasteve
- ç) Llojet e veçoritë grafike

Arti aplikativ

- a) Pllakati – simbol figurativ
- b) Mozaiku – lidhja dekorative e figuracionit
- c) Kolazh – lidhja dekorative me figuracion
- ç) Vitrai – lidhja e dekorit me figuracion
- d) Qeramika – lidhja e skulpturës me destinim funksional e praktik
- e) Kostumografia – aplikim figurativ i materialeve të ndryshme
- f) Dizajni industrial –formësim i mjeteve të ndryshme në jetën e përditshme
- g) Shprehje dekorative simetrike

Vlerësimi estetik:

- a) kultivimi dhe vlerësimi i vlerave figurative sipas individualiteteve kreative në klasë, periudha historike të vendit dhe në botë.
- b) Të vlerësuarit transparent të suksesit të arritur të secilit nxënës

UDHËZIMET METODOLOGJIKE:

- Nga e njohura në të panjohurën;
- Kujdesi në përshtatjen metodiko-didaktike ndaj aftësive psiko-fizike;
- Të tipave figurativ;
- Nxënësi në qendër – arsimtari orienton (udhëzon);
- Zgjedhja e temave – motiveve, teknikave dhe materialeve të punës adekuate të përshtatura me të gjithë elementet tjerë si: psiko-social, etno-tradicional, festiv e kohor;
- Roli aktiv i pedagogut si mentor ndërveprues (interaktiv) dhe kognitiv;
- Motivimi i nxënësve dhe kreativiteti individual;
- Vlerësimi kolektiv i vlerave të punës praktike figurative (shpjegim dhe interpretim).

FORMAT E PUNËS:

- Puna në grupe
- Puna në çifte
- Puna individuale
- Puna frontale
- Puna mediale

MOTIVIMI:

- Rrethi jetësor – hapësinor
- Intelegjenca imagjinuese
- Mediat me informacion artistik
- Dukuritë dhe ngjarjet
- Literatura shkollore
- Galeritë – muzeumet
- Garimet përmes ekspozitave
- Ekskurzioni dhe biseda interaktive rreth kulturës së gjerë artistike

VIZIONI (QASJET):

- Kuptimi i jetës së përditshme
- Imagjinata e lojës, argëtimit dhe kreacionit
- Kureshtja për të kërkuar përgjigje

- Vetëdijësimi për përjetimet emocionale
- Besimi dhe singëriteti
- Të drejtat dhe detyrimet
- Kujdesi ndaj talentëve të rinj

REZULTATET E PRITURA

Nxënësi duhet të ketë përfituar dije nga lënda e Artit figurativ që i nevojitet për të qenë i aftë të shprehë ndjenjën artistike, të menaxhojë situata si dhe zgjidhjen e problemeve që ndeshen rregullisht në jetën e përditshme dhe që u duhen si bazë për arsimimin e mëtejshëm.

Brenda këtij plani dhe programi nxënësi duhet:

- të ketë të zhvilluar të kuptuarit mbi artin në përgjithësi, t'i njohë: vijat, ngjyrat, kombinimin e tyre, të vizatojë, të pikturojë dhe të bëjë skulptura,
- të jetë në gjendje të vlerësojë dhe të përjetojë veprat artistike,
- të përdorë mjete, të cilat nevojiten për krijimin e veprave artistike si: pikturë, grafikë, dizajn, vitraj, mozaik, skulpturë, relief, torzo,
- të riprodhojnë dhe përshkruajnë vepra artistike,
- të interpretojnë domethënien apo ndjeshmërinë, të cilën e përjetojnë në veprat artistike,
- të zhvillojnë të kuptuarit, të shprehurit dhe imagjinatën

TEKSTET DHE MJETET MËSIMORE

Xhonson,	<i>Historia e artit</i>
Harvard Arnasona,	<i>Historia e artit modern</i>
	<i>Arti bashkëkohor i Kosovës</i>
Muharremi H.	<i>Kultura figurative kl. II</i>
Goçi R.	<i>Kultura figurative kl. VII, VIII</i>
Goçi R.	<i>Edukata estetike kl. I, (për shkollat e mesme)</i>
Muriqi N.	<i>Baraspesha estetike</i>
Muriqi N.	<i>Kultura figurative kl. V – VI</i>
Nimani Sh.	<i>Shqyrtime artistike</i>
Emërllahu D.	<i>Edukata estetike</i>
Gaxholli E.	<i>Mjeshtritë e pikturës</i>

HYRJJE

Teknologjia për klasën e gjashtë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprahe. Lënda mësimore e teknologjisë, nxënësit i familjarizon me format dhe dimensionet e ndryshme të përvojave dhe veprimtarive njerëzore (materialet dhe përpunimet e tyre, shkathtësitë e të punuarit dhe të dizajnit, teknologjia e informimit dhe e komunikimit si dhe teknika bujqësore dhe e ndërtimitarisë).

QËLLIMET

- zhvillimi dhe thellimi i njohurive në lëmin e teknologjisë dhe rëndësia e saj në shërbim të njeriut;
- krijimi i shprehive dhe shkathtësive gjatë punës teorike dhe praktike, aftësive të kërkimit të informacioneve nga fusha e teknologjisë;
- njohja e raporteve në mes të teknologjisë dhe shoqërisë – në kohën e sotme, në të kaluarën dhe në të ardhmen;
- puna sipas standardeve të cilësisë dhe specifikimeve të parashtruara;
- vizatimi dhe grafikët, duke përfshirë edhe vizatimin e lirë, vizatimin teknik dhe përdorimin e programeve grafike kompjuterike, janë gjithashtu thelbësore në praktikën teknologjike për përcaktimin dhe sqarimin e ideve dhe zgjidhjeve të propozuara;
- dizajnimi si aktivitet që përfshinë procesin e specifikimit, zhvillimit dhe të testimit të prototipave;
- fuqizimi për t'i kontribuar shoqërisë teknologjike.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Nxënësi duhet:

- të njohë vetitë elementare të materialeve, të cilat përdoren në industri dhe teknologjinë e përpunimit të tyre;
- të njohë veglat e punës, motorët, sistemet për transmision, sistemet për bartjen e energjisë;
- të kuptuarit e procesit prej idesë deri në realizimin përfundimtar;
- të dijë të bëjë dokumentacion teknik dhe zbatimin e tij në realizimin e prodhimeve finale;
- të kuptojë që çmimi i prodhimit varet nga çmimi i materialit, çmimi i punës dhe shpenzimet tjera;
- të dijë mënyrat e përpunimit të drurit, plastikës, metalit, alçit (gjipsit), etj.
- të kuptojë mundësitë e rregullimit të proceseve të ndryshme me kompjuter;
- të dijë të përdorë kompjuterin për dokumentacion teknik, për matje dhe për paraqitje tjera grafike;
- të dijë të përdorë aparatet për komunikim

OBJEKTIVAT SPECIFIKE	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA	METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET DIDAKTIKE	LIDHJA NDËRLËNDORE
Materialet dhe përpunimi i tyre				
Fondi i orëve: 9 ORË				
<ul style="list-style-type: none"> • të njohë letrën dhe drurin si materiale të përditshme; • të zhvillojë aftësi për punë në grup; • të zhvillojë aftësi për organizim të punës; • të zhvillojë kreativitet, originalitet, mendim kritik dhe të zhvillojë aftësinë dhe shkathhtësinë e zgjidhjes së problemeve; 	<p>Teknologjia e përpunimit të letrës dhe ndikimi i saj në ambient</p> <p>Përpunimi i letrës me dorë</p> <p>Llojet e ndryshme të materialeve të letrës dhe vetitë e tyre</p> <p>Llojet e drurit, të cilët rriten në vendin tonë, vetitë e tyre dhe teknologjia e prodhimit</p> <p>Teknologjia e përpunimit të druri</p>	<p>të dijë teknologjinë e përpunimit të letrës dhe të drurit;</p> <p>të dijë dhe t'i përdorë veglat e punës dhe makinat elementare;</p> <p>të dijë rrugën e ecurisë prej idesë deri te prodhimi;</p> <p>të dijë se çmimi i prodhimit varet nga çmimi i materialit, çmimi i punës, etj.;</p> <p>të dijë të lexojë dokumentacionin teknik;</p> <p>të përdorë fjalor përkatës për emërtimin dhe përshkrimin e pajisjeve, materialeve</p>	<p>Të gjitha përmbajtjet realizohen në formë të një projekti të përbashkët me materialet e ndryshme, prej disenjimit deri te prodhimi final.</p> <p>Nxënësit të nxiten për të marrë ndonjë nismë ose veprim të pavarur, duke marrë parasysh rregullat themelore të sjelljes në grup.</p>	<p>Gjuha amtare</p> <p>Biologjia</p> <p>Matematika</p>

<ul style="list-style-type: none"> të zhvillojë raport pozitiv ndaj mjedisit; 	<p>Çka janë gjysmëprodhimet? Krahasimi i veçorive të drurit me veçoritë e materialeve tjera</p> <p>Rëndësia e pyjeve për mjedisin</p>	<p>dhe përpunimeve; të dijë çka është lënda e parë, gjysmë prodhimet dhe prodhimet finale;</p>		
<p>Shkathësitë e të punuarit</p>				
<p>Fondi i orëve: 9 ORË</p>				
<ul style="list-style-type: none"> t'i zhvillojë aftësitë e përpunimit me dorë dhe me makina elementare të letrës dhe të drurit. 	<p>Zgjedhja dhe përdorimi i metodave përkatëse të përpunimit dhe formimit të materialeve. Prerja, shpuara, lëmimi, ngjitja, mbrojtja e sipërfaqeve. Përdoren veglat me dorë dhe makinat elektrike.</p>	<p>Të dijë të punojë në mënyrë të pavarur objekte të ndryshme nga letra dhe druri duke përdorur veglat elementare.</p>	<p>Aftësitë punuese njoftohen me përpunim me dorë të letrës dhe drurit. Përdorimi i punëtorisë të pajisur me vegla dhe makina të punës. Realizimi bëhet përmes projektit punues.</p>	

Shkathësitë e dizajnit				
Fondi i orëve: 5 ORË				
<ul style="list-style-type: none"> të zhvillojë kreativitet, origjinalitet, mendim kritik dhe të zhvillojë aftësinë dhe shkathësinë e zgjidhjeve të problemeve. të dijë të bëjë dhe të përdorë dokumentacionin teknik; të zhvillojë ide qartë se çka duhet bërë në fazat e punës dhe të sugjerojë metodat alternative në rast të pengesave gjatë punës; 	<p>Punimi i skicës së prodhimit (objektit). Planifikimi i fazave të punës. Vlerësimi dhe krahasimi i skicës dhe objektit të punuar.</p>	<p>Të ketë ide lidhur me fazat e punës prej skicës deri te realizimi i objektit. Të jetë në gjendje të dizajnojë një prodhim të thjeshtë sipas: vetive të materialit, funksionit, estetikës, çmimit, etj.</p>	<p>Përdorimi i kompjuterit për punimin e dokumentacionit teknik. Realizimi bëhet përmes projektit punues.</p>	<p>Gjuha amtare Matematika</p>
Teknologjia e informimit dhe komunikimit				
Fondi i orëve: 5 ORË				
<ul style="list-style-type: none"> të njihet me pjesët kryesore të sistemit kompjuterik dhe mundësitë e 	<p>Pjesët përbërëse kryesore të sistemit kompjuterik. Programet për</p>	<p>Të dijë të përdorë kompjuterin për punimin e dokumentacionit</p>	<p>Realizimi i kësaj mund të bëhet me përdorimin e kompjuterit.</p>	<p>Gjuha amtare Gjuha angleze Matematika</p>

përdorimit të tij;	përpunimin e tekstit dhe vizatimeve. Lidhjet ndërmjet programeve të ndryshme.	teknik.		
Teknika bujqësore dhe e ndërtimtarisë				
Fondi i orëve: 9 ORË				
<ul style="list-style-type: none"> të njihet me makinat bujqësore dhe makinat e ndërtimtarisë; të kuptuarit e ndërlidhjes ndërmjet veglave të makinës dhe materialit që përpunohet; të kuptuarit e lidhjes në mes të makinës bazë dhe veglave përngjitëse; të kuptojë dallimin në mes të makinave për transport dhe për përpunim të materialit 	<p>Makinat për përpunim të tokës</p> <p>Makinat për mbjellje, korrje, spërkatje dhe vjelje</p> <p>Makinat për transport</p> <p>Makinat për përpunimin e materialeve ndërtimore</p> <p>Elementet e ndërtimtarisë</p>	<p>Të dijë dhe të kuptojë disa parime elementare të operacioneve punuese të disa makinave bujqësore dhe të ndërtimtarisë;</p> <p>Të dijë se objektet përbëhen prej elementeve të ndryshme të ndërtimtarisë në mënyra të ndryshme;</p> <p>Të dallojë makinën dhe veglën. Të kuptojë lidhjen ndërmjet veglave dhe materialeve;</p> <p>Të klasifikojë makinat në bazë të kriterëve të ndryshme.</p>	<p>Konkretisht të njihet me punën e një makine bujqësore dhe të ndërtimtarisë dhe me demonstrimin e tyre. Përpunimi i modelit të ndonjë pajisjeje. Kjo njësi mësimore realizohet si projekt prej njohjes së makinës deri te modeli dhe kjo përfshinë shkathtësinë e dizajnit dhe të punuarit.</p>	<p>Gjuha amtare</p> <p>Fizika</p> <p>Biologjia</p>

VLERËSIMI

Vlerësimi i të nxënit bëhet në këto mënyra:

1. Duke vlerësuar angazhimin e nxënësit gjatë realizimit të përmbajtjes programore
2. Duke vlerësuar punën individuale për punimin e projekteve (modeleve) dhe punë me kompjuter
3. Duke vlerësuar kontributin në punë grupore
4. Testimi gjatë procesit mësimor
5. Vlerësimi i detyrave dhe projekteve individuale

UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TJERA MËSIMORE

LITERATURA

1. **Pajtim Bejtja, Alqi Mustafai, Eva Zagori, Renata Qatipi, Robert Tytymçe, Franko Kondakçi:** “Teknologjia 1”, Tiranë 2002.
2. **Mr. Rexhep Berisha:** “Arsimi teknik” klasa V,VI, Prishtinë 2001.

Pajisjet dhe parakushtet tjera të nevojshme

1. Kabineti me pajisje për punimin e projekteve
2. Kabineti me kompjuterë dhe shtypës
3. Aplikacionet e nevojshme softverike
4. Lidhja në Internet, rrjeti lokal në kabinet
5. Trajnime për arsimtarë
6. Mirëmbajtja

Kushtet minimale

1. Mjetet dhe veglat elementare për punë praktike
 2. Trajnime për arsimtarë
- Një kompjuter në shkollë për demonstrim të programit mësimor

VËREJTJE:

Nëse shkolla nuk ka kabinet për punimin e projekteve, atëherë programi duhet të realizohet në klasë.

Nëse shkolla nuk ka kompjuterë të potencohen aspektet teorike të temave të parapara në program dhe të bëhet demonstrimi i tyre nëse shkolla ka së paku një kompjuter.

Në fondin e paraparë të orëve janë të përfshira ligjërimi, përforcimi i lëndës dhe testimi i nxënësve.

UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME

1. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore, p.sh. ligjërimi 25%, demonstrimi 25 %, puna individuale dhe grupore 50%
2. Nxitja e punës individuale dhe shkëmbimi i dijes dhe shkathësive, puna ndërvepruese

Përsëritja e përmbajtjes nëpërmjet detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara

ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR

Puna grupore dhe individuale.

HYRJE

Eduka fizike dhe sportive në shkollën e mesme të ulët, e vënë nxënësin në kontakt me një numër të madh aktivitetesh fizike, sportive e artistike, të cilat e konstitujnë në kulturën bashkëkohore. Sipas natyrës së tyre këto aktivitete e privilegjojnë një mënyrë të posaçme të relacioneve dhe adaptimeve përballë rrethit fizik dhe njerëzor. Ajo iu mundëson të gjithë nxënësve që të provohen fizikisht dhe të njihen më mirë me përvojat të llojllojshme dhe origjinale, me burime emocionale dhe dëshirash.

EFS ndihmon në zhvillimin e personalitetit. Në kuptim më të gjerë dhe në raport me disipinat tjera, ky është diversiteti i rrethëve, në të cilat janë të vëna përvojat individuale dhe kolektive, që i lejon EFS të marrë pjesë në mënyrë specifike në edukim, shëndet, në siguri, solidaritet, përgjegjësi dhe në autonomi. Duke i ofruar raste konkrete për qasje në vlerat shoqërore dhe morale, posaçërisht në raport me rregullat, EFS ndihmon në arsimim dhe qytetërim

QËLLIMET

- Edukimi fizik dhe sportiv duhet të jetë mjet i zhvillimit të tërësishëm të personalitetit;
- Duhet të respektojë parimin e mundësive të barabarta për të gjithë nxënësit dhe respektimin e dallimeve ndërmjet tyre;
- Procesi pedagogjik të udhëhiqet ashtu që secili nxënës të jetë i suksesshëm dhe i motivuar;
- Loja si mjet relaksues dhe si mjet i edukimit duhet të jetë e pranishme në çdo orë të edukimit fizik;
- Qëllimet e natyrshme të programit mësimor lejojnë një shkallë të caktuar të autonomisë së shkollës dhe mësuesit dhe si e tillë kërkon një përgjegjësi profesionale për zgjedhjen e përmbajtjes, metodave dhe formave të punës;

- Programi mësimor duhet t'i inkurajojë fëmijët për marrëdhënie humane të ndërsjella dhe për sjellje sportive (fair play);
- Trajtim të posaçëm duhet kushtuar fëmijëve me nevoja të veçanta dhe atyre të talentuar;
- Të ndërlihdë veprimtarinë sportive me fushat tjera lëndore;
- Programi mësimor përgatit dhe vlerëson të arriturat e fëmijëve dhe nxit (inkurajon) për aktivitete të sportit;
- Duhet të respektojë standardet e shkruara dhe aktet normative dhe të kujdeset për siguri gjatë të ushtruarit.

OBJEKTIVAT

Zhvillimi i trupit, aftësive lëvizore dhe funksionale

- formimi i mbajtjes së drejtë të trupit;
- zhvillimi i aftësive lëvizore përmes lojërave të vogla sportive, lojërave shtafetare dhe në poligon;
- zhvillimi i aftësive lëvizëse (koordinimit, forcës, shpejtësisë, lëvizshmërisë, baraspeshës, saktësisë etj.);
- zhvillimi i aftësive funksionale përmes aktiviteteve të ndryshme në natyrë (shëtitje, vrapim, vrapim orientues etj.).

Përvetësimi i diturive të ndryshme sportive

- të mësuarit e teknikës së vrapimit, kërcimit dhe hedhjes
- të mësuarit e teknikës së disa elementeve gjimnastikore dhe lidhja e tyre në tërësi-kompozime
- të mësuarit e elementeve themelore teknike dhe taktike dhe përdorimi i tyre në situata të lojës
- të mësuarit e disa valleve shoqërore dhe popullore
- të mësuarit e një teknike të notit
- të mësuarit e sigurtë të skijimit

Lidhshmëria me njohuritë teorike

- njohja e rekuizitave dhe veglave sportive, ruajtja dhe përdorimi i sigurtë i tyre
- të kuptuarit e disa nocioneve sportive
- njohja e rëndësisë së disa sporteve, posaçërisht të atyre që janë të lidhura me të kaluarën dhe traditën tonë (psh. mundja)

- njohja dhe respektimi i rregullave të lojërave të vogla sportive
- njohja e kuptimit të ritmit, taktit dhe tempit në lëvizje
- të kuptuarit e përparësisë së veshmbathjes sportive, sidomos në situata të caktuara (në gara dhe në kushte të ndryshme të motit)
- respektimi i rregullave të sjelljes dhe i parimeve të sigurisë veçanërisht në pishinë, në mal, në shteg të skijimit etj.
- të kuptuarit e drejtë të rëndësisë së marrjes me sport në mënyrë të rregullt dhe sistematike për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit

Përjetimi i këndshëm i sportit, formimi dhe zhvillimi i qëndrimit të drejtë (sjelljes) shprehive dhe mënyrave të sjelljes

- zhvillimi i vendosmërisë dhe shpirtit luftarak në situata të ndryshme
- zhvillimi i këmbëngultësisë përmes aktiviteteve aerobe
- të zhvilluarit e sjelljes pozitive në sport, pjesëmarrjes dhe ndihmës së ndërsjellë
- të mësuarit e zhvillimit të respektimit të ndërsjellë
- kultivimi i qëndrimit dhe shprehive higjienike ndaj pasurisë së shkollës dhe pajimeve sportive
- të zhvilluarit e ndjenjës për vlerësimin dhe ruajtjen e traditës dhe trashëgimisë kulturore.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

1. VLERËSIMI I AFTËSIVE LËVIZORE	4 orë
2. ATLETIKË	12 orë
3. GJIMNASTIKË SPORTIVE DHE RITMIKE	14 orë
4. SPORTET KOLEKTIVE	24 orë
5. SPORTET INDIVIDUALE	
- sportet luftarake	12 orë
- sportet me raketë	8 orë
6. SKIJIMI	7-10 ditë
7. PIKNIQET DHE FUSHIMI	2 ditë në vit
8. GARA SPORTIVE SË PAKU NË DY SPORTE (SIPAS KUSHTEVE)	

TËRËSITË MËSIMORE	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET E PRITURA	LIDHSHMËRIA ME LËNDËT TJERA
1. VLERËSIMI I AFTËSIVE MOTORIKE	Matjetjet antropometrike dhe aftësive psiko-motorike	Forma e punës në grup, metoda verbale dhe e demonstrimit	Shkalla e përparimit (vlerësimi fillestar dhe përfundimtar i veçorive antropometrike dhe lëvizore)	Matematika Edukimi shëndetësor
2. ATLETIKË • Ecjet dhe vrapimet	Ecjet dhe vrapimet Ecja sportive Bazat e tekinkës së vrapimit të shpejtë dhe të qëndrueshëm Vrapim i shpejtë 60 m Vrapim i qëndrueshëm 600-800 m	Forma e punës grupore dhe individuale	Nxënësit duhet të të dinë të dallojnë ecjen e rëndomtë nga ecja sportive Të dinë nisje e ulët dhe të lartë Të dinë të vrapojnë në mënyrë të koordinuar me tempo të caktuar	Matematika Biologjia
• Kërcimet	Kërcim së larti – teknika “gërshërë” Kërcim së largu – teknika “trupi në hark”	Forma e punës grupore dhe individuale Metodat e punës: gojore, e demonstrimit, sintetike dhe e ilustrimit	Të dinë të kërcëjnë së largu dhe së larti me vrull	Biologjia Fizika
• Hedhjet	Hedhja e topthave deri 200 gr. nga vendi dhe me hov, në cak dhe në largësi	Forma e punës frontale dhe grupore Metodat e punës: gojore, e demonstrimit, sintetike dhe e ilustrimit	Të dinë të hedhin topthin me vrull Të dinë të shtytin topat medicinalë	Biologjia Fizika Matematika

	Hedhja e topave medicinalë			
3. GJIMNASTIKA SPORTIVE DHE RITMIKE • Ushtrime në dysHEME	Kapërdimi para, kapërdimi prapa, qëndrimi mbi duar, rrotullimi anësor “ylli”	Forma e punës Frontale, në çifte dhe individuale	Nxënësit duhet të dinë të dallojnë kapërdimin nga rrotullimi, të dinë qëndrimin mbi duar, rrotullimin anash	Fizikë
• Kërcimet:	Kërcimi i kaluqit këmbë-anash Kërcimi i kaluqit këmbëmbledhur	Forma e punës frontale, në çifte dhe individuale	të kërcejnë kaluqin me këmbë anash dhe këmbë të bashkuara	Fizikë
• Hekuri	Lëkundje para prapa në kacavarje	Forma e punës Frontale, në çifte dhe individuale	Të dinë të varen, kryejnë lëkundje në hekur dhe të dalin	Fizikë
• Paralelet	Me kërcim hipje në mbështetje në krahë, ecje para mbi duar, lëkundje para në mbështetje mbi duar-krahët e shtrirë, dalja me lëkundje para nga mbështetja mbi duar	Forma e punës frontale, në çifte dhe individuale	Të dinë hyrjen në paralele, të kryejnë lëkundje dhe qëndrim me forcë dhe të dinë një dalje të thjeshtë	Fizikë
• Trau gjimnastikor	Ecje mbi tra, vrapim dhe kthim, si dhe lidhja e këtyre elementeve në	Forma e punës frontale, në çifte dhe individuale	Të dinë të ecin mbi tra, të bëjnë kthim, të mbajnë baraspeshën	Fizikë

	tërësi. Ekuilibri ballor dhe anësor mbi tra. Dalja anash. me trup të drejtë	Metodat e punës: gojore, e demonstrimit, analitike dhe sintetike	dhe t'i kombinojnë elementet në tërësi	
• Valle popullore kombëtare dhe ndërkombëtare	Vallja: Shota Një valle ndërkombëtare Vallëzim modern	Forma e punës frontale	Të dinë të luajnë vallen me përcjellje muzikore, Të dinë vallëzimin elementar modern	Kulturë muzikore
4. SPORTET KOLEKTIVE • Futbollli i vogël	Elementet themelore teknike pa top: ecjet, vrapimet, ndaljet dhe klërcimet Elementet me top: pasimet, ndaljet, pranimet dhe goditjet Elementet e taktikës individuale dhe grupore Lojëra të thjeshta 1:1 deri 7:7	Forma e punës frontale dhe individuale Metodat e punës: gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Nxënësit duhet të dinë të kryejnë pasimet, pranimet dhe goditjet e topit, të dinë të përdorin elementet themelore teknike dhe taktike në lojën 1+1 deri 7+7	
• Hendbolli i vogël	Elementet themelore teknike pa top: ecjet, vrapimet, ndaljet dhe lërcimet Elementet me top: Kapja dhe mbajtja e topit, pasimet, pranimet	Forma e punës frontale dhe individuale Metodat e punës: gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Nxënësit duhet të dinë të kryejnë pasimet, pranimet dhe goditjet e topit, të dinë të përdorin elementet themelore teknike dhe taktike në lojën 1+3	Matematika

	dhe goditjet Elementet e taktikës individuale dhe grupore Lojë-hendbolli i vogël 1+3 dhe 1+4		dhe 1+4	
• Basketbolli i vogël	Elementet themelore teknike pa top: ecjet, vrapimet, ndaljet në qëndrimet themelore dhe lërcimet Elementet me top: Kapja dhe mbajtja e topit, pasimet, driblimi me ndërrimin e dorës dhe kahjes, ndalja në driblim, gjuajtja në shportë nga vendi dhe në lëvizje Elementet e taktikës individuale dhe grupore Lojë në një shportë 1:1, 2:2 dhe në dy shporta 3:3	Forma e punës frontale dhe individuale Metodat e punës: gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Nxënësit duhet të dinë të kryejnë pasimet, pranimet dhe gjuajtjen në shportë, të dinë të përdorin elementet themelore teknike dhe taktike në lojën 1:1, 2:2 dhe 3:3	Matematika
• Volejboli i vogël	Elementet themelore teknike pa top: lërcimet Elementet me top: dëbimi i topit nga lartë, nga poshtë, shërbimi	Forma e punës Frontale dhe individuale Metodat e punës: Gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Nxënësit duhet të dinë të kryejnë pasimet, pranimet, shërbimin dhe goditjet e topit, të dinë të përdorin	Matematika

	nga poshtë Elementet e taktikës individuale dhe grupore Lojë 2:2, 3:3		elementet themelore teknike dhe taktike në lojën 1:1, 2:2 dhe 3:3	
5. SPORTET INDIVIDUALE	Elementet themelore të mundjes –stili i lirë: Kapjet për krahë, për trung, për brez dhe për këmbë Elementet themelore të karatesë: Mbrojtja: Lëvizjet me duar dhe me këmbë Sulmi: me duar dhe këmbë Një katë themelore	Forma e punës frontale dhe individuale Metodat e punës: gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Nxënësit duhet të dinë elementet themelore teknike të karates mundjes dhe xhudos.	Biologji
• Sportet me raketë: • Pingpongu	Lëvizjet e dorës dhe të këmbëve. Kapja dhe mbajtja e raketës. Goditjet themelore të topit: forhend, bekhend, shërbimi dhe pranimi i shërbimit.	Forma e punës frontale dhe individuale Metodat e punës: gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Të dinë goditjet themelore të topit me raketë si: forhendi, bekhendi, shërbimi	Matematika

6. SKIJIMI 7-10 ditë	Ecjet Kthimet Ngjitjet Zbritjet Lëshimet	Forma e punës frontale në çifte dhe individuale Metodat e punës: gojore, e demonstrimit dhe sintetike	Nxënësit duhet të dinë ecjen me ski, kthimet dhe ngjitjet, lëshimet.	Biologjia Fizika Edukimi shëndetësor
7. PIKNIQET	Shëtitje në natyrë	Forma e punës frontale	Njohja e bukurive natyrore	Gjeografi Biologji
8. GARAT SPORTIVE	Të organizohen gara sportive, së paku në dy disiplina sportive	Forma e punës frontale dhe individuale	Zbatimi i rregullave të lojërave dhe sjellja sportive (fair –play), si dhe organizimi i garave	Edukatë qytetare

Nga katër sportet kolektive të ofruara shkolla duhet të zgjedhë së paku dy, varësisht nga kushtet dhe kuadrin që ka.

Përmbajtjet shtesë:

Vozitja me roshulla, me biçikletë, tenis, badminton, ragbi etj. Zgjedhjen e këtyre përmbajtjeve e bën mësuesi dhe shkolla në bazë të kushteve materiale, kadrovike dhe traditës së regjionit ku ndodhet shkolla.

VLERËSIMI

- Vlerësimi i zhvillimit trupor bëhet me instrumente antropometrike - dy herë në vit (lartësia e trupit dhe pesha e trupit)
- Vlerësimi i aftësive lëvizëse bëhet me sistemin CGS-dy herë në vit (kërcim nga vendi në gjatësi, kërcim nga vendi në lartësi, vrapim 60 metra dhe vrapim 600 metra (vajzat), 800 metra (djemtë).
- Niveli i informatave të mësuara vlerësohet individualisht dhe gjatë situatës së lojës.
- Vlerësimi i nivelit të përvetësimit të elementeve teknike dhe taktike

LITERATURA

1. **Hasangjekaj, B., Puka, J.:** *Edukata fizike* për klasën V-VI
2. **Hasangjekaj, B., Puka, J.:** *Edukata fizike* për klasën VII-VIII